



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2617, datë 8.10.2015

Për

“Miratimin të Dokumentit: Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokument Përfundimtar”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës __.__.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin të Dokumentit: Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Përfundimtar”

mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Grupi i Punës, të përbërë nga:

i. Relacioni shpjegues;

ii. Dokumenti *“Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Përfundimtar”*

iii. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485.

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
3. Ligji nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
4. “Rregullore per analizen e tregut”, miratuar me vendimin nr. 747, date 17.07.2009, te Keshillit Drejtues te AKEP, ndryshuar me VKD nr.2342, datë 31.07.2013 (**Rregullorja**).
5. Vendim Nr. 2582, datë 22.06.2015, “Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Këshillim Publik”

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projekt-Vendimi për “*Miratimin e Dokumentit “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar”*”
2. Relacioni shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**),
3. Komentet e palëve të interesuara për dokumentin “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit - Konsultim Publik*”:
4. Dokumenti i përgatitur nga Grupi i Punës “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar*”, i cili përmban si Aneks 2: *Komentet në Konsultim Publik dhe Qëndrimi i AKEP për komentet*;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V E R E N:

1. Këshilli Drejtus i AKEP me Vendimin Nr. 2582, datë 22.06.2015, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të Dokumentit: *Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Këshillim Publik.*
2. Këshillimi publik u krye më datë 25.06.2015-15.09.2015, dhe nga palët e interesuara kanë dërguar komente Autoriteti i Konkurrencës (AK) dhe operatorët Albtelecom, Albanian Mobile Communication, Vodafone Albania dhe Abcom, nëpërmjet shkresave të mëposhtëme:
 - Autoriteti i Konkurrencës (AK) me shkresën nr. 307/1 prot., datë 16.09.2015 (referenca e AKEP: nr. 542/11 prot., datë 18.09.2015)
 - Albtelecom sh.a me shkresën Nr. 7385 Prot., datë 15.09.2015 (referenca e AKEP: nr. 542/7 prot., datë 15.09.2015)
 - Vodafone Albania sh.a me shkresën ref. LRD/0135/OX., datë 15.09.2015 (referenca e AKEP: nr. 542/8 prot., datë 16.09.2015)
 - Telekom Albania sh.a me shkresën Nr. 3767/1, datë 15.09.2015 (referenca e AKEP: nr. 542/9 prot., datë 17.09.2015)
 - Abcom sh.a me shkresën Nr. 965, datë 15.09.2015 (referenca e AKEP: nr. 542/10 prot., datë 17.09.2015).
3. Nga komentet e palëve të interesuara vihet re se AK është dakort me përfundimet e AKEP si dhe masat e propozuara për rregullimin e tregjeve të telefonisë fikse, ndërsa operatorët në përgjithësi janë dakort me përfundimet e AKEP por kanë edhe qëndrime të ndryshme për disa aspekte të rregullimeve të propozuara nga AKEP, Komentet dhe qëndrimi i AKEP për komentet janë paraqitur si ANEKS i dokumentit përfundimtar të Analizës së Tregut.
4. Dokumenti “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokument Përfundimtar”:
 - a. është përgatitur pas kryerjes së këshillimit publik të zhvilluar më 25.06.2015-15.09.2015, dhe përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për komentet (Aneks 2, i dokumentit) në përputhje me nenin 35 të Ligjit 9918;
 - b. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë së të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;

- c. nga pikpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin 9918 dhe Rregulloren për Analizën e tregut;
 - d. nga pikpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizen e tregut në nenin 31 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, dhe Rregullores, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkates dhe analizën e testit të tre kriterëve, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;
 - e. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Europian dhe praktikën më të mirë rregullatore në vendet e Bashkimit Europian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut Shqiptar celular;
 - f. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918.
5. Dokumenti “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokument Përfundimtar” shërben si bazë për marrjen e vendimeve për statusin me FNT në tregjet e analizuara, dhe masat rregulluese për sipërmarrësit e përcaktuar me status me FNT.

A T E H E R E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe në zbatim të kompetencës ligjore të përcaktuar në shkronjën ç) të nenit 8 të ligjit nr. 9918, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S:

1. Të miratojë Dokumentin “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Përfundimtar”, - sipas përmbajtjes në Aneks 1.
2. Kundra këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Këshillin Drejtues të AKEP, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit përkatës.
3. Ky Vendim dhe dokumenti i miratuar në pikën 1 të publikohen në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARË:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Anila DENAJ**
- 3. Ketrin TOPÇIU**
- 4. Klarina ALLUSHI**



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ANALIZE

E TREGUT

TE TELEFONISE FIKSE

- 1) Tregu me pakice i aksesit/thirrjeve nga rrjete publike telefonike nga vendodhje fikse.
- 2) Tregjet me shumice te terminimit/tranzitimit/origjinimit te thirrjeve ne rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse.

Dokument Perfundimtar

Tetor 2015

(MIRATUAR ME VKD NR. ____ DATE ____ 2015)

Publikuar ne faqen e Internetit te AKEP, www.akep.al, ne seksionin 'Konsultime te Perfunduara'.



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ANALIZE

E TREGUT

TE TELEFONISE FIKSE

- Tregu me pakice i aksesit/thirrjeve nga rrjete publike telefonike nga vendodhje fikse.
- Tregjet me shumice te terminimit/tranzitimit/origjinimit te thirrjeve ne rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse.

Dokumenti Përfundimtar

Tetor 2015

(Miratuar me VKD nr.2617, date 8.10.2015)

INDEKSI I PERMBAJTJES

I. PERMBLEDHJE	4
II. HYRJE	13
II.1. PANORAME E SEKTORIT TE TELEFONISE FIKSE.....	13
II.2. PERCAKTIMI I SIPERMARRSVE ME FUQI TE NDJESHME NE TREG	15
1. Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator	15
2. Procesi i Konsultimit.....	16
3. Bashkepunimi me Autoritetin e Konkurences.....	17
4. Struktura e Dokumentit	17
5. Perkufizimi i tregut perkates	18
6. Fuqia e Ndjeshme ne Treg dhe masat rregulluese	20
III. ANALIZA E TREGJEVE TE SHERBIMEVE ME PAKICE	22
III.1. ZHVILLIMET E TREGUT ME PAKICE TE TELEFONISE FIKSE.....	22
1. Tendencat e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse	22
2. Ecuria e trafikut telefonik.....	25
3. Pjeset e Tregut	27
4. Tarifimi i sherbimeve me pakice	28
5. Perdorimi mesatar i thirrjeve telefonike fikse.....	34
6. Portabiliteti i numrit Fiks:	35
7. Faktore te tjere konkurrues.....	35
8. Konkurrenca e mundshme.....	36
9. Perfundim mbi ecurine e tregut te telefonise fikse	38
III.2. PERKUFIZIMI I TREGJEVE PERKATES ME PAKICE	39
III.3. TESTI I TRE KRITEREVE	43
IV. ANALIZA E TREGJEVE TE SHERBIMEVE ME SHUMICE: ORIGJINIMI, TRANZITIMI DHE TERMINIMI I THIRRJEVE NE RRJETET FIKSE	46
IV.1. PERKUFIZIMI I TREGJEVE TE INTERKONEKSIONIT	46
IV.2. ANALIZA PER FNT E TREGJEVE TE INTERKONEKSIONIT	50
1. Terminimi i thirrjeve ne rrjetet fikse	50
2. Tranzitimi i thirrjeve ne rrjetet fikse	56
V. MASAT RREGULLUESE PER OPERATORET ME FNT	58
V.1. MASAT RREGULLATORE PER TREGJET ME SHUMICE TE INTERKONEKSIONIT	59
1. Masat rregullatore te propozuara per Albtelecom	59
2. Masat rregullatore te propozuara per terminimin ne rrjetet e OA dhe Telekom Albania	60
V.2. RREGULLIMI I TARIFAVE ME SHUMICE TE INTERKONEKSIONIT	60
1. Rregullimi i tarifave me shumice te interkoneksionit te Albtelecom.....	60
2. Tarifat e terminimit ne rrjetet e operatorëve alternativë fiks dhe Telekom Albania.....	64
3. Efektet e pritshme te ndryshimeve te tarifave te terminimit.....	64
V.3. HEQJA E DETYRIMEVE NE TREGJET E DE-RREGULLUARA	66
ANEKS 1. LISTA E SIPERMARRSVE TE RRJETEVE PUBLIKE TELEFONIKE FIKSE TE PROPOZUAR PER STATUS ME FNT NE TERMINIMIN E THIRRJEVE.....	68
ANEKS 2. QENDRIMI I AKEP PER KOMENTET E DERGUARA NE KESHILLIM PUBLIK.....	70

INDEKSI I TABELAVE DHE FIGURAVE

Figura II.1 Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2014	13
Figura II.2 Ecuria e numrit te perdoruesve të telefonisë celulare dhe fikse 2010-2014.....	14
Figura II.3. Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve Elektronike 2014	14
Figura II.4. Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve Elektronike (2008-2014)	15
Figura III.1 Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2014	22
Figura III.2 Ecuria e normes se peneterimit te telefonise fikse: Shqiperia v Bota.....	23
Tabela III.1: Ecuria e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse sipas operatoreve (2010-2014)	23
Tabela III.2: Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse QIV/2014-QII/2015	24
Figura III.3: Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse sipas qarqeve 2014	25
Figura III.4: Norma e penetrimit e linjave të telefonisë fikse sipas qarqeve 2014.....	25
Figura III.5: Ecuria e thirrjeve nga rrjetet fikse dhe celulare 2010-2014.....	26
Figura III.6: Pjeset e tregut te numrit të pajtimtarëve të telefonise fikse (2010-1014)	27
Tabela III.3 Pjeset e tregut te treguesve kryesore te telefonise fikse 2007-2014.....	27
Tabela III.4 Pjeset e tregut te numrit te pajtimtareve te telefonise fikse QIV/2014-QII/2015.....	28
Tabela III.5: Krahasim i tarifave te paketes standarde te Albtelecom me vendet e SEE (2013/14)	30
Figura III.6: Ecuria e tarifës së pajtimit mujor Familjare: Shqipëri dhe SEE 2006-2013/4.....	31
Tabela III.6: Krahasim i tarifave te paketes standarde te Albtelecom me vendet e SEE (2015)	31
Tabela III.7: Krahasim i tarifave te paketes standarde te Albtelecom me operatoret alternative (2015).....	32
Tabela III.8: Ecuria e ARPM per rrjete celulare 2010-2014.....	33
Tabela III.9: Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve te Albtelecom 2010-2014	34
Tabela III.10: Perdorimi mesatar mujor i thirrjeve telefonike celulare 2010-2014	35
Tabela III.11: Perdorimi mesatar mujor i thirrjeve nga rrjete fikse dhe rrjete ceulare 2010-2014	42
Figura IV.1: Skema e elementeve (inputeve) me shumice per realizimin e thirrjeve telefonike	46
Tabela IV.1: Vlerat e tarifave tarifave të terminimit/origjinim/tranzitimit në Albtelecom 2013-2015	52
Tabela IV.2: Vlerat maksimale të tarifave të terminimit në rrjetet e operatoreve alternative fiks 2013-2015.....	52
Tabela IV.3: Vlerat maksimale te tarifave të terminimit ne rrjetin Telekom Albania per thirrjet drejt Telekom Albania Fiks 2013-2015.....	52
Figura IV.1: Tarifat mesatare të terminimit në vendet e BE (Janar 2013 dhe Janar 2014).....	53
Figura IV.2: Tarifat mesatare të terminimit sipas vendeve në Janar 2014.....	54
Tabela IV.4: Trafiku kombetar i tranzituar nga Albtelecom dhe OA (2010-2014)	56
Tabela V.1: Vlerat maksimale te tarifave tarifave të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjetin Albtelecom 2013-2015 (Analiza e tregut 2013)	61
Tabela V.2.1: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetin fiks Albtelecom (2010-2017)-Keshi9llimi Publik.....	62
Tabela V.2.2: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetin fiks Albtelecom (2010-2017) (version final)	62
Tabela V.3: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse të OA dhe Telekom Albania për Telekom Albania fiks (2010-2017).....	64
Tabela V.4: Ndryshimet në përqindje të tarifave të terminimit në rrjetet fikse (1.09.2014-2017).....	64

I. PERMBLEDHJE

Ligji nr.9918, date 19.05.2008 "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar (ne vijim Ligji 9918), ne nenin 1 te tij, percakton se qellimi i ligjit eshte qe nËpËrmjet parimit tË asnjansisË teknologjike tË promovojË konkurrencË dhe infrastrukturË efiçente nË komunikimet elektronike dhe tË garantojË shËrbimet e duhura dhe tË pËrshtatshme nË territorin e RepublikËs sË ShqipËrisË. Ne Nenin 35 te tij ligji 9918 parashikon detyrimin per zhvillimin e procedures se keshillimit me palet e interesit per analizen e tregut duke percaktuar edhe kohezgjatjen minimale te periudhes se konsultimit publik prej 60 ditesh. Njekohesisht neni 36 percakton se AKEP vendos, ndryshon mban ose heq detyrime per FNT pas keshillimit me palet e interesuara.

AKEP publikoi dokumentin e Analizes per keshillim publik me 25.06.2015 dhe periudha e keshillimit publik perfundoi me 15.09.2015. Ne perfundim te keshillimit publik ne AKEP jane depozituar komente nga kater operatore si dhe nga Autoriteti i Konkurrences. Ne Aneks 2 te ketij dokumenti final te analizes AKEP ka dhene nje permbledhje te komenteve te derguara nga palet e interesuara si dhe qendrimin e AKEP per komentet. Komentet e plota te paleve te interesuara jane publikuar si dokument me vehte.

Ky dokument perben versionin final te analizes se tregut te telefonise fikse pas keshillimit publik mbi te cilen jane bazuar dhe vendimet perkatese per FNT dhe masat rregulluese. Dokumenti eshte perditesuar me te dhenat me te fundit te tregut si dhe jane bere ndryshime per te reflektuar qendrimin e AKEP per komentet e marra.

Kjo analize e tregjeve te telefonise fikse perben raundin e katert te analizes se tregjeve te telefonise fikse. Procesi i meparshem i analizes se tregut te telefonise fikse ne vitin 2013, perfundoi me publikimin e dokumentit te Analizes se Tregut te Telefonise Fikse dhe Vendimet e Keshillit Drejtues te AKEP, VKD nr.2336-2339, date 30-31.07.2013, nepermjet te cilave AKEP percaktoi si operatore me FNT:

- Albtelecom sh.a ne tregjet perkates te meposhtem:
 - Tregjet me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse;
 - Tregun me shumice te terminimit te thirrjeve telefonike ne rrjetin e telefonise fikse te Albtelecom;
 - Tregjet me shumice te origjinimit dhe tranzitimit te thirrjeve ne rrjetet telefonike fikse.
- 77 operatore alternative te rrjeteve telefonike fikse dhe AMC¹ ne tregjet e terminimit te thirrjeve ne rrjetet individuale te telefonise fikse (AMC per terminimin e thirrjeve drejt numrave fiks per sherbimin AMC Fiks).

Masat rregulluese per FNT perfshinin midis te tjerave:

- Detyrime per mos-diskriminim dhe transparence, perfshire publikimin e RIO nga Albtelecom (per operatoret e tjere nuk u vendos detyrim per RIO);
- Kontrollin e tarifave te Albtelecom per sherbimet me shumice te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit;
- Kontrollin e tarifave per terminimin ne rrjetet e operatoreve alternative;

¹ Telekom Albania (Albanian Mobile Communications) ne Korrik 2015 nderroi emrin ne Telekom Albania, dhe pavaresisht se ne dokumnet mund te kete perdorim te dy emrave, ato i referohen te njejtis sipermarres

- De-rregullimi i tarifave me pakice te Albtelecom.

Ky dokument permban versionin final te analizes se tregjeve me pakice dhe tregjeve me shumice te telefonise fikse, dhe konkretisht:

- 1) Tregu me pakice i aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendndodhje fikse;
- 2) Tregu me pakice i thirrjeve telefonike te disponueshme per publikun nga vendndodhje fikse.
- 3) Tregu me shumice i origjinimit te thirrjeve ne rrjetin telefonik publik te ofruara nga vendndodhje fikse .
- 4) Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve per rrjete publike telefonike individuale te ofruara nga vendndodhje fikse.
- 5) Tregu me shumice i sherbimeve tranzite ne rrjetet telefonike publike fikse.

Dokumenti ka bere nje rishikim te ecurise dhe zhvillimeve te tregjeve me pakice dhe me shumice te analizuara dhe bazuar ne keto zhvillime ne Shqiperi si dhe ne zhvillimet ne kuadrin rregullator te BE per tregjet perkates ka bere dhe nje rishikim per perkufizimin e disa tregjeve perkates qe nuk jane me pjese e listes se rekomanduar nga KE per nderhyrje ex-ante.

Konkluzione nga analiza e tregjeve me pakice

Numri i pajtimtareve te telefonise fikse ne fund te vitit 2014 ishte rreth 236 mije, qe perben nje renie me rreth 16% ne krahasim me vitin 2013. Kjo renie eshte ne vazhdimesi te kurrjes se numrit te pajtimtareve te telefonise fikse qe prej vitit 2012. Kjo tendence ka vazhduar edhe ne dy tremujoret e pare te vitit 2015.

Norma e penetrimit e telefonise fikse (numri i pajtimtareve per 100 banore) prej 9% ne Shqiperi eshte shume me e ulët krahasuar me vendet e BE (39%) madje me e ulet edhe se mesatarja e vendeve ne zhvillim (10.6%).

Albtelecom në fund të vitit 2014, kishte rreth 183 mijë pajtimtarë qe perben nje reduktim me 18% ne krahasim me vitin 2013, dhe nje renie me 34% krahasuar me vitin 2010. Numri i pajtimtareve te operatorëve alternative per 2014 ishte rreth 53 mijë dhe perben nje renie me 25% krahasuar me vitin 2013, por nje faktor i rendesishem ne kete reduktim ka qene ndryshimi ne menyren e matjes/raportimit nga dy operatore kryesore alternative. Numri i pajtimtareve te Albtelecom ka vazhduar te reduktohet edhe ne dy tremujoret e pare 2015 (6% renie krahasuar me fundviten 2014).

Trafiku telefonik i pajtimtareve te telefonise fikse ka reduktime te ndjeshme ne tre vitet e fundit dhe renia e sasise se thirrjeve nga rrjete fikse eshte shoqeruar me rritje te ndjeshme te sasise se thirrjeve nga rrjete celulare. Ne vitin 2014 sasia e totale e thirrjeve nga rrjete fikse perbente vetem 3% te thirrjeve totale nga rrjete fikse dhe celulare se bashku.

Pjesa e tregut te Albtelecom per pajtimtare nuk ka ndryshime te medha ne tre vitet e fundit duke qendruar ne nivele 74-77%. Gjithsesi rritja e pjeses se tregut te Albtelecom ne 2014 duhet shqyrtuar me ndryshimet ne menyren e matjes se pajtimtareve te telefonise fikse ne 2014. Ne tremujorin e II 2015, Albtelecom pati renie te pjeses e tregut ne pajtimtare duke arritur ne 75%. Pjesa e tregut te Albtelecom per thirrjet dalese nga 2012 ne 2014 ka luhetje

nga 80-89%, ndersa pjesa e tregut te Albtelecom ne te ardhura eshte reduktuar nga 76% ne fund te vitit 2012 ne 65% ne fund te vitit 2014.

Tendence e viteve të fundit të operatorëve të telefonisë fikse ka qene promovimi i paketave tarifore me përfshirje minutash thirrje telefonike në pajtim mujor (bundles of minutes) si dhe kombinim të shërbimeve të telefonisë dhe aksesit në Internet (bundles of services). Ofrimi ne paketa te perbashketa tregon per konvergjence te sherbimeve dhe preferencat e konsumatoreve per sherbime aksesit ne Internet dhe TV, ndersa roli i telefonise fikse zvogelohet gjithnje e me shume. Deri në fund të 2014 rreth 20% e pajtimtarëve familjarë me akses broadband të Albtelecom ishin përdorues të paketave 3-fishe (telefoni, Internet dhe IPTV).

Albtelecom gjatë vitit 2014 kreu rritje të tarifave të disa lloje të thirrjeve telefonike dhe tarifës së pajtimit mujor për kategorinë familjare nga 530 lekë/muaj (me TVSH) në 700 lekë/muaj (me TVSH), por duke e shoqeruar me përfshirje të minutave te thirrjeve telefonike dhe akses në Internet në pagesën fikse të pajtimit mujor, heqje të tarifës fikse për thirrje. Rritja e pajtimit mujor dhe përfshirja e minutave falas në pajtim mujor rezultojne te jenë në linjë me mënyrën e tarifimit në vende të tjera të telefonisë fikse dhe që synojnë njëkohësisht të nxisin konsumin e thirrjeve telefonike fikse. Nga krahasimi i paketes se ndryshuar tarifore te Albtelecom me paketat standard ne vendet e rajonit rezulton se:

- Tarifa e pajtimit mujor standard e Albtelecom ne nivelin 5 Euro/muaj (700 lek) eshte me uleta ne rajon;
- Vendet qe kane pasur Pajtim mujor te ulet si Serbia, Mali i Zi, Maqedonia kane levizur drejt rritjes se tarifes se pajtimit mujor dhe ndryshimet ne Shqiperi te kesaj tarife duken te ngjashme me keto vende;
- Sasia dhe vlere monetare e thirrjeve te perfshira ne tarifen mujore te Albtelecom jane me te lartat ne rajon (pozitive per perdoruesin). Njekohesisht ne tarifen mujore Albtelecom perfshinte dhe akses ne Internet 1Mbps, qe perben perfitim shtese per perdoruesit e kesaj pakete;
- Vlere e tarifes se pajtimit mujor te paketes standarde te Albtelecom eshte ne nivel te ngjashem me tarifen e pajtimit mujor te paketave me perdorim te ulet ne Kroaci, Maqedoni, Turqi dhe Kosove dhe me perfitime ekstra (njesite e thirrjeve dhe aksesit ne Internet) me te medha se ne keto vende.

Paketat standarde te operatoreve alternative kane tarife pajtimi mujor shume te ulet, madje ASC dhe Telekom Albania ofrojne dhe paketa tarifore me parapagim (Pajtim mujor zero). Karakteristike tjeter e operatoreve Alternative eshte ofrimi falas i thirrjeve brenda rrjetit (te perfshira na pagesen mujore).

Nga te dhenat e portabilitetit te numrit fiks qe prej fillimit te ofrimit te ketij sherbimi rezulton se ne total jane portuar rreth 9500 numra telefonik fiks dhe se Albtelecom eshte operatori dhenes me i madh me rreth 7700 numra apo rreth 81% te totalit te numrave te portuar.

Prezenca e Albtelecom dhe ne tregun celular rrit avantazhet konkurruese te Albtelecom ndaj operatoreve te rrjeteve te telefonise fikse pasi i krijohet mundesia e ofrimit te paketave te perbashketa fikse-celulare. Megjithate pesha e Eagle Mobile ne tregun celular eshte e vogel ne krahasim me dy operoret me te medhenj Telekom Albania dhe Vodafone dhe pjesa e tregut ne te ardhura e Albtelecom (fiks dhe celular) ne 2014 ishte vetem 24% e tregut te komunikimeve elektronike krahasuar me 27 dhe 37% te Telekom Albania dhe Vodafone respektivisht.

Disa operatore alternative kane zgjeruar zonat e ofrimit te sherbimeve duke rritur aftesite konkurruese te tyre ndaj Altelecom ne presence edhe te masave te tjera si portabiliteti i numrit. Ne shume zona gjeografike Altelecom ndeshet me konkurrencen e disa operatoreve alternative. Masa te tjera ne nivel me shumice si LLU, bitstream krijojne mundesi per operatore te tjere te ofrojne edhe thirrje telefonike (VoB) krahas sherbimeve broadband duke perdorur rrjetin e Altelecom.

AKEP ne analizat e meparshme ka perdoruar si reference listen e tregjeve perkates te rekomandimeve te viteve 2003 dhe 2007 te KE. Ne rekomandimin e vitit 2014 per tregjet perkates KE ka hequr nga lista e tregjeve per nderhyrje ex-ante edhe tregun me pakice te aksesit ne rrjet fikse (i vetmi i ngeluar nga lista e vitit 2007).

Bazuar ne zhvillimet e tregut te telefonise fikse (seksioni III.1) dhe te tregut te komunikimeve elektronike ne teresi ne Shqiperi, rekomandimet e KE per tregjet perkates dhe pervojat ne vendet e BE-se, AKEP gjykon te arsyeshme te rishikoje vleresimin e perkufizimit dhe detajimit te 2 tregjeve perkatese me pakice te telefonise fikse te kryer ne vitin 2013. Nga analiza e kryer AKEP ka arritur ne perfundimin se tregu perkates me pakice i sherbimeve telefonike nga vendndodhje fikse perfshin ne nje treg te vetem perkates:

- aksesin dhe thirrjet telefonike nga vendndodhje fikse te ofruara nga operoret e rrjeteve fikse;
- aksesit/thirrjet nga rrjetet celulare jane pjese e tregjeve perkates te aksesit/thirrjeve nga vendndodhje fikse

Nder faktoret me kryesore ne arritjen e ketij perfundimi ishin:

- Shumica e ofruesve te thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse zoterojne rrjetin e tyre te aksesit per lidhje me perdoruesin fundor. Ne Shqiperi jane rreth 80 operatore alternative qe zoterojne rrjetin e vet te aksesit (kryesisht me linja bakri ne rrjetin e aksesit por edhe me kabllor koaksial dhe pa tela si p.sh. Telekom Albania) duke ofruar dhe thirrje telefonike per pajtimtaret e vet. Rrjetet kabllore kane zgjeruar ndjeshem zonat e ofrimit te sherbimit dhe operatori me i madh alternativ (Abcom) eshte operator kabllor me presence rrjeti ne disa zona gjeografike (7 nga 12 qarqe);
- Shumica e operatoreve kryesore alternative dhe Altelecom ofrojne paketa tarifore me pagese fikse mujore qe perfshin dhe thirrje telefonike ne pagesen fikse. Perdorimi i paketave bundle (shporta sherbimesh) eshte rritur ndjeshem. Ne fundvitin 2014, 41% e perdoruesve te sherbimeve telefonike te Altelecom perdornin paketa te integruara dyfishe dhe trefishe: Telefoni, Internet dhe TV.
- Diferenca midis trafikut total dales nga rrjetet celulare dhe rrjetet fikse ka vazhduar te rritet ne 2012-2014, dhe ne 2014 thirrjet nga rrjetet fikse perbenin vetem 3% te thirrjeve nga rrjetet celulare dhe fikse se bashku. Trafiku nga rrjetet celulare ka vazhduar te rritet ndjeshem ndersa trafiku nga rrjetet fikse ka vazhduar te reduktohet ndjeshem;
- Ne 2010-2014 perdorimi mesatar per perdorues i thirrjeve nga rrjete fikse eshte reduktuar me 46% (nga 151 minuta ne muaj ne 81 minuta), ndersa thirrjet nga rrjete celulare jane rritur me 56% (nga 110 minuta ne muaj ne 172 minuta).
- Reduktimi i ndjeshem i tarifave celulare ne vitet e fundit ka rritur ne mase te madhe efektin zevendesues te thirrjeve nga rrjete fikse me thirrje nga rrjete celulare. Kjo vihet re ne konvergjencen e nivelit te tarifave nga rrjetet celulare dhe nga rrjetet fikse (ne 2014 shpenzimi mesatar per nje minute thirrje nga rrjet celular ishte 3.12 lek/minute me TVSH). Ky efekt konvergjuet vihet re edhe ne tarifat e thirrjeve dalese nderkombetare te cilat tradicionalisht kane qene shume me te lira ne rrjetet fikse.

- Norma e penetrimit të shërbimeve të telefonisë fikse në 2014 arriti në 9%, ndërsa për telefoninë celulare ishte 119% për përdorues aktivë dhe 172% sipas kartave SIM. Mbulimi me sinjal GSM për popullsinë është mbi 99%.
- Kohezgjatja mesatare e thirrjeve nga rrjetet celulare për vitin 2014 ishte rreth 2 minuta ndërsa rrjetet fikse (Albtelecom) 2.5 minuta. Kjo tregon se kohezgjatja e thirrjeve nga rrjetet celulare është në rritje dhe duke konvergjuar me kohezgjatjen e thirrjeve nga rrjetet fikse.

Bazuar në perfundimin e perkufizimit të tregut perkates në nivel me pakicë, dhe faktin që ky treg nuk është as pjesë e listës së tregjeve perkates të Rregullores së Analizës së tregut dhe as pjesë e rekomandimit të vitit 2014 të KE për tregjet perkates, AKEP ka kryer testin e 3 kritereve nëse ky treg është i justifikuar për nderhyrje ex-ante apo jo. Nga analiza e tre kritereve rezultoi se asnjë prej tyre nuk plotësohet dhe në përputhje me rregulloren e analizës së tregut dhe rekomandimet e KE, tregu me pakicë i aksesit/thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse nuk plotëson testin e tre kritereve dhe nuk konsiderohet si treg i justifikueshem për nderhyrje ex-ante. Nder faktorët kryesorë që çojnë në mosplotësimin e këtij testi janë:

- LLU dhe akses bitstream janë dy masa rregullatore për Albtelecom që janë të disponueshme. Gjithashtu AKEP ka propozuar dhe procedurë për thjeshtëzimin e aksesit në tubacione (Draft Rregullore për përdorimin e përbashkët të infrastrukurës pasive) për të reduktuar barrierat në ndërtimin e rrjeteve.
Një operator alternativ e ka me të lehtë të hyjë në treg shkallë shkallë duke u zmadhuar, duke u konsoliduar dhe duke krijuar rrjetin e vet. Një operator alternativ duke kërkuar akses bitstream ose LLU me qëllim ofrimin e broadband, relativisht shumë lehtë mund të zgjerohet edhe në ofrimin e shërbimit të telefonisë si atë të aksesit edhe atë të televizionit duke përdorur teknologji IP
- Të dhënat tregojnë për një konvergjençë të thirrjeve nga rrjetet fikse dhe celulare, si dhe fakti që Telekom Albania ofron shërbim GSM Fiks nepermjet rrjetit celular prej disa vitesh tashmë, tregon se operatorët celulare nuk kanë pengesë për tu futur në ofrimin e shërbimeve nga vendndodhje fikse duke përdorur rrjetet e tyre celulare.

Konkluzione nga Analiza e tregjeve me shumicë

AKEP vlerëson se në perkufizimin e tregjeve perkates të terminimit dhe tranzitimit në rrjetet fikse të mos bëjë ndryshim nga Analiza e tregut në vitin 2013, d.m.th tregjet perkates janë:

- Tregu i terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin Albtelecom, shërbim i ofruar nga sipermarresi Albtelecom sh.a;
- Tregu i terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin publik fikse të operatorit alternativ X, shërbim i ofruar nga sipermarresi X²;
- Tregu i terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin publik Telekom Albania drejt pajtimareve të telefonisë fikse Telekom Albania Fiks, shërbim i ofruar nga sipermarresi Telekom Albania sh.a.;
- Tregu i tranzitimit të thirrjeve zanore në rrjetet fikse, shërbim i ofruar nga sipermarresit e rrjeteve publike telefonike fikse;

²Lista e operatoreve alternative të percaktuar me FNT është dhënë në Aneks 1.

Bazuar ne perfundimin e perkufizimit te tregut perkates ne nivel me pakice, AKEP ne perkufizimin e tregut me shumice te origjinimit te thirrjeve nga vendnodhje fikse ka perfshire edhe origjinimin e thirrjeve nga rrjetet celulare.

Bazuar ne perfundimin e perkufizimit te tregjeve perkatese me shumice te origjinimit dhe tranzitimit te thirrjeve, dhe faktin qe keto dy tregje nuk jane as pjese e listes se tregjeve perkates te Rregullores se Analizes se tregut dhe as pjese e rekomandimit te vitit 2014 te KE per tregjet perkates, AKEP ka kryer testin e 3 kriterëve nese keto dy tregje jane te justifikuar per nderhyrje ex-ante apo jo. Nga analiza e tre kriterëve rezulton se tregu i tranzitimit ploteson testin e tre kriterëve ndersa tregu i origjinimit nuk ploteson testin e tre kriterëve. Nder faktoret kryesore qe cojne ne keto konkluzione jane:

- Bazuar ne perkufizimin e tregut me pakice dhe testin e 3 kriterëve per tregun me pakice, origjinimi i thirrjeve nga vendnodhje fikse duhet te perfshije edhe origjinimin e thirrjeve nga rrjete celulare dhe vetofrimin e tyre. Gjithashtu ne kushtet specifike te Shqiperise ku rreth 80 operatore alternative kane investuar ne rrjetet e tyre fikse, perfshire rrjetet e aksesit, mund te themi qe origjinimi i thirrjeve ne nivel me shumice nuk ndeshet me pengesa te larta jo-kalimtare.
- Ne kushtet e zhvillimit te rrjeteve te telefonise fikse ne Shqiperi ku jane rreth 80 operatore me rrjetet e tyre, Albtelecom eshte i vetmi operator qe ka shtrirje kombetare dhe per shume operator eshte mundesia e vetme per te ofruar sherbime tranzitimi drejt rrjeteve te tjera kombetare, fikse dhe celulare. Ofrimi i sherbimit tranzit kombetar te plote (pa nevojte per tranzitim edhe me nje operator tjetër) kerkon lidhjen/interkonektimin me 80 operatore fikse te shperndare ne shume zona gjeografike ne Shqiperi dhe me secilin nga kater operatoret celulare

Ne vijim te perfundimeve te analizes se tregut ne 2013, AKEP ka rishikuar faktoret per statusin me FNT ne tregjet e sipercituar, duke marre ne konsiderate:

- Pjesen e tregut ne tregjet perkates te analizuar:
 - o Per terminimin e thirrjeve nuk priten ndryshime pasi edhe modeli CPP (Pala Thirrese Pagan) do te vazhdoje te ekzistojte te pakten ne periudhe afatmesme
 - o Per tranzitimin e thirrjeve kombetare Albtelecom vazhdon te kete pjese tregu te larte (mbi 60%)
- Efektet e rregullimit te tarifave te terminimit te OA: Rregullimi i tarifave te terminimit te operatoreve alternative ka shmagur problemet e aplikimit te tarifave te ndryshem per operatore te ndryshem dhe mos-marrveshjet e mundshme per keto tarifa terminimi;
- Nivelin e tarifave te terminimit ne Shqiperi krahasuar me vendet e BE dhe rajonit;
- Shperndarjen gjeografike te rrjeteve te OA dhe nevojten per sherbimet e tranzitimit te thirrjeve kombetare te Albtelecom, si pika e vetme e lidhjes se shume OA me operatoret e tjere telefonike;

Bazuar ne vleresimin e faktoreve per FNT ne tregjet perkatese te terminimit dhe tranzitimit ne rrjete fikse, AKEP vlereson se:

- *Albtelecom sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne:*
 - *tregun e terminimit te thirrjeve drejt pajtimtareve te rrjetit fiks Albtelecom;*
 - *tregun e tranzitimit te thirrjeve kombetare ne rrjetet fikse;*
- *Sipermarresi X permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt pajtimtareve te rrjetit fiks alternativ X;*

- *Sipermarresi Telekom Albania sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt numrave gjeografike ne rrjetin Telekom Albania (drejt pajtimtareve te Telekom Albania Fiks)*³;

Lista me operatorët alternative të propozuar për status me FNT për terminimin në rrjetet e tyre është dhënë në Aneks 1 të dokumentit të analizës. Lista është hartuar duke u bazuar në të dhënat e Rregjistrimit të Autorizimit të përgjithshëm dhe të dhënat e rregjistrimit të AI për sipermarresit e pajisur me numeracion gjeografik Fiks deri më 30.03.2015.

Masat rregulluese për FNT në tregjet me shumice të Interkoneksionit

AKEP gjykon se problemet e tregjeve me shumice të terminimit dhe tranzitimit nga FNT e Albtelecom ruajnë të njëjten natyrë me problemet e identifikuar në analizë 2013, kështu që ndaj operatorit me FNT Albtelecom propozohet që detyrimet aktuale për këto shërbimet me shumice të qendrojnë dhe të vazhdohet implementimi i tyre dhe konkretisht:

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
2. Detyrimi i transparencës, përfshirë publikim të RIO (Neni 40)
3. Detyrimi për ndarjen e llogarive (Neni 41)
4. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
5. Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)

AKEP gjykon që masat rregulluese ndaj operatorëve Alternative dhe të Telekom Albania (Telekom Albania fiks) për FNT në terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre të jenë:

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
2. Detyrimi i transparencës (Neni 40)
3. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
4. Detyrimi për kontroll tarife

Detyrimet e propozuara nuk përfshijnë publikim të RIO-s, si dhe një sërë detyrimesh të tjera të vendosura ndaj Albtelecom. Detyrimi i kontrollit të tarifës përfshin rregullimin nga AKEP të tarifave të terminimit të operatorëve alternative.

Bazuar në zhvillimet e fundit dhe kushtet e tregut të telefonisë fikse në Shqipëri, si dhe zhvillimet në vendet e rajonit dhe BE, AKEP pasi ka shqyrtuar dhe komentet e derguara gjatë konsultimit publik ka vendosur që:

- Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet e operatorëve të rrjeteve fikse të rishikohen me qëllim aplikimin e një tarife të vetme për terminimin e thirrjeve në rrjetet e operatorëve të rrjeteve fikse, pra duke zvogëluar numrin e segmenteve të tarifimit nga 2 në 1 dhe parimin e simetrise.
- AKEP gjykon që të përdorë metodën e rregullimit sipas tarifës mesatare në vendet e BE/rajonit (benchmark) duke përdorur një reduktim të përshkallëzuar (glide path) me tre faza që fillojnë më 1.01.2016, 1.01.2017 dhe 1.01.2018.

³ Në dokument në shumë vende për lehtësi tregu i terminimit të thirrjeve drejt numrave gjeografike fikse të Telekom Albania referohet si drejt pajtimtareve Telekom Albania Fiks.

- Me 1.01.2016 tarifat e terminimit te te gjithë operatoreve te telefonise fikse ne Shqiperi te unifikohen ne nje nivel te vetem (pra tarifa simetrike midis Albtelecom dhe OA) ne vleren 1.48 lek/minute, e njejte me tarifen e terminimit ne rrjetet celulare dhe shume e perafert me tarifen mesatare te dy segmenteve të aplikuara per Albtelecom duke filluar nga 1.09.2014;
- Me 1.01.2018 tarifa e terminimit reduktohet ne nivelin 0.7 lek/minute, qe është sa tarifa mesatare e vendeve të BEREC që aplikojnë një segment dhe sa mesatarja e tre segmenteve në vendet e BEREC dhe BE, më 1.01.2014.
- Tarifimi i tranzitimit ne rrjetin Albtelecom duke filluar nga 1.01.2016 reduktohet ne ne nivelin 0.93 lek/minute dhe me 1.01.2018 ne nivelin 0.44 lek/minute;
- Tarifat e terminimit/tranzitimit ne rrjetein Albtelecom me 1.01.2017 (Faza II) jane sa mesatarja e Fazes I dhe Fazes III, duke krijuar nje reduktim gradual.
- Tarifa për thirrje qe aktualisht eshte ne nivelin 0.38 lek/thirrje hiqet më 1.01.2016.
- Numri i pikave të interkoneksionit (POI) të Albtelecom qëndron në 12 më 1.01.2016 dhe reduktohet në 2 më 1.01.2018.

Reduktimet e propozuara te tarifave te terminimit variojnë nga 41-62% për tarifat e terminimit të thirrjeve në lek/minute dhe 100% për tarifën për thirrje, e cila propozohet të hiqet më 1.01.2016. Tarifa e propozuar për terminim në rrjete fikse në Janar 2018 (0.7 lek/minute) është sa tarifa mesatare e vendeve te BE (BEREC), por më e lartë se tarifa mesatare benchmark sipas LRIC të pastër në rrjete fikse (0.16 lek/minute) e aplikuar në vende të BE, dhe kjo zgjedhje e AKEP është bazuar në karakteristikat e tregut fiks në Shqipëri:

- telefonia fikse ka zhvillim (mbulim dhe përdorim) shumë më të ulët se në vendet e rajonit dhe BE, ndërsa telefonia celulare në Shqipëri ka shumë më tepër karakteristika të ngjashme me vendet e rajonit dhe BE. Këto karakteristika ndikojnë në nivelin e kostove duke cuar në kosto më të larta për njësi në Shqipëri per rrjetet fikse, ndërsa janë të ngjashme për rrjetet celulare në raport me vendet e rajonit dhe BE;
- objektivi për të rritur stimujt për investime/modernizime në rrjetet fikse, jo vetëm për telefoni fikse, por sidomos për akses broadband fiks.

Duke marre ne konsiderate vlerat e tarifave te terminimit deri ne 1.01.2014, ne periudhen kohore prej 4 vitesh (1.01.2014 - 1.01.2018) ndryshimet ne tarifat dhe segmentet e terminimit ne rrjetet fikse jane te medha:

- Reduktim te niveleve te terminimit ne rrjetin Albtelecom nga 3 ne 2 dhe me pas ne 1
- Reduktimi i tarifave te terminimit nga 1.5-3.5 lek/minute ne 0.7 lek/minute, qe perben reduktim me 50-80%;
- Reduktim te numrit minimal te pikave te interkoneksionit (POI) te Albtelecom nga 84 ne 12 dhe me pas ne vetem 2.

Reduktimi i pikave të interkoneksionit të Albtelecom në 1.01.2018, nga 12 në 2, krijon kohë të mjaftueshme për OA për përshtatje me zhvillimet e fundit dhe investimet e Albtelecom, duke krijuar njëkohësisht stimuj për Albtelecom për vazhdimin e investimeve në modernizim

të rrjetit fiks që duhet të sjellë përfitime për gjithë tregun në tërësi, dhe sidomos për përdoruesit fundorë.

Ndryshimet e percaktuara në këto dokument pritet të japin një shtysë të re në konkurrencën në treg për thirrjet telefonike fikse paralelisht me thjeshtëzimin e tarifimit të operatorëve me njëri-tjetrin dhe për pajtimtarët. Reduktimet e tarifave të terminimit në rrjetet fikse janë në linjë edhe me reduktimet e kryera tashmë për tarifën e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare. Këto reduktime synojnë dhe reduktimin e stimulimit për problematikën e tarifave të ndryshme on-net-off-net të ngjashme me tregun celular dhe rrisin stimulimin për tarifim unifik në rrjetet fikse dhe celulare pavarësisht destinacionit të operatorit fiks (brenda/jashtë rrjetit) madje edhe fiks/celular dhe anasjelltas.

De-rregullimi i tregjeve me pakice dhe origjinimit të thirrjeve

Perfundimet e këtij dokumenti të analizës së tregut kanë evidentuar se tregjet perkates të mëposhtem nuk plotesojnë testin e 3 kritereve për nderhyrje ex-ante:

- *Tregu i aksesit në rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse (për pajtimtare familjare dhe jo –familjare);*
- *Tregu i shërbimeve publike telefonike të ofruara nga vendodhje fikse për pajtimtare familjare dhe jo –familjare).*
- *Tregu me shumicë të origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të ofruara nga vendndodhje fikse .*

Në analizën e tregut të vitit 2013 AKEP percaktoi Albtelecom sh.a sipërmarres me FNT edhe në këto tregje duke vendosur dhe detyrime rregullatore perkatese si transparence, mos-diskriminim, ofrim Z(P)B dhe kontroll tarife për origjinimin e thirrjeve por jo për tarifën me pakice, të cilat u derregulluan duke filluar nga 1.01.2014.


Në bazë të percaktimeve të ligjit 9918, rregullores së analizës së tregut dhe direktivave dhe rekomandimeve të BE/BEREC, detyrimet e Albtelecom për FNT në këto tregje të percaktuara në 2013 propozohet të hiqen, dhe heqja e këtyre detyrimeve propozohet të bëhet efektive brenda 6 muajve pas marrjes së vendimit për FNT dhe masat rregulluese për Albtelecom sipas konkluzioneve të versionit final të kësaj analize tregu, pas keshillimit publik. Heqja e detyrimeve në tregun me pakice percaktohet të bëhet efektive me 1.01.2016, ndërsa heqja e detyrimeve për origjinimin e thirrjeve do të bëhet efektive me 1.05.2016.

II. HYRJE

II.1. Panorame e sektorit të telefonisë fikse

Ne sektorin e telefonisë fikse ofrojnë shërbim rreth 80 operatore, dhe numri i pajtimtareve të telefonisë fikse në fund të vitit 2014 ishte rreth 236 mijë, që përben një rënie me rreth 16% në krahasim me vitin 2013. Siç vihet re edhe nga Figura II.1 numri i pajtimtareve të telefonisë fikse ka filluar të reduktohet në vitin 2012 dhe ka pasur një rënie të vazhdueshme në katër vitet e fundit. Rënie më të theksuar e ka pësuar numri i pajtimtareve të Albtelecom, megjithatë dhe numri i pajtimtareve të operatoreve alternative ka pësuar rënie, por për shkak edhe të mënyrës së matjes/raportimit të tyre (shiko seksionin III.1). Tendencë në ulje e numrit të pajtimtareve të telefonisë fikse vazhdon të ndjehet tendencat e vendeve të BE, megjithatë norma e penetrimit të telefonisë fikse (rreth 9%⁴) në Shqipëri vazhdon të jetë shumë më e ulët krahasuar me vendet e BE (me një mesatare prej rreth 39.2%) dhe vendet e rajonit. Albtelecom vazhdon të zotërojë rreth 77 % të këtij tregu me rreth 183 mijë pajtimtarë ndërsa operatorët alternativë rreth 23 % me rreth 65 mijë pajtimtarë.

Figura II.1 Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2014




Një pjesë e madhe e operatoreve alternative janë të vegjël dhe me prani shumë të kufizuar rrjeti. Në fund të vitit 2014, u vu re se operatorët Abcom, ASC, Nisatel, janë operatorët alternativë që vazhdojnë të jenë më të mëdhenj dhe që zotërojnë rreth 67 % të numrit të pajtimtareve të telefonisë fikse të operatoreve alternative, apo e shprehur përmbi numrin total të pajtimtareve rreth 17 %. Abcom dhe Nisatel rezultojnë të jenë dy prej operatoreve të cilët, pavarësisht rënies që ka ky segment tregu, kanë pasur rritje të numrit të pajtimtareve në 2014 krahasuar me fundvitin e 2013, respektivisht me 14% dhe 29%.

Ecuria e përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse tregon për një reduktim të ndjeshëm jo vetëm në teram të numrit të pajtimtareve por edhe në teram të trafikut telefonik nga rrjetet fikse dhe përdorimit mesatar të thirrjeve telefonike nga rrjetet fikse. Këto tendencë janë në drejtim të kundërt me ato të telefonisë celulare. Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e numrit të përdoruesve të telefonisë fikse dhe celulare (karta SIM) për periudhën 2000-2014 ku mund të vihet re se numri i pajtimtareve të telefonisë fikse ka pasur rritje të moderuar në 2000-2011, por në të njëjtën periudhë telefonia celulare ka pasur rritje shumë here më të madhe.

⁴ Numri i pajtimtareve për 100 banorë. Numri i banorëve në Shqipëri i referohet të dhënave të Instat për numrin e popullsisë (për vitin 2011 e në vijim sipas Census 2011).

Figura II.2 Ecuria e numrit te perdoruesve të telefonisë celulare dhe fikse 2010-2014



Ndryshimet midis zhvillimeve te telefonise celulare dhe asaj fikse, po rrjeteve celulare dhe rrjeteve fikse ne teresi, vihen re edhe ne peshen ne te ardhurav midis dy llojeve te rrjeteve. Të ardhurat totale të sipërmarrësve ne tregun e komunikimeve elektronike për vitin 2014 ishin rreth 42 miliard lek, e cila perben nje renie rreth 17% ne krahasim me 2013. Renia e te ardhurave te sektorit ka ardhur kryesisht nga renie e te ardhurave te operatoreve celulare. Peshen kryesore vazhdojne te ketyre te ardhurave vazhdojne ta zene ato qe vijne nga rrjetet celulare, te cilat per 2014 jane 32.3 miliard leke, kundrejt 37.2 miliard leke qe ishin ne vitin 2013. Edhe ne te ardhurat qe vijne nga rrjete fikse (Albtelecom + OA) per vitin 2014, vihet re nje renie, krahasuar me nje vit me pare, nga 13 miliard leke ne rreth 9.7 miliard lek. Per vitin 2014 Altelecom fiks ka pesuar nje renie te te ardhurave ne krahasim me vitin 2013 prej 33%, edhe operatorevet alternative kane pesuar nje renie, por me te moderuar duke iu referuar periudhes te siperpermendur, prej 12%. Grafiket e meposhtem japin nje panorame me te qarte ne lidhje me ecurine e te ardhurave per sektorin e komunikimeve elektronike.

Figura II.3. Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve Elektronike 2014





Figura II.4. Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve Elektronike (2008-2014)



II.2 Percaktimi i sipermarresve me Fuqi te Ndjeshme ne Treg

1. Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator

Ligji 9918, ne nenin 1 te tij, percakton se qellimi i ligjit eshte qe nepermjet parimit te asnjanesise teknologjike te promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 7 i Ligjit 9918, Objektivat Rregullatore, percakton midis te tjerave:

AKEP-i nxit konkurrencën eficiente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera:

a) për t'u krijuar mundësinë çdo kategorie përdoruesish të shërbimeve të komunikimeve elektronike, përfshirë edhe përdoruesit me aftësi të kufizuara, të kenë përfitime maksimale nga aksesit në shërbimet e komunikimeve elektronike, në kuptimin e zgjedhjes së çmimit dhe cilësisë;

b) për të mbrojtur interesat e përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të mbrojtur të dhënat personale dhe privatësinë e përdoruesve;

c) për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në sektorin e komunikimeve elektronike;

d) për të siguruar integritetin dhe sigurinë e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike;

dh) për të nxitur investimet eficiente në infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe zhvillimet e reja teknologjike për një cilësi të lartë të produkteve të tyre;

ë) për të siguruar mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Kapitulli VI, Rregullimi i Konkurrencës, permban percaktimet per rregullimin e konkurrencës ne tregun e komunikimeve elektronike, dhe perfshin ndermjet te tjerave detyrimin e AKEP per kryerjen e analizes se tregut per vleresimin e konkurrencës efektive dhe percaktimin e sipermarresve me fuqi te ndjeshme ne treg. Kreu VI, permban gjithashtu kriteret e perdorura nga AKEP per vleresimin e fuqise se ndjeshme ne treg, detyrimet/masat rregulluese ne rast te gjetjes se FNT.

Pika 4 e nenit 31, parashikon detyrimin për një rregullore për analizën e tregjeve dhe përcaktimin e FNT. AKEP me vendimin Nr.747, datë 17.07.2009, ka miratuar Rregullorën për Analizën e Tregjeve (ne vijim referuara si Rregullorja), e cila u amendua në vitin 2014. Rregullorja e amenduar përcakton midis të tjerave një listë prej 7 tregjesh (lista e tregjeve të rekoandimit të vitit 2007 të KE) për t'u analizuar nga AKEP për FNT, si dhe detyrimin për të kryer analizën e tre kriterëve për tregjet që nuk janë pjesë e rekomandimit me të fundit të Komisionit Europian për tregjet perkates.

Ligji 9918 është në linjë me direktivat e KE të vitit 2003 dhe amendimet e tyre në 2009 dhe metodologjia e analizës së tregjeve e përcaktuar në Ligj dhe në Rregullore, përcakton se AKEP duhet të marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit Europian si dhe BEREC.

Disa nga Rekomandimet dhe udhëzimet e KE-se të marra në konsideratë nga AKEP janë si më poshtë:

- Udhëzuesi e komisionit për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2002/C 165/03) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet të komunikimit elektronik (ne vijim referuar si Udhëzimi i KE)
- Rekomandimi i Komisionit, datë 11 shkurt 2003, për produktet dhe shërbimet përkatëse të tregut brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregullara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2003/311/EC, OJ L 114, 8.5.2003, p. 45)
- Rekomandimi i Komisionit, datë 17 dhjetor 2007 për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2007/879/EC, OJ L 344, 28.12.2007, p. 65)
- Rekomandimi i Komisionit, datë 9 tetor 2014 për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2014/710/EC).

2.Procesi i Konsultimit

Ligji Nr.9918, parashikon në Nenin 35 të tij, procedurën e keshillimit me paletë e interesit për analizën e tregut duke vendosur si afat një periudhë kohore prej 60 ditësh. Njekohesisht nëni 36 përcakton se AKEP vendos, ndryshon, mban ose heq detyrime për FNT pas keshillimit me paletë e interesuara. Dokumenti për konsultim publik u publikua në faqen e Internetit të AKEP më 25.06.2015 dhe periudha e keshillimit publik perfundoi më 15.09.2015. Në perfundim të keshillimit publik në AKEP janë depozituar komente nga katër operatorë si dhe nga Autoriteti i Konkurrencës. Në Aneks 2 të këtij dokumenti final të analizës AKEP ka dhënë një përmbledhje të komenteve të derguara nga paletë e interesuara si dhe qëndrimin e AKEP për komentet.

3. Bashkepunimi me Autoritetin e Konkurrencës

Sipas Nenit 38 të Ligjit 9918 AKEP duhet të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës. Gjithashtu AKEP dhe Autoriteti i Konkurrencës kanë nenshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me datë 29.08.2007, ku midis të tjerave “Neni 6”, parashikon bashkepunimin midis dy autoriteteve për përcaktimin e tregut, përcaktimin e dominancës / përcaktimi i FNT. Ne vijim të parashikimeve të Ligjit 9918 dhe memorandumit të bashkepunimit midis dy institucioneve, AKEP me publikimin e dokumnetit për keshillim publik i kerkoi AK të shprehe opinionin e vet në lidhje me dokumentin e nxjerre në keshillim publik. Autoriteti i Konkurrencës (AK) me shkresën nr. 307/1 prot., datë 16.09.2015 (referenca e AKEP: nr. 542/11 prot., datë 18.09.2015) ka shprehur dakortesinë me perfundimet dhe propozimet e AKEP për analizen e tregut.

4. Struktura e Dokumentit

Ky dokument përmban analizen e tregjeve me pakice të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjeve me shumice të origjinimit, terminimit dhe tranzitimit në rrjete fikse:

- 1) Tregu i aksesit në rrjet publik telefonik nga vendndodhje fikse;
- 2) Tregu i thirrjeve telefonike të vlefshme për publikun nga vendndodhje fikse.
- 3) Tregu me shumice të origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të ofruara nga vendndodhje fikse .
- 4) Tregu me shumice të terminimit të thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse.
- 5) Tregu me shumice të shërbimeve transite në rrjetet telefonike publike fikse.

Kjo analizë e tregjeve të telefonisë fikse është në vijim të analizës së vitit 2013, procesi i cili perfundoi me publikimin e versionit final të Analizës së Tregut të Telefonisë Fikse në Korrik 2013 (në vijim referuar Analizë 2013), dhe Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP, për shpalljen me FNT të:

- Albtelecom në tregjet perkates:
 - *Tregu me pakice të aksesit në rrjet publik telefonik nga vendndodhje fikse (për pajtimtare familjare dhe jo –familjare);*
 - *Tregu me pakice të shërbimeve publike telefonike të ofruara nga vendndodhje fikse për pajtimtare familjare dhe jo –familjare).*
 - *Tregu me shumice të terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik Albtelecom të ofruar nga vendndodhje fikse.*
 - *Tregu me shumice të origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të ofruara nga vendndodhje fikse.*
 - *Tregu me shumice të shërbimit tranzit kombëtar në rrjetet telefonike publike të ofruara nga vendndodhje fikse,*
- 77 Operatoreve alternative në
tregun me shumice të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetet individuale të tyre.
- Sipermarresi Albanian Mobile Communications sh.a në

Tregun me shumice te terminimit te thirrjeve ne rrjet publik telefonike Telekom Albania drejt numrave gjeografike te ofruara nga vendndodhje fikse (per pajtimtaret e Telekom Albania Fiks).

Duke qene se kjo analize per telefonine fikse eshte ne ciklin e katert te saj, per efekt mosperseritje te argumenteve te njejte, lexuesit i jepen referenca me analizat e meparshme te tregut te telefonise fikse. Ky version per keshillim i Analizes eshte perditesuar me te dhenat me te fundit te tregut per Shqiperine, vendet e rajonit dhe BE.

Kapitulli III permban analizen e tregjeve me pakice duke bere fillimist nje analize te zhvillimev te tregut te telefonise fikse dhe tendenace te tij, dhe me pas kryhet perkufizimi i tregut perkates dhe testi i 3 kriterëve.

Kapitulli IV analizon tregjet me shumice te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit, duke u fokusuar ne ecurine e tarifave te terminimit ne Shqiperi dhe vendet e BE, testin e 3 kriterëve per origjinimin dhe tranzitimin e thirrjeve si dhe statusin me FNT ne keto tregje.

Masat rregullatore per FNT ne tregjet e evidentuara trajtohen ne kapitullin V, duke u fokusuar me shume ne rregullimin e tarifave te terminimit ne rrjetet fikse.

5. Perkufizimi i tregut perkates

Ne kuader te analizave te kryera nga nje rregullator per qellime te analizes se konkurrences efektive dhe percaktimit te sipermarresit/sipermarresve me FNT, analiza e nje tregu perkates fillon me shqyrtimin e produkteve dhe sherbimeve qe konsiderohen te jene pjese e te njejtit treg.

Ne Analizat e meparshme AKEP ka perdorur perkufizimin e tregut perkates te dhene ne Rregulloren e Analizes se Tregut, perkufizim i marre nga Ligji per Mbrojtjen e Konkurences:

***Treg perkates-** jane produktet qe vleresohen si te zevendesueshme nga konsumatorët ose klientët e tyre, per sa u perket karakteristikave, çmimit dhe funksionit te tyre dhe qe ofrohen ose kerkohen nga ndermarrjet ne nje zone gjeografike me kushte te njejta konkurrençe, zone kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese.*

Ky perkufizim i Ligjit nr.9121, date 28.7.2003 “Per Mbrojtjen e Konkurrences” i ndryshuar, neni 3, pika 7, eshte i ngjashem me perkufizimin e dhene ne Udhezimin e KE, pika 44⁵, udhezim i perdorur nga AKEP ne Analizat e meparshme te tregut. Per kete arsye si dhe duke qene se udhezimi i KE, eshte pjese e dokumentave te KE te referuara ne Rregulloren per analizen e tregut, AKEP ne kete Analize do te perdore te njejten metodologji per percaktimin e produkteve/sherbimeve qe jane pjese e te njejtit treg perkates, si dhe ne Analizat e meparshme, sic eshte shtjelluar dhe ne paragrafet ne vijim.

⁵ According to settled case-law, the relevant product/service market comprises all those products or services that are sufficiently interchangeable or substitutable, not only in terms of their objective characteristics, by virtue of which they are particularly suitable for satisfying the constant needs of consumers, their prices or their intended use, but also in terms of the conditions of competition and/or the structure of supply and demand on the market in question (32). Products or services which are only to a small, or relative degree interchangeable with each other do not form part of the same market (33). NRAs should thus commence the exercise of defining the relevant product or service market by grouping together products or services that are used by consumers for the same purposes (end use).

Perkufizimi i tregut per nje produkt/sherbim merr parasysh efektin e zevendesueshmerise se produktit/sherbimit (ne anen e kerkeses dhe ofertes), si edhe dimensionin gjeografik. Nje instrument ndihmes qe perdoret per identifikimin e tregjeve eshte parimi i monopolistit hipotetik.

Parimi i monopolistit hipotetik

Nje produkt konsiderohet te perbeje nje treg me vete nese “monopolisti” (hipotetik) qe ofron produktin mund te rrise çmimin e ketij produkti per nje periudhe kohe jo tranzitore dhe te mos kete renie ne shitje deri ne nivelin qe kjo te jete jo- fitimprurese. Pra, rritja e çmimit duhet te jete fitimprurese dhe e qendrueshme-monopolisti te kete aftesine te mbaje çmimin mbi nivelin konkurrues.

Testi i monopolistit hipotetik kryhet per te analizuar produktet/sherbimet te cilat mund te bejne pjese ne te njejtin treg duke marre ne konsiderate efektin e zevendesueshmerise se produkteve ne anen e kerkeses dhe/ose ofertes. Nese monopolisti perballet me kufizime nga ana e kerkeses- konsumatorët do te zhvendosen drejt konsumit te nje produkti tjetër, qe do ishte zevendesues dhe, nga ana e ofruesve- ofrues te tjere do te futeshin ne kete treg per te ofruar produktin me çmim dhe perfitim te larte, atehere produktet e tjera qe jane zevendesues te ngushte te produktit te analizuar duhet te perfshihen ne kete treg.

Zevendesimi ne anen e kerkeses

Nese nje subjekt, qe eshte monopol ne ofrimin e nje produkti/sherbimi, do te rriste çmimin e ketij produkti, çfare mundesish kane konsumatorët te zevendesojne perdorimin e ketij produkti me nje tjetër ?

Produkti/sherbimi qe analizohet krahasohet me produkte te tjere, nese ato mund te zevendesohen nga ana e konsumatorit. Nese konsumatorët mund te zevendesojne produktin e ofruar nga monopolisti hipotetik me nje produkt apo produkte te tjera, keto te fundit duhet te perfshihen ne perkufizimin e tregut perkates.

Zevendesimi ne anen e ofertes

Nese monopolisti hipotetik do te rriste çmimin e produktit/sherbimit per nje periudhe kohe jo tranzitore, a do te kishte presion nga ofrues te tjere te mundshem te ketij sherbimi? Operatore te tjere, te cilet nuk e ofrojne sherbimin ne fjale, mund te zhvendosin burimet e tyre ne drejtim te ofrimit te ketij sherbimi.

Ne zevendesimin ne anen e ofertes duhet te merren parasysh vetem operatore, te cilet mund te zhvendosin burimet e tyre drejt ofrimit te sherbimit te marre ne konsiderate, per nje kohe te shkurter dhe pa kosto te larta te pakthyeshme. Pra, operatore te rinj qe nuk jane ne treg nuk mund te merren parasysh, pasi reagimi i tyre ndaj nje rritjeje te çmimit te produktit nuk do te ishte i shpejte (ne periudhe afatshkurter), por do te kerkonte kohe per investime kapitale qe kerkojne nje periudhe afatgjate. Ofruesit e mundshem jane operatore qe ofrojne sherbime te tjera dhe lehtesisht per nje periudhe kohe te shkurter mund te prodhojne edhe produktin, çmimi i te cilit eshte rritur.

Efekti i operatoreve te rinj ne treg, qe duhet te kryejne investime kapitale, merret ne konsiderate vetem ne analizen e fuqise se ndjeshme ne treg, pra te konkurrences se mundshme qe keta operatore mund te ushtrojne.

Kufizime te perbashketa ne tarifim

Nje faktor tjetër që merret në konsideratë në perkufizimin e tregut perkates është nëse ekzistojnë kufizime të përbashkëta në tarifim (common pricing constraints) midis klienteve, shërbimeve apo zonave të ndryshme. Kjo do të thotë që operatori të mos jetë i pavarur në tarifimin e shërbimeve të ndryshme: s'ka mundësi të rrisë çmimin e një shërbimi pa reduktuar çmimin e një shërbimi tjetër, i cili në vetevetë nuk është zëvendësues për shërbimin tjetër.

6. Fuqia e Ndjeshme në Treg dhe masat rregulluese

Pekufizimi i FNT është dhënë në nenin 33 të ligjit:

Një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm, apo së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.

Ky perkufizimi është pothuajse i njëjti me perkufizimin e Direktives Kuader të KE 2002, neni 14⁶ (EC 2002 Framework Directive).

Neni 33 i Ligjit përcakton gjithashtu kriteret kryesore që duhet merren në konsideratë për analizën për FNT, duke bërë një ndarje për rastet kur në treg dyshohet për një sipërmarrje me FNT, që do të thotë dominancë individuale, dhe për raste kur dyshohet për më shumë se një sipërmarrje me FNT apo dominancë e bashkuar. Perkufizimi i dominancës së bashkuar i dhënë në nenin 33 është si vijon:

Dy ose më shumë sipërmarrës vlerësohen se kanë një pozitë zotëruese nëse edhe në mungesë të lidhjeve strukturore apo të lidhjeve të tjera, veprojnë në treg në një strukturë dhe mënyrë të tillë, e cila të çon në një sjellje të bashkërenduar, në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët ose përdoruesit.

Për përcaktimin e FNT, dominancë individuale apo e bashkuar, siç theksohet dhe në pikat 79 dhe 98 të Udhezimit të KE, kriteret e përdorur duhen marrë të gjithë në konsideratë dhe në kombinim me njëri tjetrin dhe jo në mënyrë të veçantë për secilin kriter me vetë, pasi evidenca e kriterëve të veçantë mund të mos jetë përcaktuese e FNT.

Analiza krahas shqyrtimit të kriterëve për vlerësimin e konkurrencës efektive në treg në të kaluarën, bën vlerësimin se si pritët të evoluojë tregu në të ardhmen. Analiza kryhet për të shqyrtuar nëse një treg perkates vlerësohet të jetë në konkurrencë efektive në një periudhë të paktën 2 vjeçare, dhe mungesa e konkurrencës efektive në një treg perkates të justifikueshem për nderhyrje ex-ante është e barazvlefshme me ekzistencën e fuqisë së ndjeshme në treg, prej një ose më shumë sipërmarrësish.

Ekzistenca e FNT do të thotë që në treg ka probleme të cilat identifikohen dhe në bazë të problemeve të evidentuara, propozohet marrja masave rregulluese apo detyrimeve për të zbatuar nga sipërmarrësi/sipërmarrësit me FNT. AKEP në bazë të nenit 34, ka detyrimin që në rast të gjetjes së FNT në një treg perkates të vendosë një disa apo të gjitha detyrimet e

⁶“an undertaking shall be deemed to have significant market power if, either individually or jointly with others, it enjoys a position equivalent to dominance, that is to say a position of economic strength affording it the power to behave to an appreciable extent independently of competitors customers and ultimately consumers”

cilesuara ne nenet 39-45 dhe neni 56 te Ligjit. Vendosja e detyrimeve/masave rregulluese per FNT duhet te marre ne konsiderate objektivat rregullatore te percaktuar ne Ligj.

Nese nga analiza arrihet ne perfundimin se tregu perkates eshte ne konkurrence efektive, pra nuk ka FNT, atehere AKEP nuk vendos detyrime dhe ne rast se ndaj sipermarrsve jane vendosur detyrime (per shkak te statusit te meparshem me FNT) atehere AKEP i heq keto detyrime duke percaktuar dhe nje afat kohor jo me te gjate se 6 muaj per berjen efektive te tyre. Ky percaktim aplikohet edhe per tregjet e analizuara, por qe nuk permbushin testin e tre kritereve per nevojen per nderhyrje ex-ante.

III. ANALIZA E TREGJEVE TE SHERBIMEVE ME PAKICE

III.1. Zhvillimet e tregut me pakice te telefonise fikse

Ne analize 2013 AKEP percaktoi Albtelecom si operator me FNT ne tregjet perkates me pakice te meposhtem:


- Tregu i aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse (per pajtimtare familjare dhe jo –familjare);
- Tregu i sherbimeve publike telefonike te ofruara nga vendodhje fikse per pajtimtare familjare dhe jo –familjare).

Ne kete kapitull paraqiten ndryshimet kryesore qe kane ndodhur ne tregun me pakice te ofrimit te sherbimeve te telefonise fikse ne vitet fundit qe nga analiza e viti 2013 dhe efektet qe ato kane pasur ne treg, sidomos ne dominancen apo FNT ne treg te Albtelecom.

1. Tendencat e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse

Numri i pajtimtareve te telefonise fikse ne fund te vitit 2014 ishte rreth 236 mije, qe perben nje rnie me rreth 16% ne krahasim me vitin 2013. Sic vihet re edhe nga figura e meposhteme numri i pajtimtareve te telefonise fikse ka pasur rritje te moderuar te qendrueshme ne vitet 2000-2011, ndersa ka filluar te kete rnie te shpejte duke filluar nga viti 2012. Reduktimi i numrit te pajtimtareve ne tre vitet e fundit eshte vene re si per Albtelecom dhe per operatoret alternative.


Figura III.1 Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2014



Tendenca ne ulje e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse vazhdon te ndjehet tendencat e vendeve te BE, megjithate norma e reduktimit duket se eshte me e shpejte si dhe ne ky reduktim ndodh kur norma e penetrimit e telefonise fikse prej 9%⁷ ne Shqiperi eshte shume me e ulët krahasuar me vendet e BE, ku norma mesatare e penetrimit te telefonise fikse eshte rreth 39.2% (sipas ITU). Sipas grafikut te meposhtem vihet re se norma e penetrimit te telefonise fikse ne Shqiperi ne 2014 eshte me e ulet edhe se mesatarja e vendeve ne zhvillim.

⁷ Numri i pajtimtareve per 100 banore. Numri i banoreve ne Shqiperi i referohet tedhenave te INSTAT per numrin e popullsise (per vitin 2011 e ne vijim sipas Census 2011).

Figura III.2 Ecuria e normes se peneterimit te telefonise fikse: Shqiperia v Bota



Burimi: ITU dhe AKEP

Tabela e meposhteme paraqet ecurine e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse te operatoreve kryesore te rrjeteve fikse per periudhen 2010-2014. Altelecom në fund të vitit 2014, kishte rreth 183 mijë pajtimtarë qe perben nje reduktim me 18% ne krahasim me vitin 2013, dhe nje renie me 34% krahasuar me vitin 2010.

Tabela III.1: Ecuria e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse sipas operatoreve (2010-2014⁸)

	Altelecom	Abcom	ASC	Nisatel	Telekom Albania Fiks	OA te tjere	Total
2010	277,763	19,975	7,408	5,900	NA	20,456	331,502
2011	258,943	27,167	10,129	4,950	7,565	30,090	338,844
2012	230,397	33,000	7,649	5,500	6,119	28,996	311,661
2013	210,382	13,680	15,047	7,166	6,950	27,975	281,200
2014	182,591	15,531	3,987	9,423	2,550	21,652	235,734
Ndryshimi 2014/2013	-13%	14%	-74% ⁹	31%	-63%	-23%	-16%

Abcom dhe Nisatel kane rritjen me te madhe vjetore ne 2014 me 14% dhe 31% respektivisht. Abcom vazhdon te mbaje poziten e operatorit me te madh alternativ fikse te telefonise fikse i ndjekur nga Nisatel. Numri i pajtimtareve te operatorëve alternative per 2014 ishte rreth 53 mijë dhe perben nje renie me 25% krahasuar me vitin 2013.

Nje faktor qe ka ndikuar ne reduktimin e numrit te pajtimtareve te operatoreve alternative ne dy vitet e fundit eshte edhe menyra e matjes dhe raportimit te tyre:

⁸ Ne 2014 u perdor per here te pare matja e pajtimtareve sipas pajtimtareve aktive, ndaj mund te kete shmangje te vlerave nga raportim i QIV 2014.

⁹ Ne raportin QIV 2014, per ASC u perdor "Numri i linjave të pajtimtarëve të telefonisë fikse" i fundvitit 2013, kurse ne kete analize u saktesua dhe u perdor sipas perdoruesve aktive ne fund te 2014.

- Abcom si operatori alternativ me i madh ka raportur reduktim te ndjeshem te numrit te pajtimtareve te telefonise fikse ne vitin 2013 (rreth 14 mije krhasuar me 33 mije ne 2012). Abcom është një operator kabllor dhe shërbimi telefonik ofrohet bashkë me shërbimin e internetit. Për vitet e mëparshme numri i pajtimtarëve telefonikë raportohej i barabartë me ata të internetit. Duke filluar nga gjashtëmujori i parë 2013, Abcom konsideron si pajtimtarë telefonikë vetëm ata pajtimtarë që e përdorin apo paguajnë vecmas për shërbim telefonik.
- Per vitin 2014 ne ndryshimet e perkufizimeve te treguesve statistikore, AKEP perfshiu perkufizimin e perdoruesit aktiv te telefonise fikse per perdoruesit me parapagim: perdorues me parapagim te telefonise fikse qe kane perdorur sherbimin telefonik fikse te pakten nje here gjate tre muajve te fundit. Telekom Albania dhe ASC jane dy operatore qe ofrojne sherbim telefonik fikse dhe me parapagim, dhe vihet re se keta dy operatore kane renien me te madhe ne 2014 me 63% dhe 74% respektivisht.

Tabela e meposhteme paraqet nje perditestim per ecurine e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse ne tre tremujoret e fundit.

Tabela III.2: Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse QIV/2014-QII/2015

Numri i linjave të pajtimtarëve të telefonisë fikse	Albtelecom	Abcom	ASC	Nisatel	Telekom Albania Fiks	OA te tjere	Total
QIV_2014	182,591	15,531	3,379	9,236	2,550	22,385	235,672
QI_2015	175,167	12,615	4,243	9,236	2,142	20,244	223,647
QII_2015	171,568	13,969	4,306	9236*	6,066	22,818	227,963
Ndryshimi QII_2015/QIV_2014	-6%	-10%	27%	0%	138%	2%	-3%

Nga te dhenat vihet re se gjate kesja periudhe ka vazhduar tendenca renese e numrit te pajtimtareve te Albtecom dhe tregut ne teresi. Telekom Albania rezulton te kete pasur nje rritje te konsiderueshme te numrit te pajtimtareve Telekom Albania fikse ne tremujorin e II-te 2015.

Të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë se rreth 41% e të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse janë në Tiranë. Qarqet me penetrim më të madh të telefonisë fikse janë Tirana, Vlora, Gjirokastra dhe Korca me 11-13.4%, ndërsa qarqet me penetrim më të ulët janë Kukësi dhe Dibra me më pak se 3%.

Figura III.3: Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse sipas qarqeve 2014






Figura III.4: Norma e penetrimit e linjave të telefonisë fikse sipas qarqeve 2014



2. Ecuria e trafikut telefonik

Figura e mëposhtme parqet ecurinë e trafikut telefonik të thirrjeve dalëse të pajtimtarëve të telefonisë fikse të Albtelcom dhe operatorëve celularë në periudhën 2003-2014. Nga të dhënat rezultojnë se trafiku telefonik i pajtimtarëve të Albtelcom ka reduktime të ndjeshme në tre vitet e fundit: nga nivele rreth 570 milion minuta në 2012 në vetëm 190 milion minuta në 2014. Siç mund të vihet re nga figura e mëposhtme, rënia e thirrjeve nga rrjetet fikse është shoqëruar me rritje të ndjeshme të sasive të thirrjeve nga rrjetet celulare që në 2014 ishte rreth 7.3 miliard minuta. Sasia totale e thirrjeve nga rrjetet fikse (Albtelcom dhe OA) në 2014 ishte rreth 220 milion minuta, dhe kjo përben vetëm 3% të thirrjeve totale nga rrjetet fikse dhe celulare së bashku.


Figura III.5: Ecuria e thirrjeve nga rrjetet fikse dhe celulare 2010-2014



3. Pjeset e Tregut

Figura e meposhteme paraqet ecurine e pjeseve te tregut per numer pajtimtaresh te telefonise fikse te Albtelecom dhe operatoreve alternative per periudhen 2010-2014.

Figura III.6: Pjeset e tregut te numrit të pajtimtarëve të telefonise fikse (2010-2014)



Ne tabelen e meposhtme paraqiten pjeset e tregut per aksesin dhe thirrjet telefonike dales ne total, per periudhen 2007-2014 per sherbimet e telefonise fikse, per numrin e pajtimtareve ne total, volumin e trafikut dales ne total, si dhe pjeset e tregut per volumin e te ardhurave ne total te klasifikuar per Albtelecom dhe Operoret Alternative (perfshire edhe Telekom Albania Fiks).

Tabela III.3 Pjeset e tregut te treguesve kryesore te telefonise fikse 2007-2014

Treguesit e pjeseve te tregut		2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Pajtimtare	Alternative	12%	13%	13%	16%	24%	26%	25%	23%
	Albtelecom	88%	87%	87%	84%	76%	74%	75%	77%
Trafiku dales	Alternative	7%	7%	11%	6%	8%	11%	20%	14%
	Albtelecom	93%	93%	91%	94%	92%	89%	80%	86%
Te Ardhura	Alternative	5%	5%	7%	18%	16%	24%	28%	35%
	Albtelecom	95%	95%	93%	82%	84%	76%	72%	65%

Nga te dhenat e tabelës dhe figures vihet re se:

- Pjesa e tregut te Albelecom per pajtimtare nuk ka ndryshime te medha ne tre vitet e fundit duke qendruar ne nivele 74-77%. Gjithsesi rritja e pjeseve se tregut te

Albtelecom ne 2014 duhet shqyrtuar me ndryshimet ne menyren e matjes se pajtimtareve te telefonise fikse ne 2014 (seksioni me siper);

- Pjesa e tregut te Albtelecom per thirrjet dalese nga 2012 ne 2014 ka luhatej nga 80-89%.
- Pjesa e tregut te Albtelecom ne te ardhura eshte reduktuar nga 76% ne fund te vitit 2012 ne 65% ne fund te vitit 2014

Tabela e meposhteme paraqet ecurine e pjeseve te tregut per numrin e pajtimtareve te telefonise fikse per tre tremujoret e fundit.

Tabela III.4 Pjeset e tregut te numrit te pajtimtareve te telefonise fikse QIV/2014-QII/2015

	Albtelecom	Abcom	ASC	Nisatel	Telekom Albania Fiks	OA te tjere
QIV_2014	77%	7%	1%	4%	1%	9%
QI_2015	78%	6%	2%	4%	1%	9%
QII_2015	75%	6%	2%	4%	3%	10%

Nga te dhenat vihet re se Albtelecom ka pasur renie te pjeses se tregut duke arritur ne 75% ne tremujorin e II 2015.

4. Tarifimi i sherbimeve me pakice

Tendence e viteve të fundit të operatorëve të telefonisë fikse ka qene promovimi i paketave tarifore me përfshirje minutash thirrje telefonike në pajtim mujor (bundles of minutes) si dhe kombinim të shërbimeve të telefonisë dhe aksesit në Internet (bundles of services). Operatorët më të mëdhenj alternative si Abcom dhe ASC tradicionalisht janë ofrues të shërbimeve akses në internet, telefoni dhe transmetim të shërbimeve televizive, dhe ofrojnë dhe paketa të integruara më të tre shërbimet në një shportë dhe me tarifë mujore të përbashkët. Gjatë vitit 2014 edhe Albtelecom filloi ofrimin e paketave trefishe, Telefoni, Internet dhe IPTV, madje edhe paketa me kater sherbime (telefoni fikse, Internet, TV dhe telefoni celulare). Deri në fund të 2014 rreth 20% e pajtimtarëve familjarë me akses broadband të Albtelecom ishin përdorues të paketave 3-fishe (telefoni, Internet dhe IPTV).

AKEP nepermjet analizes se tregut ne 2013 dhe me VKD nr.2337, date 30.07.2013, vendosi qe Albtelecom ka status me FNT ne tregun me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse, por bazuar ne nje sere faktoresh vendosi per heqjen e detyrimit te kontrollit te tarifave me pakice te pajtimtareve, duke filluar nga data 1.01.2014.

Albtelecom gjatë vitit 2014 kreu rritje të tarifave të disa lloje të thirrjeve telefonike dhe tarifës së pajtimit mujor për kategorinë familjare nga 530 lekë/muaj (me TVSH) në 700 lekë/muaj (me TVSH). Rritja e pajtimit mujor u shoqërua me përfshirje të 60 minutave ndërkombëtare dhe minutave brenda rrjetit Albtelecom në kohën off-peak, në pagesën fikse të pajtimit mujor, heqje të tarifës fikse për thirrje si dhe përfshirje të akses në Internet me kapacitet 1GB download. Rritja e pajtimit mujor dhe përfshirja e minutave falas në pajtim

mujor rezultojne te jenë në linjë me mënyrën e tarifimit në vende të tjera të telefonisë fikse dhe që synojnë njëkohësisht të nxisin konsumin e thirrjeve telefonike fikse.

Tabela e meposhteme paraqet nivelin e tarifave te pajtimit mujor per perdoruesit familjare te paketes standard, cfare perfshihet ne pagesen e pajtimit mujor dhe nese ka paketa te tjera opsionale per perdorim te ulet dhe detaje mbi keto paketa. Te dhenat jane per vitin 2013/2014 per vendet e rajonit dhe per Shqiperine eshte perditesuar me ndryshimet e kryera nga Albtelecom ne Qershor 2014 dhe qe jane ende ne fuqi.

Tabela III.5: Krahasim i tarifave te paketes standarde te Albtelecom me vendet e SEE (2013/14)


Shteti	Tarifa standard e pajtimit mujor me TVSH (€)	Vlera e njesive te thirrjeve telefonike te perfshira ne Pajtim mujor		A ka pakete me perdorim te ulet?	Kufizime per paketen me perdorim te ulet	Tarifa mujore e paketes me perdorim te ulet me TVSH (€)	Vlera e njesive te thirrjeve telefonike te perfshira ne Pajtim mujor	
		Sasia e thirrjeve	Vlera nominale per cdo njesi thirrje (€)	Baza e ofrimit?	Sasia e thirrjeve		Vlera nominale per cdo njesi thirrje (€)	
Croatia	9.92	60 minutes	0.039 per minute	Super 30	Vetem per perdorues qe marrin asitence sociale	4.96	-	-
Iceland	12.44	-	-	Nuk ka	-	-	-	-
FYR Macedonia	7.65	-	-	Pjese e sherbimit universal me 4 madle tarifore: 1. Tarife minimale 2. Tarife per persona me aftesi te kufizuara 3. Model me tarifa sociale me parapagim 4. Tarifa per pensioniste	-	4.96	0	2.439
Montenegro	6.07	100 minutes of local off-peak calls	0.022 (19-07h)	Yes (mini package)	Residential users only	3.094	0	-
Serbia	4.51	300 pulses	0.004	Yes. Commercial offer	Fully disabled customers	50% off the regular price	300 pulses	0.004
Turkey	6.44	3,000 minutes of on-net call	-	Yes. Commercial offer	-	5.548	3,000 minutes of on-net call	-
Albania	5.00	Unlimited on-net off-peak calls + 60 international minutes + Internet 1 Mbps	-0.036-0.050 (on-net) (20.00-08.00) - 0.132 Interenaltioanl	None	-	-	-	-
Bosnia & Herzegovina BH Telecom Telekom Srpske HT Mostar	• 5.85 • 6.55 • 7.78	100 minutes of local calls in peak time	• 0.020/min • 0.018/min • 0.016/min	Yes	families of soldiers died in the war, disabled veterans, people with disabilities	2.512	100 minutes of local calls in peak time	• 0.020/min • 0.018/min • 0.016/min
Kosovo*	9.36	2,500	0.046	Yes	-	5.788	75	0.046

Burimi: AKEP dhe Cullen International Report 4, April 2014

Nga tabela mund te vihet re se:

- Tarifa e pajtimit mujor standard e Albtelecom ne nivelin 5 Euro/muaj eshte me uleta ne rajon, pervec Serbise qe e ka 4.5 Euro
- Vendet qe kane pasur Pajtim mujor te ulet si Serbia, Mali i Zi, Maqedonia kane levizur drejt rritjes se tarifes se pajtimit mujor dhe ndryshimet ne Shqiperi te kesaj tarife duken te ngjashme me keto vende (Figura III.6);
- Sasia dhe vlera monetare e thirrjeve te perfshira ne tarifen mujore te Albtelecom jane me te lartat ne rajon (pozitive per perdoruesin). Njekoheesisht ne tarifen mujore te Albtelecom perfshihte dhe akses ne Internet 1Mbps, qe perben perfitim shtese per perdoruesit e kesaj pakete;
- Vlera e tarifes se pajtimit mujor te paketes standarde te Albtelecom eshte ne nivel te ngjashem me tarifen e pajtimit mujor te paketave me perdorim te ulet ne Kroaci, Maqedoni, Turqi dhe Kosove dhe me perfitime ekstra (njesite te thirrjeve dhe aksesit ne Internet) me te medha se ne keto vende.

Figura III.6: Ecuria e tarifës së pajtimit mujor Familjare: Shqipëri dhe SEE 2006-2013/4



Burimi: Cullen International Report 4, April 2014 dhe AKEP .

Nga informacioni me i perditësuar i vitit 2015 i tarifave te operatoreve incumbent ne vendet e rajonit per paketat standard tregon se perseri paketa e Albtelecom eshte nga paketat me Pajtim mujor me te ulet, madje edhe se Serbia qe duket se ka rritur pajtimn mujor krahasur me vitin 2013.

Tabela III.6: Krahasim i tarifave te paketes standarde te Albtelecom me vendet e SEE (2015)

Shteti	Programi	Tarifa (Euro)	Minuta brenda rrjetit	Minuta kombetare
Shqiperia	Paketa baze familjare	5.00	pa limit (off-peak)	60
Serbia	Paketa standarte	5.47	N / A	150
Rumania	Paketa Small	7.26	pa limit	100
	Paketa Medium	10.34	pa limit	200

	Paketa Large	12.54	pa limit	400
Kroacia	Super 60	9.75	60	N / A
	Halo non stop	14.95	pa limit	N / A
	Halo non stop+	16.90	pa limit	N / A
Bosnje Hercegovina	Paketa baze	7.65	150	N / A
	Paketa sociale	2.50	100	N / A
	Phone 15	8.95	200	N / A
	Phone 25	14.92	400	N / A
	Flat BiH	29.84	3000	300
	Senior plus	8.95	150	N / A
Mali i Zi	Tarifne opcije	5	N / A	50*
	Tarifne opcije	9.9	N / A	120*
	Tarifne opcije	19.9	N / A	250*
Kosova	TiKtel 0	3.99	0	N / A
	TiKtel 300	5.49	30	N / A
	TiKtel 1000	7.99	120	N / A
	TiKtel NS	15.99	180	N / A

(*)Shtuar ketyre minuta edhe minuta nderkombetare
Burimi: Kerkimi i AKEP (Qershor 2015)

Tabela e meposhteme paraqet krahasimin e tarifave kryesore te paketes standard Familjare te Albtelecom me operatoret alternative kryesore ne Shqiperi. Sic mund te vihet re nga tabela operatoret alternative kane tarifa pajtimi mujor shume te ulet, madje ASC dhe Telekom Albania ofrojne dhe paketa tarifore me parapagim (Pajtim mujor zero). Karakteristike tjeter e operatoreve Alternative eshte ofrimi falas i thirrjeve brenda rrjetit (te perfshira ne pagesen mujore).

Tabela III.7: Krahasim i tarifave te paketes standarde te Albtelecom me operatoret alternative (2015)

	Albtelecom	Abcom	Abissnet	ASC	Nisatel
Tarifa e abonimit mujor	700	300	200	0	300
Thirrje brenda rrjetit	5-7.5 peak (0 lek off peak)	0	0	0	0
Thirrje drejt rrjete lokale off-net	7	3.5	3.5	3	0
Thirrje drejt fiks kombetare	10.14	7.5	5.5	10	5
Thirrje drejt Celularë kombetare	32 (falas drejt EM)	18	12.5	15	12
Nderkombetar zona I	18.46 (60 minuta falas)	8	7		5

Paketa standarde e cituar “Familjare” është një ndër opsionet e paketave tarifore të Albtelecom, pasi sic është vënë në dukje dhe ne analizen e vitit 2013, Albtelecom ofron një sërë paketash tarifore dhe opsione (shporta me minuta) dhe shporta të integruara me dy, tre apo kater sherbime të komunikimeve elektronike, thirrje telefonike, akses ne Internet, IPTV dhe telefoni celulare.

Shërbimet e integruara dhe alternativat tarifore të Altelecom tregojnë për rritje të fleksibilitetit dhe inovacionit të Altelecom në ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse dhe shërbimeve të reja në kushtet e migrimit drejt rrjetit NGN/NGA të Altelecom. Shërbimet trefishe (Internet, TV dhe Telefoni fikse) tashmë janë shërbimet më atraktive në treg nga Altelecom dhe operatorët e tjerë kryesore alternativë si Abcom, ASC dhe Abissnet.

Presioni konkurrues nga tarifat celulare

Ne analizen 2013 AKEP ka theksuar se Altelecom pervec presionit konkurrues nga operatorët e tjerë fikse ndeshet edhe me presion konkurrues nga operatorët celulare për thirrjet telefonike. Ne vitet e fundit ky presion duket se është rritur akoma me shume, pasi tarifat celulare kanë vazhduar të reduktohen ndjeshëm. Tabela e mëposhtme paraqet të ardhuren mestare për minute të thirrjeve telefonike (ARPM) për periudhën 2010-2014. Ky tregues mat se sa paguajnë mestarisht përdoruesit celulare për një minute thirrje telefonike (pavarësisht destinacionit).

Tabela III.8: Ecuria e ARPM për rrjete celulare 2010-2014

	ARPM (Lek/minute)	ARPM Ndryshimi vjetor (%)
2010	6.49	
2011	5.35	-18%
2012	3.92	-27%
2013	3.13	-20%
2014	2.63	-16%

Shënim: Vlerat pa TVSH

Vlerat e tabelës tregojnë reduktimin e ndjeshëm të shpenzimit mesatar për një minute thirrje nga rrjetet celulare, dhe në vitin 2014 kjo vlerë është 3.2 lek/minute me TVSH. Këto vlera janë të krahasueshme me tarifat nga rrjete fikse, dhe duke marrë në konsideratë lehtësinë me të madhe të kryerjes së thirrjeve nga aparat celular se nga aparat fikse, presioni konkurrues është shumë i madh. Kjo tendencë vihet re sidomos dhe për thirrjet nderkombetare, që tradicionalisht kanë qenë më të lira nga rrjetet fikse. Gjate vitit 2014 dhe aktualisht operatorët celulare kanë ofruar shumë paketa/oferta që përmbajnë tarifa shumë të lira për thirrjet nderkombetare, gjë që ka çuar në rritje shumë të madhe të thirrjeve nderkombetare nga përdoruesit celulare: nga 56 milion minuta në 2010 në 611 milion minuta në 2014.

Perfundim mbi ecurinë e tarifave:

- Evolimi i teknologjisë dhe sjelljes konsumatore në drejtim të paketave të integruara dhe të thjeshta (me përfshirje të minutave në pagesë mujore) janë tregues se Altelecom ndeshet me presion konkurrues nga operatorët e tjerë në tarifimin e shërbimeve telefonike
- Paketa tarifore standarde 'Familjare' e Altelecom ka pasur rritje të pajtimit mujor dhe tarifave të disa lloj thirrjeve por ka përfshirë njëkohësisht minuta konsumi në

pagesen fikse mujor dhe akses ne Internet. Krahasuar me vendet e rajonit kjo pakete rezulton te jete atraktive per shkak te nivelit me te ulet te pajtimit mujor dhe sasise me te madhe te minutave te perfshira ne pagesen fikse mujore.

- Operatoret alternative kryesore kane paketa tarifore standarde qe karakterizohen nga pajtim mujor i ulet (100-300 lek/muaj) si dhe me tarifa zero per thirrjet brenda rrjetit;
- Albtelecom dhe disa operatore alternative ofrojne dhe paketa opsionale me pagese fikse mujore me minuta te perfshira ne pagese fikse
- Ofrimi i paketave dy dhe trefishe eshte karakteristike e operatoreve kryesore te telefonise fikse qe jane njekoheisht dhe operatoret kryesore te ofrimit te aksesit ne Internet.
- Tarifimi i sherbime te telefonise fikse ne disa raste eshte dhe me paketa me parapagim si ASC dhe Telekom Albania.
- Tendenca e tarifave te telefonise fikse ne Shqiperi eshte drejt tarifimit te sherbimeve si edhe ne tregun celular: tarifa me pajtim mujor te ulet ose dhe me parapagim, tarifa shume te lira (falas) brenda rrjetit, paketa dhe oferta te ndryshme me sherbime te integruara.
- Reduktimi i ndjeshem i tarifave celulare ne vitet e fundit ka rritur ne mase te madhe efektin zevendesues te thirrjeve nga rrjete fikse me thirrje nga rrjete celulare.

5. Perdorimi mesatar i thirrjeve telefonike fikse

Nga tabela e meposhteme vihet re se konsumi i thirrjeve dalese eshte ne trend zbrites pervec vitit 2010 ku eshte vene re rritje ne thirrjet dalese totale si dhe ne thirrjet e marra (hyrese), e cila reflektohet edhe tek MOU.

Tabela III.9: Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve te Albtelecom 2010-2014

	2010	2011	2012	2013	2014	Ndryshimi 2014/2012
Thirrje dalese	151	116	106	94	81	-23.6%
Thirrje te marra	204	160	152	147	130	-14.5%
MOU	356	276	258	241	211	-18.2%

Mesatarisht per Albtelecom konsumi i thirrjeve te kryera ne vitin 2014 ishte 81 minuta ne muaj thirrje dalese si dhe 130 minuta ne muaj thirrje te marra dhe krahasuar me 2012 ka nje rnie 23.6% dhe 14.5% respektivisht.

Krahasuar me telefonine celulare vihet re se perdorimi i thirrjeve celulare eshte rritur ndjeshem ne periudhen 2010-2014. Ne vitin 2010 perdoruesit e telefonise fikse konsumonin mesatarisht 356 minuta thirrje ne muaj ndersa perdoruesit e telefonise celulare 234 minuta thirrje ne muaj. Ne vitin 2011 thirrjet e perdoruesve celulare barazohen me thirrjet e perdoruesve te telefonise fikse dhe ne vitin 2014 konsumi i thirrjeve celulare arrin ne 341 minuta ne muaj ndersa i thirrjeve te telefonise fikse ne 211 minuta ne muaj.

Tabela III.10: Perdorimi mesatar mujor i thirrjeve telefonike celulare 2010-2014

	2010	2011	2012	2013	2014	Ndryshimi 2014/2012
Përdorues Aktiv						
Thirrje dalëse	110	130	152	156	172	13%
Thirrje të marra	124	147	168	167	168	0%
MOU	234	277	319	324	341	7%

Te dhenat e mesiperme te konsumit te thirrjeve telefonike tregojne se efekti zevendesues i thirrjeve telefonike fikse me thirrje telefonike celulare eshte prezent, dhe se Albtelecom ndeshet me presion konkurrues jo vetem nga operatoret e tjere te telefonise fikse, por edhe nga operatoret celulare per thirrje telefonike.

6. Portabiliteti i numrit Fiks:

Ky sherbim per telefonine fikse filloi te ofrohet prej muajit Shtator 2012. Kjo lehtesi i krijon mundesine pajtimtareve te operatoreve te telefonise fikse qe te bartin numrin e tyre fiks drejt operatorit qe ata vleresojne si me atraktiv per sherbimet telefonike fikse, pa ndryshuar numrin e telefonit. Ashtu si edhe portabiliteti i numrit celular, implementimi i portabilitetit te numrit fiks ka rritur konkurrencen midis operatoreve dhe perfitimet e perdoruesve fundore. Nga te dhenat e portabilitetit te numrit fiks qe prej fillimit te ofrimit te ketij sherbimi rezulton se:

- Ne total jane portuar rreth 9500 numra telefonik fiks, qe eshte rreth 4% e numrit total te pajtimatreve te telefonise fikse;
- Albtelecom eshte operatori dhenes me i madh me rreth 7700 numra apo rreth 81% te totalit te numrave te portuar;
- Abcom eshte operatori marres me i madh me rreth 6000 numra apo 63% te totalit te numrave te portuar;
- Numri i operatoreve qe kane shkembyer (marre/dhene) numra eshte 17.

Nga sa me siper rezulton se portabiliteti i numrit fiks pervecse ka rritur perfitimet e perdoruesve te telefonise fikse ai ka rritur ndjeshem presionin konkurrues me te cilin Albtelecom ndeshet ne tregun e telefonise fikse nga operatoret e tjere.

7. Faktore te tjere konkurrues

Disa nga faktoret e tjere qe ndikojne ne drejtim te rritjes se konkurrences ne tregun e telefonise fikse dhe reduktimin e dominaces se Albtelecom:

- Z(P)B:
Mundesia e perdoruesve te Albtelecom per perdorimin e Z(P)B per kryerjen e thirrjeve telefonike nepermjet bartesve te thirrjeve rrit perfitimet e tyre. Kjo mundesi tashme eshte e disponueshme prej fundit te vitit 2011, megjithate deri tani asnje operator nuk ka aplikuar per Kod Bartesi dhe perdoruesit e Albtelcom ende nuk kane filluar te nxjerrin perfitim nga ky sherbim. Nje forme e ZB eshte kryera e thirrjeve nepermjet kartave me parapagim te OSHKP-ve, dhe ky sherbim vazhdon te perdoret nga rreth 25 mije pajtimatre te Albtelecom.
- LLU:

Mundesia e perdoruesve te Altelecom per perdorimin e sherbimin LLU, per aksesin ne Internet dhe kryerjen e thirrjeve telefonike nepermjet operatoreve te tjere qe marrin akses ne rrjetin Altelecom per LLU, rrit perfitimet e tyre. Aktualisht ky sherbim eshte prezent ne treg prej viti 2012, dhe tarifat per LLU jane rishikuar (reduktuar) ne analizen e vitit 2014. Megjithese ky sherbim nuk eshte blere nga asnje operator dhe se eshte i fokusuar ne sherbimt broadband, LLU e plote krijon mundesine edhe te ofrimit te thirrjeve per pajtimtaret e Altelecom nga ofrues te tjere te thirrjeve telefonike. Njekohesihet edhe LLU me akses te pjesshme vetem per broadband krijon mundesine e ofrimit te thirrjeve telefonike nepermjet VoB (Voice over Broadband).

- Bitstream:

Detyrimi i Altelecom per bitstream krijon mundesine operatoreve te tjere te ofrimit te aksesit ne Internet pajtimtareve te Altelecom duke mos pasur nevojte per investime ne rrjet backbone dhe akses. Ky sherbim ka filluar te perdoret nga dy operatore dhe rezultojne rreth 1400 linja me akses bitstream. Si edhe LLU ky sherbim megjithese eshte i fokusuar per akses ne Internet krijon mundesine e ofrimit te thirrjeve telefonike nepermjet VoB (Voice over Broadband) nga operatoret e tjere duke perdorur rrjetin e Altelecom.

Faktoret e mesiperm rrisin mundesite e ofrimit te sherbimeve nga operatore te tjere duke perdorur rrjetin e Altelecom pa qene nevoja per investime te medha ne rrjetet e tyre, dhe ne kete menyre rrisin presionin konkurrues ndaj Altelecom jo vetem per sherbime broadband por edhe per telefoni (VoB) duke ndikuar ne reduktimin e dominances se Altelecom per sherbimet telefonike me pakice te thirrjeve telefonike.

8.Konkurrenca e mundshme

Faktoret qe ndikojne ne reduktimin apo eliminimin e dominances se Altelecom ne te ardhmen vazhdon te jete edhe konkurrenca e mundshme qe mund te vije:

- nga operatoret aktuale ne tregun e telefonise fikse.

Abcom dhe Nisatel jane operatore alternativ qe ka pasur rritjen me te madhe te numrit te pajtimtareve ne keto vite:

- Abcom konkurren ne treg me oferta triple play dhe eshte operatori alternativ me shtrirjen me te madhe gjeografike dhe kjo mund te perbeje avantazh ndaj Altelecom. Ne 2014 Abcom pati nje rritje te pajtimtareve prej rreth 14% ne krahasim me 2013.
- Po ashtu edhe Nisatel eshte nje kokurrent potencialisht i forte ndaj Altelecom ne qarkun e Vlores. Ne fund te 2014 kishte nje rritje prej rreth 29% te numrit te pajtimtareve ne krahasim me fundvitin e 2013 dhe pjesa e tregut e Altelecom ne kete qark eshte 52%.
- Me vazhdimin e ofrimit te portabilitetit te numrit fiks qe ne 2012 aftesite konkurruese te operatoreve alternative normalisht vine ne rritje. Jane portuar gjithsej 9520 numra.

Karakteristike e tregut te telefonise fikse ne Shqiperi eshte ofrimi i sherbimeve te telefonise fikse nga nje numer i madh operatoresh (rreth 80) te cilet kane rrjetet e veta te telefonise, perfshire rrjet aksesi per lidhej direkte me perdoruesin fundor. Keta operatore jane te shperndare gjeografikisht ne Shqiperi dhe shumica kane prezenca lokale te kufizuar. Megjithate prezenca lokale e operatoreve rrit aftesite konkurruese te ketyre operatoreve per shkak edhe te njohjes me te mire te tregjeve lokale. Numri i operatoreve

alternative sipas qarqeve varion nga 3 deri ne 15 (Tirane), dhe Albtelecom ne disa qarqe si Vlore dhe Shkoder eshte 52-63%.

- Nga operatoret celulare.

Konkluzioni i perkufizimit te tregut perkates ne vitin 2013 ishte qe aksesit/thirrjet telefonike nga rrjete celulare nuk jane pjese e te njejtit treg perkates me aksesin/thirrjet telefonike nga vendndodhje fikse pasi nuk mund te konsiderohen zevendesues te afert. Megjithate AKEP vlereson se midis sherbimeve ka zevendesueshmeri dhe kjo eshte me e theksuar ne zevendesimin e aksesit/thirrjeve fikse me akses/thirrje celulare me shume se e kunderta. Kjo zevendesueshmeri e sherbimeve, megjithese jo ne mase te tille per te qene ne nje treg perkates, ndikon ne zvogelimin e dominances aktuale te Albtelecom.

Vleresimi i AKEP duke marre ne konsiderate edhe ecurine e tarifave celulare dhe te telefonise fikse eshte se:

- Ekzistenca e tarifave shume te uleta ose ne nivel zero te aksesit (pajtimi mujor/lidhje) per telefonine celulare ndikon ne vendimet e familjeve per te hequr dore nga nje linje telefonike fikse ose per te mos e blere ate;
- Reduktimi i ndjeshem i tarifave celulare ka ndikuar ne rritjen e ndjeshme te trafikut celular dhe ne rritjen e zevendesueshmerise se thirrjeve fikse me thirrje celulare pasi ato po behen te krahasueshme ne nivelin e tarifave. Megjithate zevendesueshmeria e thirrjeve nga rrjete fikse me thirrje nga rrjete celulare ka qene gjithmone e pranishme dhe perdoruesit jane te gatshem te zevendesojne thirrjet fikse me thirrje nga celulare edhe duke paguar nje tarife/kosto shtese per keto thirrje per shkak te konvencences se kryerjes qe krijojne thirrjet nga celulare krahasuar me ato nga fiks.

- Faktore te tjere

Nje faktor tjetër ndikues ne konkurrencen ne tregun me pakice te telefonise fikse eshte edhe implementimi efektiv i detyrimeve te vendosura ndaj Albtelecom ne nivel me shumice. AKEP gjate ketyre viteve ka marre vendime per implementimin e Z(P)B ne rrjetin Albtelecom si dhe per hapjen e qarkut lokal. Keto detyrime jane reflektura ne ndryshimin e RIO per perfshirjen e Z(P)B dhe pergatitjen e RUO. Gjithashtu ne korrik te 2014 u publikua nga Albtelecom edhe "*Ofertë Referencë për shërbim në tregun me shumicë të aksesit broadband të Albtelecom*". Ne tregun e sherbimit te aksesit me shumice per akses broadband deri ne fund te 2014 rezulton te jete rreth 1,393 linja bitstream. Sic eshte cituar ne seksionin e meparshem perdorimi i ketyre sherbimeve me shumice nga operatoret e tjere do te beje te mundur rritjen e konkurrences ne tregun me pakice te thirrjeve telefonike dhe reduktimin e dominances se Albtelecom ne kete treg.

Gjate ketyre viteve verehet se ka pasur rritje te ndjeshme te konkurrences se mundshme nga rritja dhe forcimi i pozitave te operatoreve kryesore alternative ne treg si dhe nga mundesite e perdoruesve fiks per te zevendesuar thirrje fikse me thirrje nga celulare me tarifa te cilat jane ulur dhe po ulen ndjeshem. Keto aftesi konkurruese pritet te rriten me tej ne vitet ne vijim duke cuar ne reduktim akoma me te madh te pozites dominuese te Albtelecom.

Bashkimi i Albtelecom me Eagle Mobile

Eagle Mobile sh.a. ka qene gjithmone ne pronesine e Albtelecom sh.a., megjithate ne vitin 2013 dy kompanite u bashkuan ne nje kompani te vetme (Albtelecom sh.a). Prezenca e Albtelecom dhe ne tregun celular rrit avanzhet konkurrues te Albtelecom ndaj operatoreve te rrjeteve te telefonise fikse pasi i krijohet mundesia e ofrimit te paketave te perbashketa fikse-celulare. Megjithate duhet theksuar se:

- Efekti i zevendesueshmerise celular-fiks dhe konvergjences se tarifave celulare-fikse cojne ne dimension tregu te telefonise fikse me te madh, fiks dhe celular. (Shiko seksionin ne vijim).
- Pesha e Eagle Mobile ne tregun celular eshte e vogel ne krahasim me dy operatoret me te medhenj Telekom Albania dhe Vodafone. Madje nga pjesa e tregut ne te ardhura e Albtelecom (fiks dhe celular) eshte vetem 24% e tregut te komunikimeve elektronike krahasuar me 27 dhe 37% te Telekom Albania dhe Vodafone respektivisht.

9. Perfundim mbi ecurine e tregut te telefonise fikse

Bazuar në analizën e fundit të telefonisë fikse sic jemi shprehur me siper, Albtelecom u caktua me fuqi te ndjeshme në disa tregje, ku ndër të tjera edhe në tregjet me pakice te aksesit ne rrjet telefonik nga vendndodhje fikse dhe thirrjeve telefonike nga rrjet fikse. Nëpërmjet vendimeve AKEP nxorri jashte rregullimit tarifat me pakice te Albtelecom, duke filluar nga 1.01.2014. Sic edhe eshte vene dukje ne seksionet e mesiperme, numri i pajtimatrëve të Albtelecom që përdorin paketën familjare standarte është në rënie, për shkak të zgjedhjeve që kanë me paketa opsionale (telefoni dhe telefoni/internet ose telefon/internet/IPTV). Nderkohe de-rregullimi i tarifave me pakice coi ne ndryshimin nga Albtelecom te tarifave te paketes Familjare, te cilat konsistonin ne rritje te tarifes se pajtimit mujor dhe te disa lloj thirrjeve, nderkohe ne pagesen fikse mujore u perfshine minuta thirrje si dhe akses ne Internet. Rritja e pajtimit mujor duket se ka dhene efektet ne largimin e një pjese të pajtimtarëve të Albtelecom, megjithese reduktimi i numrit te pajtimatreve te telefonise fikse te ALbtelecom ka qene me renie edhe ne vitet e meparshme.

Analiza e kryer evidenton se aftesia dominuese e Albtelecom ne tregun e telefonise fikse eshte kufizuar ndjeshem per shkak te disa faktoreve:

- Portabiliteti i numrit fiks ka qene efektiv dhe Albtelecom eshte dhenesi me i madh i numrave fiks;
- Disa operatore alternative kane zgjeruar zonat e ofrimit te sherbimeve duke rritur aftesite konkurruese te tyre ndaj Albtelecom ne prezence edhe te masave te tjera si portabiliteti i numrit. Ne shume zona gjeografike Albtelecom ndeshet me konkurrencen e disa operatoreve alternative;
- Masa te tjera ne nivel me shumice si LLU, bitstream krijojne mundesi per operatore te tjere te ofrojne edhe thirrje telefonike (VoB) krahas sherbimeve broadband duke perdorur rrjetin e Albtelecom.
- Evolimi i teknologjise dhe sjelljes konsumatore ne drejtim te paketave te integruara dhe te thjeshta (me perfshirje te minutave ne pagese mujore) jane tregues se Albtelecom ndeshet me presion konkurrues nga operatoret e tjere ne tarifimin e sherbimeve telefonike.
- Konvergjenca e sherbimeve fikse dhe celulare eshte rritur ndjeshem me perfarimin e tarifave te thirrjeve celulare dhe fikse si dhe te sasise se thirrjeve dhe kohezhatjes se tyre.

- Megjithë bashkë me Albtelecom me Eagle Mobile, puna e Albtelecom (fiks dhe celular) në të ardhurat e tregut të komunikimeve elektronike është vetëm 24% në 2014 dhe më e vogël se Vodafone apo Telekom Albania.

III.2 Perkufizimi i tregjeve perkates me pakice

Në analizën e tregut pararendës në vitin 2013 AKEP, vlerësoi se tregjet perkatese në telefoninë fikse ishin këto:

- tregu i aksesit në rrjet publik telefonik nga vëndndodhje fikse;
- tregu i thirrjeve telefonike të disponueshme për publikun nga vëndodhje fikse;

Referenca në analizat pararendëse në trajtimin e këtyre tregjeve ishte nga rekomandimi i KE, 2007/879/EC i 2007 si dhe kushtet e tregut Shqiptar. Në këto rekomandime, KE ka reduktuar numrin e tregjeve perkates të telefonisë fikse nga 6 në 1, duke lënë vetëm tregun e aksesit në rrjet publik telefonik nga vëndndodhje fikse për pajtimtarët familjare dhe jo-familjare. Nderkohe KE në rekomandimin e vitit 2014 për tregjet perkates ka hequr nga lista e tregjeve për nderhyrje ex-ante edhe tregun me pakice të aksesit në rrjetet fiks.

Nga rezultatet e analizave të tregjeve me pakice të telefonisë fikse në vëndet e BE-se, vihet re se deri në Maj 2015:

- në 5 vende nuk ka FNT në tregun e aksesit në rrjetet telefonike nga vëndosdhje fikse asnjë sipas rekomandimit 2007;
- në 4 vende nuk ka FNT në tregun me shumicë të origjinimit sipas rekomandimit 2007;
- në 23 vende nuk ka FNT për asnjë nga tregjet perkates të thirrjeve telefonike nga rrjetet fikse.

Nga rezultatet e analizave të tregjeve me pakice të telefonisë fikse në disa vende (Vëndet Antare/Kandidate dhe Potenciale për anëtarësim në BE)¹⁰, vihet re se deri në fund të majit 2015:

- Estonia në analizën e zhvilluar në fillim të vitit 2014, vëndosi të nxjerre nga rregullimi tregun e pakicës të aksesit në rrjet publik telefonik nga vëndodhje fikse dhe tregun shumicës të origjinimit në rrjetet fikse.
- Filanda nga analizat që ka kryer për tregun e origjinimit dhe të aksesit në rrjetet publike fikse ka dalë në konkuzionin që këto tregje nuk plotësojnë asnjë nga tre kriteret për të nderhyrje ex ante.
- Rumania në analizën e zhvilluar në 2013 doli në konkluzionin që tregu i aksesit në rrjet publik telefonik nga vëndodhje fikse dhe tregun i origjinimit në rrjetet fikse nuk përbejnë tregje të dyshuar për nderhyrje ex ante.
- Portugalia po ashtu si edhe dy shtete më sipër ka vëndosur të derregulojë tregun me pakice të aksesit dhe telefonisë në rrjetet fikse, por në ndryshim me shtetet më sipër tregun me shumicë të origjinimit e ka akoma nën rregullim.
- Kroacia ka përfunduar analizën e tregut të aksesit në PSTN (tregu 1/2007), por në ndryshim nga shtetet e sipërpermendur në perkufizimin e tregut ka përfunduar në këto tregje të gjitha shërbimet e aksesit të komunikimeve elektronike nga rrjetet fikse. Në përfundim të analizës ky treg rezultoi të jetë i dyshuar për nderhyrje ex ante. Edhe

¹⁰ Sipas të dhënave të Cullen International Maj 2015

persa i perket tregut te origjinimit nga rrjete fikse testi tregoi qe ka operatore me FNT si rrjedhim eshte treg i dyshuar per nderhyrje ex ante.

- Islanda ne qershor te vitit 2013 vendosi masa rregulluese per tregun me pakice te aksesit te telefonise nga rrjete fikse dhe nder te tjera edhe detyrimin per akses ne nivel shumice. Persa i perket tregut me shumice te origjinimit masat rregulluese qe u vendosen nuk ndryshonin nga ato te analizes se vitit 2008, perseri ne kete treg u evidentuan operatore me FNT.
- Sllovenia ka te derreguluar tregun e pakices per telefonine dhe se fundmi ne prill te 2015 vendosi te nxjerre nga rregullimi edhe tregun e origjinimit ne rrjete fikse ose te quajtur ndryshe tregu 2 sipas rekomandimit 2007.
- Kosova nga periudha e analizes se fundit te kryer nga AKEP nuk ka pasur zhvillimve te kete aspekt. Ne fuqi jane vendimet e marra ne shkurt te 2012 ku tregut i aksesit ne rrjetet publike telefonike nga rrjete fikse, tregu i thirrjeve, tregut te origjinimit jane rregulluar ne nivel shumice dhe pakice.

Bazuar ne zhvillimet e tregut te telefonise fikse (seksioni III.1) dhe te tregut te komunikimeve elektronike ne teresi ne Shqiperi, rekomandimet e KE per tregjet perkates dhe pervojat ne vendet e BE-se, AKEP gjykon te arsyeshme te rishikoj vleresimin e perkufizimit dhe detajimit te tregjeve perkatese me pakice te telefonise fikse te kryer ne vitin 2013, ku AKEP arriti ne konkuzionin qe tregjet perkatese ne nivelin me pakice te justifikueshme per nderhyrje ex-ante dhe per t'u analizuar ishin:

- Tregu i aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse (per pajtimtare familjare dhe jo –familjare);
- Tregu i sherbimeve publike telefonike te ofruara nga vendodhje fikseper pajtimtare familjare dhe jo –familjare).

Ne vijim edhe te analizes se tregut ne 2013, AKEP vlersion te fokusohet ne dy pyetjet me te rendesishme:

- A ka nevojte per perkufizim te tregjeve te vecante, akses dhe thirrje telefonike nga rrjete fikse, apo duhet te perkufizohet nje treg i vetem?
- A perfshihen thirrjet telefonike nga rrjetet celulare ne tregun e aksesit/thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse?

1. Aksesit dhe thirrjet telefonike nga vendndodhje fikse

AKEP ne analizen e tregut 2013 arriti ne perfundimin se duhet te kete dy tregje te ndryshem per aksesin dhe thirrjet telefonike nga vendndodhje fikse, bazuar edhe ne pervojen ne vendet e BE dhe konkluzionet e analizave te viteve 2007 dhe 2010. Megjithate nga analiza e kryer me siper per zhvillimevet ne tregun fiks vihet re se:

- Tregu Shqiptar nuk ka treguar interes per sherbimet e Z(P)B megjithese ato jane te disponueshme qe prej vitit 2010. Keto sherbime mundesojne qe nje perdorues te kete ofruet te ndryshem te aksesit dhe thirrjeve telefonike;
- LLU e plote qe mundeson ofrim te aksesit broadband dhe thirrjeve telefonike nuk eshte perdorur nga operatoret e tjere. Ky sherbim si edhe Z(P)B mundeson qe pervec aksesit broadband te kete edhe ofrim te thirrjeve nga ofruet i ndryshem nga operatori incumbent

- Shumica e operatoreve kryesore alternative dhe Albtelecom ofrojnë paketa tarifore me pagese fikse mujore që përfshin dhe thirrje telefonike në pagese fikse;
- Përdorimi i paketave bundle (shporta shërbimesh) është rritur ndjeshëm. Në fundvitin 2014, 41% e përdoruesve të shërbimeve telefonike të Albtelecom përdornin paketa të integruara dyfishe dhe trefishe: Telefoni, Internet dhe TV.
- Shumica e ofruesve të thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse zoterojnë rrjetin e tyre të aksesit për lidhje me përdoruesin fundor. Në Shqipëri janë rreth 80 operatore alternative që zoterojnë rrjetin e vet të aksesit (kryesisht me linja bakri në rrjetin e aksesit, por edhe me kabllor koaksial dhe pa tela si p.sh. Telekom Albania) duke ofruar dhe thirrje telefonike për pajtimtarët e vet. Rrjetet kabllore kanë zgjeruar ndjeshëm zonat e ofrimit të shërbimit dhe operatori më i madh alternativ (Abcom) është operator kabllor me prezencë rrjeti në disa zona gjeografike (7 nga 12 qarqe);

Per sa me siper, AKEP gjykon se bazuar në zhvillimet e fundit të tregut dhe karakteristikat e telefonisë fikse në Shqipëri, **aksesi dhe thirrjet telefonike nga vendndodhje fikse janë pjesë e të njëjtit treg perkates.**

2. A janë aksesit/thirrjet nga rrjetet celulare në të njëjtin treg perkates me aksesit/thirrjet nga vendndodhje fikse?

Në analizat pararendese përfshirë edhe analizën e tregut në 2013 është konkluduar që aksesit dhe thirrjet nga vendndodhje të levizshme (celulare) nuk janë pjesë e tregjeve të aksesit dhe thirrjeve dales nga vendndodhje fikse. Në analizën 2013 AKEP ka bërë një shqyrtim të detajuar të faktoreve që ndikojnë ose jo në përfshirjen ose jo të aksesit/thirrjeve celulare në tregun perkates të aksesit/thirrjeve në rrjetet fikse. Nder faktoret kryesore që ndikuan në mospërfshirje të tyre në aksesin/thirrjet nga vendndodhje fikse ishin:

- *Diferenca e madhe e trafikut dales në 2009-2012 shpjegohet edhe me rritjen dhe numrin shumë më të madhe të përdoruesve celulare se numri i përdoruesve të Albtelecom që aktualisht në 2010-2011 ka pasur rënie;*
- *Ecuria e trafikut të Albtelecom në vitet 2007-2009 nuk ka ardhur në rënie, ndërsa në vitet 2010 dhe 2012 është vënë re reduktim i trafikut dales. Megjithatë kjo periudhë është shqyrtuar edhe me reduktim të numrit të pajtimtareve të Albtelecom.*
- *Një rol të madh në rritjen e madhe të trafikut dales celular rezulton se ka luajtur rritja e konkurrencës midis operatoreve celulare dhe reduktimi i ndjeshëm i tarifave të operatoreve celulare.*
- *pavaresisht uljes së ndjeshme të tarifave në telefoninë celulare, perseri thirrjet nga telefonia fikse janë me të lira se thirrjet nga telefonia celulare, sidomos në paketat standarte dhe kohët e fundit edhe në paketat e tjera.*
- *Një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e kësaj lloji zëvendësueshmërie, është fakti se shërbimet celulare konsumohen si pakete shërbimesh që përfshin lloje të ndryshme thirrjesh (drejt destinacioneve të ndryshme si brenda rrjetit, jashtë rrjetit dhe nderkombetare) dhe krahasimi i zëvendësueshmërisë së bazuar në tarifa të llojeve të caktuara të thirrjeve celulare dhe fikse nuk do të ishte i plotë.*

Nderkohe, KE në rekomandimin e vitit 2014 për tregjet perkates ka shpjeguar midis të tjerave se megjithatë në nivel komunitar KE gjykon se aksesit/thirrjet celulare nuk janë në të njëjtin treg perkates me aksesin/thirrjet nga rrjetet fikse, në disa vende kjo mund të gjykohej nga Autoritetet Rregullatore duke marrë në konsideratë faktore të tilla si:

- Zhvendosjen e trafikut nga rrjete fikse drejt rrjet celulare
- Konvergjencen e cmimeve celulare dhe fikse;
- Nivelin e penetrimit te telefonise fikse dhe nivelin e penetrimit/mbulimit te rrjeteve celulare
- Konvergjencen e kohezgjatjes mesatare te thirrjeve nga rrjete fikse dhe rrjete celulare

Nga analiza e kryer ne seksionin e meparshem III.1 AKEP ka evidentuar se:

- Diferenca midis trafikut dales nga rrjetet celulare dhe rrjetet fikse ka vazhduar te rritet ne 2012-2014, dhe ne 2014 thirrjet nga rrjetet fikse perbenin vetem 3% te thirrjeve nga rrjete celulare dhe fiske se bashku. Trafiku nga rrjetet celulare ka vazhduar te rritet ndjeshem ndersa trafiku nga rrjetet fikse ka vazhduar te reduktohet ndjeshem;
- Njekohesisht perdorimi mesatar i thirrjeve nga rrjete celulare eshte rritur ndjeshem, nderkohe qe ka rene ndjeshem perdorimi mesatar i thirrjeve nga rrjete fikse: Thirrjet nga rrjete fikse jane reduktuar nga 151 minuta ne muaj ne 81 minuta ne 2014, ndersa thirrjet nga rrjete celulare jane rritur nga 110 minuta ne muaj ne 2010 ne 172 minuta ne 2014.

Tabela III.11: Perdorimi mesatar mujor i thirrjeve nga rrjete fikse dhe rrjete celulare 2010-2014

	2010	2011	2012	2013	2014	Ndryshimi 2014/2010
Thirrje dales nga Rrjete fikse (Albtelecom)	151	116	106	94	81	-46%
Thirrje dales nga rrjete celulare (mesatare e 4 operatoreve)	110	130	152	156	172	+56%

- Ne 2012-2014 tarifat celulare kane vazhduar reduktimin dhe perdoruesit celulare paguajen mesatarisht 3.12 lek/minute thirrje nga rrjete celulare, qe eshte shume krahasueshme me tarifat nga rrjetet fikse. Pra tarifat celulare dhe fikse po konvergjojne.
- Reduktim i ndjeshem i tarifave celulare vihet re edhe ne thirrjet nderkombetare te cilat tradicionalisht kane qene shume me te lira ne rrjetet fikse. Ky reduktim ka qene i konsiderueshem ne vitin 2014 (dhe aktualisht) dhe kjo ka cuar ne rritje me shume se 10 here te thirrjeve dales nderkombetare nga rrjete celulare ne periudhen 2010-2014.
- Norma e penetrimit te sherbimeve te telefonise fikse ne 2014 arriti ne 9%, ndersa per telefonine celulare ishte 119% per perdorues aktive dhe 172% sipas kartave SIM. Mbulimi me sinjal GSM per popullsi eshte mbi 99%.
- Kohezgjatja mesatare e thirrjeve nga rrjete celulare per vitin 2014 ishte rreth 2 minuta ndersa rrjet fikse (Albtelecom) 2.5 minuta. Kjo tregon se kohezgjatja e thirrjeve nga rrjete celulare eshte ne rritje dhe duke konverguar me kohezgjatjen e thirrjeve nga rrjete fikse.

Per sa me siper, AKEP gjykon se **Aksesi/thirrjet nga rrjetet celulare jane pjese e tregjeve perkates te aksesit/thirrjeve nga vendndodhje fikse.**

Dimensioni gjeografik i shërbimeve të telefonisë fikse

Duke u bazuar në përfundimet e analizave pararendese të telefonisë fikse dhe celulare, ku këto tregje u përcaktuan me dimension kombëtar, si dhe në faktin se nuk kanë ndodhur apo pritet të ndodhin ndryshime të tilla që të ndikojnë në ndryshimin e përfundimit për dimensionin gjeografik, AKEP gjykon se

Dimensioni gjeografik i tregut përkatës të aksesit në rrjet publik telefonik dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse është kombëtar.

Perfundim:

Tregu përkatës me pakicë të shërbimeve telefonike nga vendndodhje fikse përfshin në një treg të vetëm përkatës:

- aksesin dhe thirrjet telefonike nga vendndodhje fikse të ofruara nga operatorët e rrjeteve fikse;
- aksesit/thirrjet nga rrjetet celulare janë pjesë e tregjeve përkatës të aksesit/thirrjeve nga vendndodhje fikse

III.3. Testi i tre kritereve

Bazuar në përfundimin e seksionit III.2 dhe përfundimet e seksionit III.1, për shkak se tregu përkatës i perkufizuar me sipër nuk është as pjesë e listës së tregjeve përkatës të Rregullores së Analizës së tregut dhe as pjesë e rekomandimit të vitit 2014 të KE për tregjet përkatës, për këto treg duhet të kryhet testi i 3 kritereve nëse është i justifikuar për nderhyrje ex-ante. Testi i tre kritereve është përshkruar në Rregullore (pika 4 e nenit 3) dhe është i njëjti me testin e rekomanduar nga KE dhe sipas këtij testi që një treg të përcaktohet nëse është treg i justifikueshëm për nderhyrje ex-ante, për këto treg duhet të plotësohen të tre kriteret e mëposhtme:

- 1. prëzëncë e barrierave të larta dhe jo-kalimtare të hyrjes ;*
- 2. një strukturë tregu e cila nuk ka tendencë për të shkuar në drejtimin të një konkurrence efektive brenda afatit kohor përkatës; dhe*
- 3. pamjaftueshmëria e ligjit të konkurrencës për të adresuar në mënyrë të përshtatshme dëshimin e tregut të marrë në shqyrtim*

Direktivat dhe rekomandimet e KE për tregjet përkatës, e bëjnë të qartë se që një treg të jetë i justifikueshëm për nderhyrje ex-ante, duhet të realizohen të tre kushtet. Nëse edhe njëri prej tyre nuk realizohet atëherë tregu nuk mund të konsiderohet si treg i justifikueshëm për nderhyrje ex-ante.

- i. prëzëncë e barrierave të larta dhe jo-kalimtare të hyrjes*

KE në rekomandimin e vitit 2014 për tregjet përkatës dhe arsyetimin e këtij kriteri për tregun me pakicë të aksesit ka marrë në konsideratë midis të tjerave:

- ekzistencen e alternativave te tjera per akses ne rrjete fikse si nepermjet LLU, akses bitstream te cilat midis te tjerave mundesojne edhe ofrimin e thirrjeve nga vendndodhje fikse. Keto zhvillime reduktojne kostot e hyrjes ne kete treg per operatoret tjere.
- Tranzicioni i rrjeteve fikse PSTN ne rrjete IP, zhvillimet ne NGA, rritja e mbulimit me rrjete kabllore koaksiale, zhvillimet ne telefonine IP te menaxhuar. Efekti i ketyre zhvillimeve con ne uljen e barrierave per ofrim te thirrjeve telefonike.
- Konvergjenca e sherbimeve fikse dhe celulare dhe fakti qe ne disa vende aksesin ne sherbimet celulare eshet konsideruar zevendesues per sherbimet fikse. Edhe ne rastet kur sherbimet nuk konsiderohen ne nje treg perkates, KE citon se operatoret celulare mundet lehtesisht te hyjne ne tregun fiks nepermjet zgjidhjeve si 'Home Zones'

Bazuar ne perkufizimin e tregut perkates ne seksionin III.2 dhe zhvillimet e tregut ne III.1, AKEP gjykon se keta tre faktore plotesohen edhe ne Shqiperi:

- LLU dhe akses bitream jane dy masa rregullatore per Albtelecom qe jane te disponueshme. Gjithashtu AKEP ka propozuar dhe procedura per thjeshtezimin e aksesit ne tubacione (Draft Rregullore per perdorimin e perbashket te infrastruktures pasive) per te reduktuar barriererat ne ndertimin e rrjeteve.
Nje operator alternativ e ka me te lehte te hyje ne treg shkalle-shkalle duke u zmadhuar duke u konsoliduar dhe duke krijuar rrjetin e vet. Nje operator alternativ duke kerkuar akses bitstream ose LLU me qellim ofrimin e broadband, relativisht shume lehte mund te zgjerohet lehtesisht edhe ne ofrimin e sherbimit te telefonise si ate te aksesit edhe ate te televizionit duke perdorur teknologji IP
- Albtelecom ka bere migrimin e plote tashme ne rrjetin NGA si dhe rrjetet kabllore kane rritur mbulimin e tyre ne Shqiperi. Njekohesisht ne Shqiperi ekzistojne 80 operatore alternative me rrjetet e tyre te aksesit dhe qe kryesisht kane qene fillimisht ofruer te aksesit ne Internet.
- Te dhenat tregojne per nje konvergjenca te thirrjeve nga rrjete fikse dhe celulare, si dhe fakti qe Telekom Albania ofron sherbim GSM Fiks nepermjet rrjetit celular prej disa vitesh tashme, tregon se operatoret celulare nuk kane pengesa per tu futur ne ofrimin e sherbimeve nga vendndodhje fikse duke perdorur rrjetet e tyre celulare.

Per sa me siper, duke marre ne konsiderate qe faktoret e mesiperme pritet te forcohen akoma me shume ne te ardhmen e afatmesme, **Kriteri 1 nuk plotesohet.**

- ii. *nje strukture tregu e cila nuk ka tendence per te shkuar ne drejtimin te nje konkurrence efektive brenda afatit kohor perkates*

Persa i perket tendencave drejt nje konkurrence efektive te tregut te aksesit/thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse, bazuar ne masat aktuale rregullatore qe jane fuqi is LLU, bitstream, portabilitet numri fiks, dhe ne perfundimet e analizet se tregut celular (dhe masave te marra ne Analizen e fundit te tregut celular), si dhe masave te propozuara per tregjet me shumice ne kete analize tregu, AKEP gjykon se ky treg ka tendencen te shkoje drejt nje konkurrence efektive ne peridudhe afat-mesme deri afat-gjate.

Duke u fokusuar ne kerkesen ne rritje te konsumatoreve per perdorim te paketave te sherbimeve te telekomunikacionit, parashikohet qe konkurenca ne kete treg te karakterizohet nga nje mbizoterim i fuqishem qe do te mbuloje aksesin dhe telefonine, sherbimin e broadbandit (paketa dyshe me telefoni+internet), sherbimin e televizionit (paketa trefishe me

telefoni+internet+IPTV) dhe shërbimet celulare (paketa katerfishe telefoni+internet+IPTV+ telefoni celulare).

Per me shume ndryshimi i sjelljes se konsumatoreve kundrejt shërbimeve te tjera te komunikimeve elektronikë si ato celulare dhe shërbimeve te mesazheve po cojne ne nje renie te kerkeses per shërbim telefonik fikse. Kete sjellje e vertetojne edhe te dhenat e seksionit III.1 ku shihet qarte qe trafiku dales nga celulari ze pjesen me te madhe (97%) te trafikut te gjeneruar ne total. Gjitashtu edhe minutat mesatare te origjinuara nga nje pajtimtar i telefonise fikse jane me te me te ulta (me shume se dy here) se minutat e origjinuar nga nje perdorues i telefonise celulare.

Ne prani te ekzistences se nje numri te madh paketash ne treg, konvergjences se shërbimeve celulare-fikse dhe portabilitetin e numrit eshte e disfavourshme per nje operator, qofte ky edhe operatori kryesor me pjese tregu relativisht te larte, te mund te silllet si i pavarur nga konkurrenca dhe nga konsumatorët.

Pra persa arsyetuar me siper as **Kriteri 2 i testit nuk plotësohet**

iii. pamjaftueshmeria e ligjit te konkurrenca per te adresuar ne menyre te pershtatshme deshtimin e tregu te marre ne shqyrtim

Nga karakteristikat e shpjeguara me siper nuk ka te ngjare qe nje operator te kete aftesine te silllet ne menyre te pavarur nga konkurrentët dhe nga konsumatorët. Ne qofte se kjo ndodh, roli i ligjit te konkurrenca dhe nderhyrjet e AK vlerësohet te jete efektiv per te denuar sjelljet anti-konkurrenca ne kete treg me pakice pa nevoje nderhyrje ex-ante me FNT ne treg

Per sa me siper, AKEP gjykon se **Kriteri 3 i testit nuk plotësohet**

Megjese nga tre kriteret nuk plotësohet asnje prej tyre, ne perputhje me rregulloren e analizes se tregu dhe rekomandimet e KE, tregu me pakice i aksesit ne rrjet publik telefonik dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse nuk plotëson testin e tre kriterëve dhe nuk konsiderohet si treg i justifikueshem per nderhyrje ex-ante.

IV. ANALIZA E TREGJEVE TE SHERBIMEVE ME SHUMICE: ORIGJINIMI, TRANZITIMI DHE TERMINIMI I THIRRJEVE NE RRJETET FIKSE

IV.1. Perkufizimi i tregjeve te interkoneksionit

Sherbimet ne nivelin me shumice jane sherbime te nevojshme per operatoret e rrjeteve fikse dhe celulare dhe ofruesit e sherbimeve qe te ofrojne sherbimet te telefonise perdoruesve fundore, pra ne nivelin me pakice. Ne perkufizimin e sherbimeve te telefonise fikse ne nivelin me pakice, qe behet ne kapitullin me pas, u be nje ndarje e ketyre sherbimeve ne akses dhe thirrje telefonike te disponueshme per publikun nga vendndodhje fikse. Ne nivelin me shumice sherbimet e nevojshme te operatoreve per te ofruar thirrje drejt rrjeteve te tjera jane origjinimi, terminimi dhe tranzitimi i thirrjeve te cilat jane elemente te nevojshme per te ofruar thirrje telefonike pajtimtareve te rrjeteve fiks, thirrje drejt pajtimtareve te rrjeteve fiks dhe per te vijuar thirrjet drejt ketyre pajtimtareve. Njekohesisht keto sherbime sherbejne si inpute edhe per ofrimin e thirrjeve nga rrjetet celulare drejt rrjeteve fikse.

Ne analizen pararendese te vitit 2013 AKEP ka bere perkufizimin e tregjeve perkates te terminimit, tranzitimit dhe origjinimit si me poshte


- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin Albtelecom, sherbim i ofruar nga sipermarresi Albtelecom sh.a;**
- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin publik alternativ fiks X¹¹, sherbim i ofruar nga sipermarresi X sh.a;**
- **Tregu i origjinimit te thirrjeve zanore ne rrjetet fikse, sherbim i ofruar nga sipermarresit e rrjeteve publike fiks;**
- **Tregu i tranzitimit te thirrjeve zanore ne rrjetet fikse, sherbim i ofruar nga sipermarresit e rrjeteve publike fikse;**

Dimensioni gjeografik i tregjeve te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit te thirrjeve zanore eshte zona operimit (mbulimit me rrjet) te operatorit perkates ofrues te sherbimit(territori i Republikes se Shqiperise per Albtelecom).

Ne lidhje me segmentimin e tre sherbimeve terminim, origjinim dhe tranzitim AKEP ne analizat e meparshme te tregut ka dhene nje skeme ilustruese per kufijte/dallimin midis inputeve te terminimit/origjinimit dhe tranzitimit.

Figura IV.1: Skema e elementeve (inputeve) me shumice per realizimin e thirrjeve telefonike

¹¹ Cdo sipermarres qe eshte pajisur me autorizim te pergjithshem nga AKEP per ofrimin e rrjeteve publike telefonike fikse dhe eshte aktiv ne treg.



Skema e mesiperme IV.1 paraqet elementet perberes te nje thirrje telefonike brenda rrjetit fiks. Ne rastet e interkonektimit me nje rrjet tjetër, operatori tjetër (fiks ose celular) ka nevoje per elemente te ndryshem ne varesi te pikes se interkonektimit dhe destinacionit (origjinim - per bartesit e thirrjeve) te thirrjeve ne rrjetin fiks. Rrjetet mund te interkonektohen per te terminuar dhe origjinuar thirrje midis njeri tjetrit ose drejt operatoreve te tjere (tranzitim).

Skema e mesiperme i referohet me mire rastit te nje rrjeti PSTN. Me kalimin ne NGN ndodhin ndryshime ne hierarkine e rrjetit dhe menyren e komutimit te trafikut, pasi centralet lokale dhe RSU-te qe tregohen ne skeme eliminohen dhe zevendesohen nga MSAN (ne rastin e FTTN apo Albtelecom) dhe pika lidhje te MSAN-ve deri ne centralet softswich.

Procesi i migrimin te NGN megjithese mund te kete efekt ne segmentet e vecanta te sherbimeve (lokal/njefish/dyfish) si dhe ne menyren e interkonektimit me SS7 apo IP, ai nuk ka impakt ne perkufizimin e tregjeve perkates te terminimit/tranzitimit/origjinimit te thirrjeve ne rrjete fikse, per sa kohe vazhdon modeli Calling Party Pays.

Gjate kesaj periudhe dhe viteve ne vijim nuk pritet te kete ndryshime qe mund te ndikojne ne menyren ndarjes se sherbimeve terminimin/origjinim dhe tranzitim. Ndryshimi i perkufizimit dhe numrit te segmenteve te ketyre sherbimeve eshte i nevojshem ne kushtet e rrjetit te ri NGN/NGA te Albtelecom, dhe AKEP ka nisur kete proces qe me analizen e meparshme (reduktimi i segmenteve nga 3 ne 2 dhe reduktimi i pikave te interkoneksionit te Albtelecom) dhe ndryshime te metejshme jane objekt i kesaj analize tregu. Ne kete periudhe nuk kane ndryshuar dhe nuk pritet te ndryshojne nje sere faktoresh qe ndikojne ne ndryshimin e konkluzioneve te meposteme:

- ekzistojne tregje perkates te vecante per terminimin e thirrjeve ne cdo rrjet fiks: pra ofrimi nga secili operator rrjeti fiks i terminimit te thirrjeve ne rrjetin e vet;
- tregjet e origjinimi dhe tranzitimit perfshijne ofrimin e ketyre sherbimeve nga te gjithë operatorët e rrjeteve fikse
- tregu perkates i terminimit te thirrjeve ne rrjetet fikse perfshin vetem terminimin e thirrjeve kombetare
- tregu perkates i tranzitimit te thirrjeve ne rrjetet fikse dhe terminimi ne rrjet fiks perfshin vetem tranzitimin dhe terminimin e thirrjeve kombetare
- tregu i origjinimit te thirrjeve perfshin dhe vet-ofrimin (self-supply).

Per nje diskutim me te detajuar per perkufizimin e tregjeve perkates te terminimit/tranzitimit/origjinimit te thirrjeve ne rrjetet fikse, lexuesi mund ti referohet dokumentave te Analizave te telefonise fikse 2010 dhe 2013, qe jane te publikuar ne faqen e Internetit te AKEP www.akep.al ne seksionin Konsultime te Perfunduara.

Nderkohe, bazuar ne perkufizimin e tregut me pakice dhe testin e 3 kritereve per tregun me pakice ne seksionin III.3, origjinimi i thirrjeve nga vendndodhje fikse duhet te perfshije edhe origjinimin e thirrjeve nga rrjete celulare dhe vetofrimin e tyre.

Per sa me siper, AKEP gjykon qe perkufizimi i tregjeve perkates te mos kete ndryshim nga analiza e tregut e vitit 2013, d.m.th. tregjet perkates te interkoneksionit ne rrjetet fikse jane:

- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin Albtelecom, sherbim i ofruar nga sipermarresi Albtelecom sh.a;**
- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin publik fiks te operatorit alternativ X, sherbim i ofruar nga sipermarresi X¹²;**
- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin publik Telekom Albania drejt numrave gjeografike te Telekom Albania (pajtimtareve Telekom Albania Fiks), sherbim i ofruar nga sipermarresi Telekom Albania sh.a.;**
- **Tregu i origjinimit te thirrjeve zanore nga vendndodhje fikse, sherbim i ofruar nga sipermarresit e rrjeteve publike fikse dhe celulare;**
- **Tregu i tranzitimit te thirrjeve zanore ne rrjetet fikse, sherbim i ofruar nga sipermarresit e rrjeteve publike fikse;**

Dimensioni gjeografik i tregjeve te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit te thirrjeve zanore eshte zona operimit (mbulimit me rrjet) te operatorit perkates ofrues te sherbimit (territori i Republikes se Shqiperise per Albtelecom dhe operatoret celulare) .

Testi i 3 Kritereve per origjinimin dhe tranzitimin e thirrjeve nga vendndodhje fikse

Rekomandimi i KE 2014 ka te perfshire ne listen e tregjeve perkates vetem tregun e terminimit te thirrjeve ne nje rrjet fiks, dhe nuk ka perfshire tregun e origjinimit te thirrjeve si dhe tregun e tranzitimit te thirrjeve. Tregu i tranzitimit nuk eshte as pjese listes se tregjeve perkatese te Rregullores se Analizes se Tregut dhe Rekomandimit 2007 te KE, ku eshte bazuar Rregullorja e AKEP e amenduar ne vitin 2013. Bazuar ne percaktimet e Rregullores se Analizes se Tregut (neni 3, pika 4), AKEP duhet te kryejë testin e tre kritereve per tregun e tranzitimit dhe origjinimit te thirrjeve nga rrjete fikse.

Testi i tre kritereve eshte pershkruar ne Rregullore (pika 4 e nenit 3) dhe eshte i njejte me testin e rekomanduar nga KE dhe sipas ketij testi qe nje treg te percaktohet nese eshte treg i justifikueshem per nderhyrje ex-ante, per kete treg duhet te plotesohen te tre kriteret e meposhteme:

- 1.prezenca e barrierave te larta dhe jo-kalimtare te hyrjes ;*
- 2.nje strukture tregu e cila nuk ka tendence per te shkuar ne drejtimin te nje konkurrence efektive brenda afatit kohor perkates; dhe*
- 3.pamjaftueshmeria e ligjit te konkurrences per te adresuar ne menyre te pershtatshme deshtimin e tregut te marre ne shqyrtim*

¹²Lista e operatoreve alternative eshte dhene ne Aneks 1.

Direktivat dhe rekomandimet e KE per tregjet perkates, e bejne te qarte se qe nje treg te jete i justifikueshem per nderhyrje ex-ante, duhet te realizohen te tre kushtet. Nese edhe njeri prej tyre nuk realizohet atehere tregu nuk mund te kosniderohet si treg i justifikueshem per nderhyrje ex-ante.

1. prezenca e barrierave te larta dhe jo-kalimtare te hyrjes

Akses/origjinimi i thirrjeve nga rrjetet fikse konsiderohet si nje nga inputet me pak te replikueshme ne nivel me shumice se bashku me terminimin qe lejojne operatoret/ofruesit e sherbimeve te ofrojne thirrje telefonike fikse. Alternativa zevendesuese per akses/origjinimin per nje ofrues te sherbimeve ne tregun me pakice te telefonise fikse perfshijne ndertimin e rrjetit te aksesit ose marrjen me qira te lidhjes me pajtimtarin e rrjetit fiks si nepermjet LLU apo bitstream. Megjithate zhvillimet e ndodhura ne investimet ne rrjetet e aksesit nga operatoret alternative, kostoja e ndertimit te rrjeteve te aksesit eshte e konsiderueshme dhe nuk pritet te zvogelohet.

Bazuar ne perkufizimin e tregut me pakice dhe testin e 3 kriterëve per tregun me pakice ne seksionin III.3, origjinimi i thirrjeve nga vendndodhje fikse duhet te perfshije edhe origjinimin e thirrjeve nga rrjete celulare dhe vetofrimin e tyre. Gjithashtu ne kushtet specifike te Shqiperise ku rreth 80 operatore alternative kane investuar ne rrjetet e tyre fise, perfshire rrjetet e aksesit, mund te themi qe origjinimi i thirrjeve ne nivel me shumice nuk ndeshet me pengesa te larta jo-kalimtare.

Ne keto kushte AKEP gjykon se **testi i pare per akses/origjinimin e thirrjeve nga rrjete fikse nuk plotesohet.**

Per sa i perket tranzitimit te thirrjeve, AKEP ka konkluduar ne analizat e meparshem qe tranzitimi i thirrjeve nderkombetare nuk perben me treg te justifikueshem per nderhyrje ex-ante, ndersa tranzitimi i thirrjeve kombetare vazhdon te kete prezenca te barrierave te larta te hyrjes ne treg. Ecuria e sherbimit te tranzitimit te thirrjeve kombetare tregon se disa operatore kane filluar te ofrojne tranzitim te thirrjeve kombetare. Megjithate, ne kushtet e zhvillimit te rrjeteve te telefonise fikse ne Shqiperi ku jane rreth 80 operatore me rrjetet e tyre, Albtelecom eshte i vetmi operator qe ka shtrirje kombetare dhe per shume operator eshte mundesia e vetme per te ofruar sherbime tranzitimi drejt rrjeteve te tjera kombetare, fikse dhe celulare. Operatoret e tjere fiks qe kane hyre ne kete treg kane mbulim te kufizuar dhe marredhenie me numer te kufizuar operatoresh, madje dhe keta tranzitues alternative kane nevojë per sherbimet e tranzitimit te Albtelecom per te vijuar thirrjet e grumbulluara drejt operatoreve te tjere kombetare. Ofrimi i sherbimit tranzit kombetar te plote (pa nevojë per tranzitim edhe me nje operator tjetër) kerkon lidhjen/interkonektimin me 80 operatore fiks te shperndare ne shume zona gjeografike ne Shqiperi dhe me secilin nga kater operatoret celulare.

Ne keto kushte AKEP gjykon se **testi i pare per tranzitimin e thirrjeve kombetare nga rrjete fikse plotesohet.**

2. Nuk ka tendence per te shkuar ne drejtimin te nje konkurrence efektive brenda afatit kohor perkates;

Ecuria e pjeseve te tregut te origjinimit te thirrjeve (vetem rrjetet fikse) si dhe te tranzitimit te thirrjeve kombetare tregon se keto tregje nuk kane shenja per tendence drejt nje konkurrence efektive, te pakten edhe per dy vitet e ardhshme. Nderkohe me perkufizimin e ri te tregut te origjinimit te thirrjeve, per perfshirjen edhe te origjinimit te thirrjeve nga rrjete celulare, ky treg rezulton te kete tendence te shkoje ne konkurrence efektive.

Ne keto kushte AKEP gjykon se **testi i dyte plotesohet per tranzitimin e thirrjeve kombetare nga rrjete fikse por nuk plotesohet per origjinimin e thirrjeve.**

3. pamjaftueshmeria e ligjit te konkurrences per te adresuar ne menyre te pershtatshme deshtimin e tregut te marre ne shqyrtim

Ne kushtet kur tregjet e origjinimit dhe tranzitimit shfaqin problemet e FNT dhe deshtime tregu, masat rregulluese per te adresuar keto probleme duhet te jene ex-ante dhe trajtimi nga AK i rasteve te vecanta nuk mund te zgjidhe problemet qe mund te vijne nga FNT ne keto tregje.

Ne keto kushte AKEP gjykon se **testi i trete plotesohet per origjinimin dhe tranzitimin e thirrjeve kombetare nga rrjete fikse.**

Per sa me siper, AKEP gjykon se:

- *te tre kriteret plotesohen per tregun perkates te tranzitimit te thirrjeve kombetare dhe ne kete menyre ky treg gjykohet i justifikueshem per nderhyrje ex-ante dhe analize per FNT.*
- *Per tregun e origjinimit te thirrjeve nuk plotesohen 2 kriteret dhe ne kete menyre ky treg nuk gjykohet i justifikueshem per nderhyrje ex-ante.*

IV.2. Analiza per FNT e tregjeve te interkoneksionit

1. Terminimi i thirrjeve ne rrjetet fikse

Per te analizuar ekzistencen apo jo te fuqise se ndjeshme ne treg, neni 33 percakton nje sere kriteresh qe duhet te merren ne konsiderate. Sipas perkufzimit te tregjeve perkates te terminimit te thirrjeve ne rrjetet fikse, çdo operator fiks eshte monopolist ne ofrimin e sherbimit te terminimit te thirrjeve ne rrjetin e vet, dhe mund te konkludohet se secili prej tyre ka FNT. Megjithate, terminimi i thirrjeve eshte nje sherbim i cili i ofrohet operatoreve te tjere te rrjeteve, dhe per te arritur ne perfundimin se nje operator ka FNT, qe do te thote aftesi ndikuese ne percaktimin e cmimit te ketij sherbimi pavaresisht operatoreve te tjere apo konsumatoreve, eshte e rendesishme te analizohen edhe disa faktore te tjere qe ndikojne ne kete aftesi ndikuese.

Ne Analize 2013 AKEP arriti ne konkluzionin se Albtelecom dhe te gjithe operoret alternative, perfshire Telekom Albania jane operoret me FNT ne terminimin e thirrjeve ne rrjetet e tyre:

- Albtelecom sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt pajtimtareve te rrjetit fiks Albtelecom;
- Sipermarresi X permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt pajtimtareve te rrjetit fiks alternativ X;
- Sipermarresi Telekom Albania sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt pajtimtareve te Telekom Albania Fiks

AKEP si edhe ne analizat e meparshme per terminimin e thirrjeve (ne rrjete fikse dhe celulare) edhe ne kete analize ka trajtuar faktoret/kriteret e konsideruar me te rendesishem si pjeset e tregut, fuqia kundervepruese e blesesve te sherbimit dhe tarifimi i sherbimit te terminimit

Pjeset e Tregut

Kontrolli 100% i rrjetit terminues nga secili ofruer i sherbimit te terminimit te thirrjeve ne rrjetin e tij, perben ne kete menyre edhe 100% pjese tregu, duke e identifikuar si monopolist

ne ofrimin e ketij sherbimi. Ky percaktim mbi pjesen e tregut ne masen 100% nga secili operator i telefonise fikse ruan te njejten linje arsytimi te perdorur edhe ne analizat pararendese. Pjesa e tregut te terminimit te thirrjeve drejt abonenteve te rrjetit nuk varet nga madhesia e rrjetit, pasi pavaresisht madhesise apo numrit te pajtimareve ne rrjet, secili operator eshte monopolist ne ofrimin e terminimit te thirrjeve drejt aboneteve te vet.

Pjesa e tregut prej 100% qe secili operator ka ne terminimin e thirrjeve ne rrjetin e tij, nuk pritet te ndryshoje pasi nuk ka as alternative teknike per zevendesimin e tij:

- Teknikisht nuk ka asnje mundesi per terminimin e thirrjeve nga nje rrjet A ne nje rrjet B pa nderveprimin e operatorit qe zoteron pajtimtaret drejt te cileve eshte destinuar thirrja.
- Barrierat e natyres teknike jane te paevitueshme per te mundesuar sherbimin e terminimit te nje rrjeti tjetër ne mungese te koordinimit dhe gjetjes se nje vije sjellje te perbashket ne negociatat qe mund te zhvillohen.

Percaktimin si monopolist ne ofrimin e sherbimit te terminimit te thirrjeve per cdo operator te telefonise fikse e gjejme edhe nga perkufizimi i tregjeve perkates te identifikuar ne kapitullin II, sipas te cilit cdo operator fiks eshte monopolist ne ofrimin e sherbimit te terminimit te thirrjeve ne rrjetin e vet, dhe mund te konkludohet se secili prej tyre ka FNT. Megjithate, terminimi i thirrjeve eshte nje sherbim i cili i ofrohet operatoreve te tjere te rrjeteve, dhe per te arritur ne perfundimin se nje operator ka FNT, qe do te thote aftesi ndikuese ne percaktimin e cmimit te ketij sherbimi pavaresisht operatoreve te tjere apo konsumatoreve, kjo e percakton si te rendesishme te analizohen edhe disa faktore te tjere.

Fuqia Kundervepruese dhe konkurrenca e mundshme ne tregun e terminimit

Ne Analize 2013 u arrit ne konkuzionin qe edhe operatorët alternative aktive ne treg, ashtu si Albtelecom, plotesojne kriteret per FNT ne kete treg. Nepermjet rregullimit me status me FNT AKEP percaktoi tarifat e operatoreve ne treg per terminimin e thirrjeve ne rrjetet e tyre. Nga praktika shume vjecare e marredhenieve midis operatoreve per negociatat per percaktimin e tarifave te terminimit me marreveshje komerciale rezultoi ne probleme te cilat jane evidentuar ne analize 2013. Operatorët kane percaktuar tarifat gjate kesaj kohe ne nivelet maksimale te percaktuara nga AKEP dhe nuk eshte vene re qe te jene percaktuar tarifa me te uleta se nivelet maksimale per shkak te fuqise kundervepruese te operatoreve.

Per sa i perket konkurrences se mundshme, per terminimin e thirrjeve ne rrjetet fikse (dhe celulare) eshte arritur tashme ne konkluzionin se per shkak te karaktersitikave teknike te ofrimit vetem nga operatori i rrjetit perkates te terminimit, ofrimi i ketij sherbimi nga secili operator nuk ndeshet me konkurrenca te mundshme ne treg per ofrim nga operatore te tjere te ndryshem nga operatori i pajtimatrit ku perfundon thirrja telefonike.

Ecuria e tarifave te terminimit ne rrjetet fikse

Në dokumentin e Analizes së tregut të telefonisë fikse, miratuar më 30.07.2013, dhe me vendimet përkatëse të FNT (30-31.07.2014), AKEP ka miratuar nivelin e tarifave të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit për Albtelecom dhe tarifat e terminimit për operatorët alternativë fiks, përfshirë Telekom Albania për Telekom Albania fiks, të përcaktuar me FNT. Nepermjet vendimeve te vitit 2013, AKEP vendosi midis te tjerave:

- Reduktimin e segmenteve te terminimit/origjinimit ne rrjetin Albtelecom nga 3 ne 2, duke bashkuar terminimin ne segment lokal me terminimin ne segment njefish (rajonal);
- Reduktimin e segmenteve e tranzitimit nga 2 ne 1;
- Reduktimin e tarifave te terminimit/origjinimit/tranzitimit te Albtelecom;

- Percaktimin me FNT edhe te Operatoreve Alternative (77) dhe Telekom Albania per Telekom Albania Fiks, duke vendosur nen-kontroll edhe tarifat e terminimit ne rrjetet e ketyre opertaoreve;
- Reduktimin e tarifes per thirrje.

Tarifat e përcaktuara në këto vendime dhe afatet kohore të aplikimit të tyre janë janë dhënë në tabelat e mëposhtëme.

Tabela IV.1: Vlerat e tarifave tarifave të terminimit/origjinim/tranzitimit në Albtelcom 2013-2015

	1.09.2010	Faza I 1.01.2014	Faza II 1.09.2014- deri ne nje Vendim tjetet te AKEP
Terminim – Origjinim (lek/minute)			
Lokal	1.50	1.34	1.19
Njefish	2.50	1.34	1.19
Dyfish	3.50	2.68	1.85
Tranzitim(lek/minute)			
Njefish	1.50	1.71	1.32
Dyfish	2.50	1.71	1.32
Tarife per thirrje	0.83	0.53	0.38

Shenim: Tarifat jane pa TVSH.

Tabela IV.2: Vlerat maksimale të tarifave të terminimit në rrjetet e operatoreve alternative fiks 2013-2015

	1.09.2010	Faza I 1.01.2014	Faza II 1.09.2014- deri ne nje Vendim tjetet te AKEP
Tarifa lek/minute			
Lokal	1.5-1.95	1.50	1.34
Mesatare-Njefish/dyfish	2.5-3.25/3.5	2.42	1.77
Tarifë fikse për thirrje (lek/thirrje)	0.83	0.53	0.38

Shenim: Tarifat jane pa TVSH.

Tabela IV.3: Vlerat maksimale te tarifave të terminimit ne rrjetin Telekom Albania per thirrjet drejt Telekom Albania Fiks 2013-2015




	1.09.2010	Faza I 1.01.2014	Faza II 1.09.2014- deri ne nje Vendim tjetet te AKEP
Terminimi lek/minute	1.50 ose 2.5	1.34	1.19

Shenim: Tarifat janë pa TVSH.

Tarifat mesatare në vendet e BE të publikuara nga KE

Të dhënat e publikuara nga KE në lidhje me tarifat e aplikuara në 27 vendet anëtare të BE deri më 1 Janar 2014, janë paraqitur në Figurë 1, më poshtë sipas tre segmenteve që aplikohen normalisht për terminimin e thirrjeve në rrjetet fikse.

Figura IV.1: Tarifat mesatare të terminimit në vendet e BE (Janar 2013 dhe Janar 2014)




Burimi: EC Digital Agenda (Financial indicators fixed and mobile 2014)


Tarifa mesatare në vendet e BE në Janar 2014 sipas 3 segmenteve ishte:

- 0.41 eurocent/minutë për segmentin 1 (local)
- 0.43 eurocent/minutë për segmentin 2 (rajonal apo njëfish)
- 0.63 eurocent/minutë për segmentin 3 (kombëtar apo dyfish)

BEREC (më parë ERG) kryen publikime periodike të tarifave mesatare të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse. Publikimet janë cdo gjashtë muaj dhe publikimi më i fundit paraqet situatën e tarifave të terminimit në Janar 2014 në 34 vende Evropiane. Në këtë listë përfshihen 27 vendet anëtare të BE plus 7 vende të tjera Evropiane, përfshirë disa vende me status kandidat për anëtar në BE. Figura e mëposhtme paraqet tarifat e terminimit në rrjetet fikse sipas 3 segmenteve më 1 Janar 2014.

Figura IV.2: Tarifat mesatare të terminimit sipas vendeve në Janar 2014





Burimi: BEREC BoR (14) 55

Sipas të dhënave të mësipërme tarifa mesatare në vendet e BEREC në Janar 2014 sipas 3 segmenteve ishte:

- 0.41 eurocent/minutë për segmentin 1 (local)
- 0.47 eurocent/minutë për segmentin 2 (rajonal apo njëfish)
- 0.64 eurocent/minutë për segmentin 3 (kombëtar apo dyfish)

Vihet re se tarifat mesatare në vendet e BE dhe BEREC janë shumë të përafërta dhe pa ndryshime të ndryshme sipas të 3 segmenteve.

Tarifat aktuale te terminimit ne Shqiperi jane reduktuar ne baze te vendimeve te AKEP dhe jo per shkak presionit konkurrues me te cilin ndeshen operatoret apo faktore te tjere si fuqia kundervepruese. Tarifat e terminimit jane percaktuar ne nivelet maksimale te lejuara nga AKEP dhe nuk ka pasur tendenca per percaktim te tarifave poshte ketyre niveleve. Tarifat aktuale te terminimit ne rrjetet fikse jane reduktuar ndjeshem ne dy vitet e fundit, por ende jane shume me te larta se tarifat mesatare ne vendet e BE. Ne mungese te rregullimit ex-ante me statusin me FNT operatoret do te mund te tarifonin tarifa mbi nivelet e rregulluara dhe vlera te ndryshme per operator te ndryshem (diskriminim).

Perfundime mbi FNT ne tregjet e terminimit:

Bazuar ne perfundimet e ketij seksioni, AKEP vlereson se Albtelecom dhe te gjithë operatorët alternative, perfishire Telekom Albania jane operatorë me FNT ne terminimin e thirrjeve ne rrjetet e tyre:

- *Albtelecom sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt pajtimtareve te rrjetit fiks Albtelecom;*
- *Sipermarresi X permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt pajtimtareve te rrjetit fiks alternativ X;*
- *Sipermarresi Telekom Albania sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve drejt pajtimtareve te Telekom Albania Fiks;*

Lista me operatorët alternative (te referuar me siper si Sipermarresi X) te propozuar per status me FNT per terminimin ne rrjetet e tyre eshte dhene ne Aneks 1 te ketij dokumenti te analizes. Lista eshte hartuar duke u bazuar ne te dhenat e Rregjistrit te Autorizimit te pergjithshem si dhe te dhenat e rregjistrit te Autorizimit Individual per sipermarresit e pajisur me numeracion gjeografik Fiks deri me 30.03.2015. Pra sipermarresit qe percaktohen me FNT jane sipermarresit qe kane njoftuar per ofrim rrjeti publik telefonik fiks (rrjet publik fiks

dhe telefoni fikse) sipas te dhenave te Rregjistrimit te AP dhe qe njekohesisht jane pajisur me numeracion gjeografik fikse deri me 30.03.2015.

2. Tranzitimi i thirrjeve ne rrjetet fikse

Tranzitimi i thirrjeve sherben per te lidhur dy rrjete qe nuk kane lidhje direkte me njeri-tjetrin apo kur kjo lidhje direkte nuk konsiderohet ekonomike nga palet. Per tranzitimin e thirrjeve kombetare Albtelecom aktualisht eshte operator me FNT dhe tarifat e tranzitimit kontrollohen dhe rregullohen nga AKEP. Sherbimi i tranzitimit kerkohet nga operatorët e rrjeteve fikse per te kompletuar thirrjet telefonike te perdoruesve te tyre drejt rrjeteve te tjera (jo te interkonektuar direkt). Ne analizat pararendese AKEP ka dhene perkufizimin e ketij sherbimi bazuar ne RIO-n e publikuar nga Albtelecom dhe gjithashtu ka percaktuar edhe tarifen maksimale per tranzitim te Albtelecom, e cila qe prej dates 01.09.2014 vazhdon te jete e njete per te dyja segmentet ne vleren 1.32 leke/minute (pa TVSH).

Pjeset e tregut

Per te vleresuar fuqine e ndjeshme ne kete treg si edhe ne tregjet e tjere faktor i rendesishem eshte pjesa e tregut. Edhe ne analizat pararendese ky treg ne kushte e Shqiperise ka rezultuar te dominohet nga Albtelecom. Gjate analizave jane dhene fakte dhe shpjeguar edhe pasoje e kujt eshte kjo dominance.

Ne dy vitet e fundit, pas ndryshimeve ligjore ne lidhje me sherbimin e tranzitimit gjenden edhe operatore te tjere qe mundesojne kryerjen e ketij sherbimi edhe pse kryesisht eshte i perqendruar si tranzit lokal dhe me pak i fokusuar ne segmente te tjera te tranzitimit (rajonal apo kombetar). Bazuar ne te dhenat e evidentuara per sherbimin e tranzitimit kombetar nga Albtelecom dhe OA per vitet 2010-2014, rezulton qe pjesa e tregut te Albtelecom eshte reduktuar nga 95% ne 2010 ne 70% ne 2014, por me oshilacione te ndjeshme ne periudhen 2012-2014.

Tabela IV.4: Trafiku kombetar i tranzituar nga Albtelecom dhe OA (2010-2014)

	2010	2011	2012	2013	2014
Albtelecom	95%	87%	62%	88%	70%
OA	5%	13%	38%	12%	30%

Pas heqjes se barrierave ligjore ne ofrimin e sherbimit te tranzitimit te thirrjeve kombetare, rezulton qe ne kete treg aktualisht jane futur edhe operatore te tjere alternative, te cilet ne total kane mundur te rrisin pjeset e tyre te tregut. Kjo rritje vleresohet te kete ardhur nga zgjerimi i zonave te mbulimit te operatoreve alternative. Megjithe renien e pjeses se tregut, Albtelecom vazhdon te kete nivel te larte prej 62-70% pjese tregu per tranzitimin e thirrjeve kombetare. Oshilacionet ne pjeset e tregut per tranzitimin e thirrjeve kombetare tregojne se operatorët alternative nuk kane krijuar ende sherbim te qendrueshem tranziti kombetar.

Barriera per hyrjen ne tregun e tranzitit kombetar

Pavaresisht heqjes se barrierave ligjore dhe ndryshimeve te ndodhura faktoret kryesore nuk kane ndryshim esencial nga analiza pararendese. Vazhdon te ekzistojne pengesa per hyresit e rinj ne kete treg duke nisur qe nga investimet me maturim afatgjate dhe si pasoje e kesaj dhe zgjerimi ne zonat e mbulimit has pengesa per te cilat jemi ndalur me gjate ne analizen 2013. Megjithe heqjen e barrierave ligjore per hyrjen ne tregun e tranzitimit te thirrjeve, gje e cila reflektohet edhe nga rritja e numrit te ofruesve te ketij sherbimi dhe rritja e pjeses se tregut te

tyre, perseri ky treg ndodhet nen efektin e barrierave te rendesishme me natyre ekonomike, pasi mbulimi me infrastrukturen e nevojshme te territorit kombetar apo edhe zona te konsiderueshme per ofrimin e ketij sherbimi, kerkon investime te medha. Vazhdon te jete prezente ekzistenca e operatoreve alternative me mbulim te kufizuar gjeografik qe e kane te nevojshme sherbimin e tranzitimit nga Albtelecom per t'iu ofruar pajtimtareve te tyre nje sherbim telefonik ne pakice me mbulim jashte mundesive qe iu ofron rrjeti i tyre. Duke marre parasysh sasine qe duhet investuar dhe faktoret vendas qe ndikojne ne normen e kerkuar te kthimit ndaj ketij investimi mund te mendojme se eshte e veshtire per kapacitet qe kane shumica e operoret alternative te zgjerojne mbulimin gjeografik ne gjithe Republiken e Shqiperise. Megjithese disa nga keta operatore kane pasur tendenca positive ne kete drejtim sic edhe eshte evidentuar ne analizen pararendese, perseri mbulimi i tyre vazhdon te jete me i vogel se ai i Albtelecom. Nje faktor i tille, vazhdon ti krijoje avantazh konkurrues Albtelecomit si operatori kryesor dhe vazhdon te mbaje poziten dominuese te tij ne kete treg.

Fuqia Kundervepruese

Ne mungese te nderhyrjes rregullatore per te rregulluar sherbimin e tranzitit kombetar, aftesia qe operatori Albtelecom te demonstroje dominancen e tij do te ishte e padiskutueshme, kjo pasi mundesia qe zbehja e dominances se Albtelecom ne kete treg te vinte si rezultat i fuqise kundervepruese nga palet blerese te ketij sherbimi do te ishte relativisht e vogel. Per rrjedhoje ky faktor do te ishte ne disavantazh te konkurrences efektive ne kete treg

Konkluzioni per tregun e tranzitit kombetar

Pas vleresimit te pjeses se tregut per Albtelecom dhe OA, rezulton se megjithese niveli i pjeses se tregut te Albtelecom eshte reduktuar ndjeshem ne 2012-2014, ai eshte ende i larte ne 70% dhe avantazhet e Albtelecom ne madhesine e rrjetit (mbulim dhe prezence gjeografike) ne raport me operoret e tjera fiks, numri i larte i operatoreve alternative me prezence te kufizuar gjeografike, rrisin aftesine dominuese te Albtelecom ne kete treg.

Nga vleresimi i faktoreve te fuqise kundervepruese te bleresve te ketij sherbimi, si dhe vleresimeve mbi mundesite e zhvillimit te konkurrences ne kete treg, prezences se barrierave te hyrjes ne kete treg etj, AKEP gjykon se :

Albtelecom sh.a. permbush kushtet per t'u shpallur sipermarres me FNT ne tregun perkates te tranzitimit kombetar te thirrjeve.

V. MASAT RREGULLUESE PER OPERATORET ME FNT

Ne baze te analizes se kryer per tregjet e telefonise fikse, rezulton se:

- **Sipermarresi Albtelecom sh.a** vleresohet se permbush kushtet per t'u shpallur me FNT ne tregjet perkates te meposhtem:
 - *Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve ne rrjetin publik telefonik Albtelecom te ofruar nga vendndodhje fikse.*
 - *Tregu me shumice i sherbimit tranzit kombetar ne rrjetet telefonike publike te ofruara nga vendndodhje fikse.*
- **Sipermarresi X** i rrjetit alternativ X vleresohet se permbush kushtet per t'u shpallur me FNT ne tregun e shumices te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin e tij, konkretisht ne tregun:
 - *Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve ne rrjetin publik telefonik te operatorit X te ofruar nga vendndodhje fikse.*
- **Sipermarresi Telekom Albania** vleresohet se permbush kushtet per t'u shpallur me FNT ne tregun e shumices te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin e tij, konkretisht ne tregun:
 - *Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve ne rrjet publik telefonike Telekom Albania drejt numrave gjeografike te ofruara nga vendndodhje fikse (per pajtimtaret e Telekom Albania Fiks).*
- Tregjet perkates te meposhtem:
 - *Tregu i aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendndodhje fikse (per pajtimtare familjare dhe jo –familjare);*
 - *Tregu i sherbimeve publike telefonike te ofruara nga vendndodhje fikse per pajtimtare familjare dhe jo –familjare).*
 - *Tregu me shumice i origjinimit te thirrjeve ne rrjetin telefonik publik te ofruara nga vendndodhje fikse .*

per te cilat Sipermarresi Albtelecom sh.a u vleresua me FNT ne analizen e tregut ne vitin 2013, kane ndryshime ne perkufizimin e tyre dhe nuk plotesojne testin e 3 kritereve, d.m.th nuk vleresohet te jene me tregje perkates te justifikuar per nderhyrje ex-ante, dhe ne kete menyre Albtelecom nuk gjykohet te kete me FNT ne keto tregje.

Pika 2 e Nenit 34 te ligjit 9918, percakton midis te tjerave se *nëse AKEP-i përcakton se një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë ajo vendos ndaj tyre një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të nevojshme, të cilësuar në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji.*

Pika 3, Neni 34 i Ligjit 9918 dhe pika 5 e nenit 3 te Rregullores se Analizes se Tregut, percaktojne midis te tjerave se: *Në qoftë se AKEP gjatë analizimit dhe përcaktimit të një tregu arrin në përfudimin se, ky treg nuk plotëson një nga kriteret e referuara në piken 4 të këtij neni, AKEP nuk vendos detyrime rregullatore në këtë treg ose anulon detyrimet rregullatore ekzistuese, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9918.*

Per sa me siper rezulton se tregjet perkates ne te cilat ka operatore me FNT jane tregjet e terminimit te thirrjeve ne rrjetet individuale te telefonise fikse si dhe tregu i tranzitimit te thirrjeve kombetare ne rrjetet fikse. AKEP ne analizat e meparshme ka evidentuar problematiken e FNT ne keto tregje dhe problematika e tregut te terminimit ne rrjetet fikse eshte tashme e miretrajtuar pasi ato jane probleme standarde qe do te ekzistionin ne kushte e mos-rregullimit ex-ante:

- refuzimi per te dhene akses ne rrjet per sherbimet e interkoneksionit;
- vonesat per dhenien e aksesit;
- mosdhenie e informacionit;
- aplikimi i kushteve diskriminuese midis operatoreve te ndryshem;
- aplikimi i kushteve te padrejta ne marreveshje interkoneksioni.

Seksionet e meposhteme permbajne propozimet e AKEP per detyrimet e operatoreve me FNT, duke u fokusuar ne rregullimin e tarifave te terminimit dhe tranzitimit, si dhe heqjen e detyrimeve per tregjet e de-rregulluara.

V.1. Masat rregullatore per tregjet me shumice te interkoneksionit

1. Masat rregullatore te propozuara per Altelecom

AKEP gjykon se problemet e tregjeve me shumice nga FNT e Altelecom per terminimin dhe tranzitimin e thirrjeve kombetare ruajne te njejten natyre me problemet e identifikuara nga analize 2013, keshtu qe ndaj operatorit me FNT Altelecom propozohet qe detyrimet aktuale (pervec detyrimit per Z(P)B qe ishte detyrim per FNT ne tregjet me pakice dhe origjinimin e thirrjeve) te qendrojne dhe te vazhdohet implementimi i tyre dhe konkretisht:

1. **Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)**
2. **Detyrimi i transparencës (Neni 40)**
3. **Detyrimi për ndarjen e llogarive (Neni 41)**
4. **Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)**
5. **Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)**

- Nenet 46 dhe 52 permbajne detyrime per sipermarresit me FNT ne lidhje me aksesin/interkoneksionin, ndersa 55-59, permbajne percaktime ne lidhje me detyrimet per kontrollin dhe rregullimin e tarifave dhe zbatimin e tyre.

- AKEP, gjykon se per te realizuar objektivat rregullatore te AKEP, te listuara ne piken 3 te nenit 7 te Ligjit 9918, per FNT per terminimin, origjinimin dhe tranzitimin e thirrjeve ne rrjetin Altelecom, te gjitha masat e cituara jane te nevojshme per Altelecom.

- Pervec detyrimeve te citura me siper, Altelecom duhet te zbatojne dhe detyrimet e Ligjit 9918 per akses dhe interkoneksionin, perfshire afatet kohore te dhenies se ofertes se aksesit kerkuesve dhe dorezimin ne afat te MI-ve.

- Detajime te detyrimeve te operatoreve me FNT ne lidhje me interkoneksionin jane pjese e rregullores te Akses dhe Interkoneksionit.

- Albtelecom duhet te publikoje gjithashtu marreveshje te Nivelit te Sherbimit (Service Level Agreement-SLA) si dhe Tregues Kryesore te Performances (Key Performance Indicators - KPI) per interkoneksionin sipas percaktimeve te Rregullores se Akses dhe Interkoneksionit.

- Zbatimi i detyrimit te ndarjes se llogarive dhe mbajtjes se llogarive (nenet 42 dhe 45) dhe zbatimi i detyrimit te orientimit ne kosto te tarifave te interkoneksionit (neni 59), nga Albtelecom, do te kryhet ne baze te percaktimeve te Rregullores Nr. 32, date 26.12.2013 "Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri", miratuar me VKD nr.2406, date 26.12.2013.

2. Masat rregullatore te propozuara per terminimin ne rrjetet e OA dhe Telekom Albania

AKEP ka vleresuar nepermjet analizes, qe operoret alternative te rrjeteve te telefonise fikse plotesojne kushtet per FNT per terminimin e thirrjeve ne rrjetet e tyre individuale. Ne lidhje me masat rregullatore/detyrimet per FNT te ketyre operoreve AKEP gjykon qe te kene te njejat detyrime te vendosura edhe ne analizen e tregut te kryer ne vitin 2013:

1. **Detyrimi i Mosdiskriminimit (Neni 39)**
2. **Detyrimi i transparencës (Neni 40)**
3. **Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)**
4. **Detyrimi per kontroll tarife**

Detyrimi i mosdiskriminimit perfshin ndalimin e aplikimit te tarifave te ndryshme te terminimit te thirrjeve hyrese kombetare per operore te ndryshem kombetar origjinues te thirrjeve te terminuara ne rrjetin e operatorit alternativ. Pra nepermjet ketij detyrimi nje operator alternativ nuk mund te aplikojte tarifa te ndryshme terminimi per operore te ndryshem si celulare ashtu edhe fiks.

AKEP si edhe ne vitin 2013 gjykon qe operoret alternative te mos kene detyrim per publikim oferte reference interkonesioni, pasi kjo mase nuk eshte e nevojshme dhe do te ishte jo-proporcionale.

Detyrimi i transparences perfshin publikimin nga operatori alternative te tarifave/tarifave te terminimit ne rrjetin e tij si dhe te adreses se pikes se interkoneksionit me kete rrjet. Ne kushtet e mos-vendosjes se detyrimit per publikim RIO ky detyrim gjykohet i nevojshme per zbatimin e mos-diskriminimit ne tarifa.

Detyrimi i dhenies akses per interkoneksion eshte detyrim qe operoret rrjeteve publike telefonike te japin akses per terminim ne rrjetet e tyre me qellim realizimin e interkoneksionit te rrjeteve publike telefonike.

V.2. Rregullimi i tarifave me shumice te interkoneksionit

1. Rregullimi i tarifave me shumice te interkoneksionit te Albtelecom

AKEP nepermjet analizes se tregut ne 2013 percaktoi tarifate me shumice te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit ne rrjetin Albtelecom sipas tabeles se meposhteme:

Tabela V.1: Vlerat maksimale te tarifave tarifave të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjetin Albtelecom 2013-2015 (Analiza e tregut 2013)

	2010- 31.12.2013	Faza I 1.01.2014- 31.08.2014	Faza II 1.09.2014- deri ne nje Vendim tjetër te AKEP
Terminim – Origjinim (lek/minute)			
Lokal	1.50	1.34	1.19
Njefish	2.50	1.34	
Dyfish	3.50	2.68	1.85
Tranzitim(lek/minute)			
Njefish	1.50	1.71	1.32
Dyfish	2.50	1.71	
Tarifë fikse për thirrje ¹³ (lek/thirrje)	0.83	0.53	0.38

Shenim: Tarifate jane pa TVSH.

Nepermjet skemes se mesiperme u krye reduktimi i segmenteve te terminimit/origjinimit nga 3 ne 2 dhe i tranzitimit nga 2 ne 1 duke filluar nga data 31.08.2014. Keto reduktime te segmenteve u shoqeruan me reduktime te tarifave si dhe me reduktim te pikave te intrekoneksionit te Albtelecom nga 68 pika interkonesioni lokale, 12 rajonale dhe dy pika kombetare ne 12 pika rajonale, perfshire 2 pika kombetare. Ne keto 12 pika rajonale operatoret mund te percjellin trafik per terminim ne destinacione rajonale dhe kombetare.

AKEP ne periudhen Shtator-Tetor 2014 kreu keshillim publik te dokumentit “*Rishikimi i tarifave te terminimit te thirrjeve ne rrjetet fikse-Këshillim publik*”. Pergatitja e dokumentit te nxjerre ne keshillim publik u krye pas nje konsultimi paraprak me operatoret kryesore te telefonise fikse. Gjate ketyre takimeve si dhe nga komentet ne keshillim publik te dokumnetit te cituar operatoret u shprehen per:

- Dakortesine per kalimin e segmenteve të tarifimit të terminimit nga 2 në 1;
- Dakortesi te pergjithshme per aplikimin e tarifave simetrike te terminimit midis operatoreve te rrjeteve fikse;
- Nevojen per reduktimin e tarifave te terminimit ne rrjetet fikse duke mbajtur ne konsiderate kushtet e ndryshme te zhvillimit dhe situates se telefonise fikse ne Shqiperi ne krahasim me vendet e BE.

Bazuar ne komentet e Albtelecom si dhe per faktin qe faza e pare e propozuar fillonte shume shpejt pas aplikimit te reduktimit me 1.09.2014, AKEP gjykoi qe procesin e keshillimit publik te rishikimit te tarifave te terminimit ne rrjetet fikse ne 2014 (cituar me lart) ta bashkoje me kete proces analize tregu.

¹³Aplikohet per terminimin, origjinimin dhe tranzitimin e thirrjeve.

Bazuar në zhvillimet e fundit dhe kushtet e tregut të telefonisë fikse në Shqipëri, si dhe zhvillimet në vendet e rajonit dhe BE, AKEP propozon që tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet e operatorëve të rrjeteve fikse të rishikohen me qëllim aplikimin e një tarife të vetme për terminimin e thirrjeve në rrjetet e operatorëve të rrjeteve fikse. AKEP gjykon që të përdorë metodën e rregullimit sipas tarifës mesatare në vendet e BE/rajonit (benchmark) duke përdorur një reduktim të përshkallëzuar (glide path).

Tabela e mëposhtme paraqet tarifat te terminimit dhe tranzitimit të Albtelecom si dhe numrin e pikave të interkoneksionit për periudhën 2010-2017, përfshire ndryshimet e propozuara ne dokumentin e nxjerre ne keshillim public ne Qershor 2015.

Tabela V.2.1: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetin fiks Albtelecom (2010-2017)- Keshillimi Publik

	1.09.2010	1.01.2014	1.09.2014	1.01.2016	1.01.2017	Ndryshimi 2017/aktuale
Terminim – (lek/minute)						
Lokal	1.5	1.34	1.19			
Njefish	2.5			1.52	0.7	-41%
Dyfish	3.5	2.68	1.85			-62%
Tranzitim (lek/minute)						
Njefish	1.5	1.71	1.32	0.93	0.43	
Dyfish	2.5					-68%
Tarife per thirrje (lek/thirrje)	0.83	0.53	0.38	0.00	0.00	
POI	84	12	12	12	2	

Tarifat pa TVSH

Bazuar në komentet e dhena ne keshillim publik, AKEP gjykon qe te beje disa ndryshime ne vlerat dhe afatet e propozuara per tarifat e terminimit/tranzitimit dhe numrin e pikave te interkoneksionit. Vlerat dhe afatet e rishikuara jane dhene ne tabelen e meposhteme, qe perben dhe versionin final te AKEP pas keshillimit publik. Ne kete version final AKEP ka zgjatur me 12 muaj periudhen e arrijtes se vleres benchmark te tarifes se terminimit (0.7 lek/minute), dhe te arrijtes se numrit minimal 2 te POI, duke shtuar nje faze te ndermjetme.

Tabela V.2.2: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetin fiks Albtelecom (2010-2018) (version final)

	1.09.2010	1.01.2014	1.09.2014	1.01.2016	1.01.2017	1.01.2018	Ndryshimi 2017/aktuale
Terminim – (lek/minute)							
Lokal	1.5	1.34	1.19				
Njefish	2.5			1.48	1.09	0.70	-41%
Dyfish	3.5	2.68	1.85				-62%

Tranzitim (lek/minute)							
Njefish	1.5	1.71	1.32	0.93	0.68	0.44	
Dyfish	2.5						-67%
Tarife per thirrje (lek/thirrje)	0.83	0.53	0.38	0.00	0.00	0.00	
POI	84	12	12	12	12	2	

Tarifat pa TVSH

Vlerat e tabelës së mësipërme janë përcaktuar si më poshtë:

- Tarifa e terminimit më 1.01.2018 është sa tarifa mesatare (benchmark) e vendeve të BEREC që aplikojnë një segment dhe sa mesatarja e tre segmenteve në vendet e BEREC dhe BE, më 1.01.2014.
- Tarifa e terminimit nga 1.01.2016 është përcaktuar sa niveli i tarifës së terminimit në rrjetet celulare. Kjo tarifa (1.48) është shumë e përafërt me tarifën mesatare të dy segmenteve të aplikuara duke filluar nga 1.09.2014 (1.52), dhe për efekt thjeshtezimi të marrëdhënieve midis operatoreve fikse dhe celulare përben një vlerë më të arsyeshme për terminim në rrjet fikse;
- Tarifa e terminimit/tranzitimit më 1.01.2017 është përcaktuar si mesatare e fazes I dhe III.
- Tarifa e tranzitimit duke filluar nga 1.01.2016 është përcaktuar sa tarifa e propozuar nga AKEP në keshillim publik të analizës së tregut fikse në 2012;
- Tarifa e tranzitimit nga 1.01.2018 është 0.44 lek/ minutë që përbën reduktim me 53% nga Faza e I, e njëjtë me masën e reduktimit të tarifës së terminimit midis Fazes III dhe Fazes I.
- Tarifa për thirrje që aktualisht është në nivelin 0.38 lek/thirrje hiqet më 1.01.2016.
- Numri minimal i pikave të interkoneksionit (POI) të Albtelcom qëndron në 12 më 1.01.2016 dhe 1.01.2017 dhe reduktohet në 2 më 1.01.2018.

Tarifa e terminimit në rrjetin Albtelcom më 1.01.2018 përcaktohet të arrijë vlerën 0.7 lek/minutë, që është sa tarifa mesatare e terminimit e vendeve të BEREC që aplikojnë një segment (13 vende) si dhe sa mesatarja e tre tarifave mesatare të vendeve të BE dhe BEREC, më 1.01.2014. Në fazën e parë që fillon më 1.01.2016 kryhet kalimi në një segment tarifimi. Në këtë fazë ka një rritje të tarifës së terminimit në segment lokal/njefish, por kjo kompensohet nga reduktimi i tarifës në segment dyfish si dhe heqja e tarifës për thirrje. Reduktimi në Janar 2018 në raport me tarifën aktuale është 41-62% për tarifën e terminimit dhe 67% për tarifën e tranzitimit. Rregullimi i tarifave sipas nivelit benchmark (mesatar) dhe reduktimi i përshkallëzuar është një praktikë e ndjekur nga AKEP më parë si dhe një praktikë e lejuar nga Ligji 9918, Neni 7, pika 1 dhe neni 57, pika 2.

Shtyrja me 12 muaj e arritjes së vlerës benchmark të përzgjedhur nga AKEP krijon mundësi për një reduktim më të shkallëzuar të tarifës së terminimit të Albtelcom dhe të operatoreve të tjera alternative.

Pikat e Interkoneksionit të Albtelcom

Numri (minimal) i pikave të interkoneksionit propozohet të vazhdojë të jetë 12 edhe për vitin 2016 dhe vitin 2017, ndërsa duke filluar nga 1.01.2017 ky numër propozohet të reduktohet në 2, në centralet softswitch të Albtelecom në Tiranë dhe Durrës. Reduktimi i pikave të interkoneksionit vjen si rezultat i migrimit të rrjetit Albtelecom nga PSTN në NGN dhe është një proces që ka ndodhur dhe po ndodh dhe në vende të tjera. Këtë proces AKEP e ka parashikuar edhe në Analizën e tregut fiks të miratuar më 30.07.2013.

Periudha 24 mujore (1.01.2016-1.01.2018) gjykohet e mjaftueshme për operatorët alternativë për t'u përshtatur me reduktimin e pikave të interkoneksionit për të realizuar interkoneksionin në një nga dy pikat kombetare të interkoneksionit të Albtelecom në Tiranë apo Durrës. Efekti nuk pritet të jetë i madh pasi ai shoqërohet me reduktim të ndjeshëm të tarifave të terminimit (41-62%) dhe me heqjen e tarifës për thirrje (aktualisht 0.38 lek/thirrje). Megjithatë numri minimal i pikave të interkoneksionit në rrjetin Albtelecom dhe ndryshimet e tyre do jone objekt diskutimi në kuadër të perditimit të ofertes reference të interkoneksionit të Albtelecom.

2. Tarifat e terminimit në rrjetet e operatorëve alternativë fiks dhe Telekom Albania

Tarifat e terminimit në rrjetet e operatorëve alternativë fiks dhe Telekom Albania (për Telekom Albania fiks) propozohen të barazohen me ato të Albtelecom duke filluar nga 1.01.2016, pra të jone me 1 segment dhe simetrike midis të gjithë operatorëve të rrjeteve publike që ofrojnë telefoni fikse në Shqipëri. Heqja e asimetrise është në linjë dhe me rekomandimet e BEREC (më parë ERG) pasi shumica e operatorëve kanë vite tashmë që janë në treg dhe simetria nxit një konkurrencë më të drejtë dhe thjeshtëzim të tarifimit për pajtimtarët e telefonisë fikse.

Tabela V.3: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse të OA dhe Telekom Albania për Telekom Albania fiks (2010-2018)

	2010	1.01.2014	1.09.2014	1.01.2016	1.01.2017	1.01.2018
OA						
Lokal	1.5-1.95	1.5	1.34	1.48	1.09	0.7
Mesatare-Njefish/dyfish	2.5-3.25/3.5	2.42	1.77			
Tarife fikse per thirrje	0.83	0.53	0.38	0	0	0
Telekom Albania						
Terminimi lek/minute	1.50 ose 2.5	1.34	1.19	1.48	1.09	0.7
Tarife fikse per thirrje		0.53	0.38	0	0	0

Tarifat pa TVSH

3. Efektet e pritshme të ndryshimeve të tarifave të terminimit

Tabela e mëposhtme paraqet reduktimet e tarifave të terminimit të thirrjeve telefonike në rrjetet fikse dhe Telekom Albania për Telekom Albania Fiks, aktuale dhe të propozuara për dy vitet në vijim.

Tabela V.4: Ndryshimet në përqindje të tarifave të terminimit në rrjetet fikse (1.09.2014-2018)

	1.09.2014	1.01.2016	1.01.2017	1.01.2018	Ndryshimi 2016/2014	Ndryshimi 1.01.2018/2014
Albtelecom						
Lokal/Njefish	1.19	1.48	1.09	0.70	24%	-41%
Dyfish	1.85				-20%	-62%
POI	12	12	12	2		
OA						
Lokal	1.34	1.48	1.09	0.70	10%	-48%
Mesatare- Njefish/dyfish	1.77				-16%	-60%
Telekom Albania						
Terminimi lek/minute	1.19	1.48	1.09	0.70	24%	-41%
Tarife fikse per thirrje	0.38	0.0	0.0	0.0	-100%	-100%

Tarifat pa TVSH

Nga tabela vihet re se reduktimet variojnë nga 41-62% për tarifat e terminimit të thirrjeve në lek/minutë dhe 100% për tarifën për thirrje, e cila propozohet të hiqet më 1.01.2016. Ndryshimet e percaktuara ne kete dokument pritet të japin një shtysë të re në konkurrencën në treg për thirrjet telefonike fikse paralelisht me thjeshtëzimin e tarifimit të operatorëve me njëri-tjetrin dhe për pajtimtarët. Këto reduktime synojnë dhe reduktimin e stimujve për problematikën e tarifave të ndryshme on-net-off-net të ngjashme me tregun celular dhe rrisin stimujt për tarifim unifik në rrjetet fikse dhe celulare pavarësisht destinacionit fiks/celular. Reduktimet e tarifave të terminimit në rrjetet fikse janë në linjë edhe me reduktimet e kryera tashmë për tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare. Niveli i tarifave të terminimit në rrjetet fikse në Shqipëri në Janar 2018 pritet të arrijë nivelin mesatar të vendeve të BE/BEREC në 2014, pra me një sfazim 4 vjet. Ky sfazim gjykohet i justifikuar per shkak te ndryshimeve te medha te zhvillimit te rrjeteve fikse ne Shqiperi dhe vendet e BE apo dhe rajonit: penetrimi shume i ulet dhe sasia e thirrjeve shume e ulet.

Tarifa e propozuar për terminim në rrjete fikse në Janar 2018 (0.7 lek/minutë) është më e lartë se tarifa mesatare benchmark sipas LRIC të pastër në rrjete fikse (0.16 lek/minutë) e aplikuar në vende të BE, dhe kjo zgjedhje e AKEP është bazuar në karakteristikat e tregut fiks në Shqipëri:

- telefonia fikse ka zhvillim (mbulim dhe përdorim) shumë më të ulët se në vendet e rajonit dhe BE, ndërsa telefonia celulare në Shqipëri ka shumë më tepër karakteristika të ngjashme me vendet e rajonit dhe BE. Këto karakteristika ndikojnë në nivelin e kostove duke cuar në kosto më të larta për njësi në Shqipëri për rrjetet fikse, ndërsa janë të ngjashme për rrjetet celulare në raport me vendet e rajonit dhe BE;
- objektivi për të rritur stimujt për investime/modernizime në rrjete fikse, jo vetëm për telefoni fikse por sidomos për akses broadband fiks.

Megjithate duke marre ne konsiderate vlerat e tarifave te terminimit deri ne 1.01.2014, ne periudhen kohore prej 4 vitesh (1.01.2014 - 1.01.2018) ndryshimet ne tarifate dhe segmentet e terminimit ne rrjetet fikse jane te medha:

- Reduktim te niveleve te terminimit ne rrjetin Albtelecom nga 3 ne 2 dhe me pas ne 1
- Reduktimi i tarifave te terminimit nga 1.5-3.5 lek/minute ne 0.7 lek/minute, qe perben reduktim me 50-80%;
- Reduktim te numrit minimal te pikave te interkoneksionit (POI) te Albtelecom nga 84 ne 12 dhe me pas ne vetem 2.

Reduktimi i pikave të interkoneksionit të Albtelecom në 1.01.2018, nga 12 në 2, krijon kohë të mjaftueshme për OA për përshtatje me zhvillimet e fundit dhe investimet e Albtelecom, duke krijuar njëkohësisht stimuj për Albtelecom për vazhdimin e investimeve në modernizim të rrjetit fiks që duhet të sjellë përfitime për gjithë tregun në tërësi, dhe sidomos për përdoruesit fundorë.

V.3. Heqja e detyrimeve ne tregjet e de-rregulluara

Ne analizen e tregut te vitit 2013 AKEP percaktoi Albtelecom sh.a sipermarres me FNT edhe ne tregjet e meposhteme:

- *Tregu i aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse (per pajtimtare familjare dhe jo –familjare);*
- *Tregu i sherbimeve publike telefonike te ofruara nga vendodhje fikse per pajtimtare familjare dhe jo –familjare).*
- *Tregu me shumice i origjinimit te thirrjeve ne rrjetin telefonik publik te ofruara nga vendndodhje fikse .*

Perfundimet e ketij dokumneti te analizes se tregut kane evidentuar nevojën per ndryshime ne perkufizimin e tregjeve perkates te mesiperme (kapitujt II dhe III) dhe rezultojne se tregjet perkates te ri-perkufizuar nuk plotesojne testin e 3 kriterëve, d.m.th nuk vleresohet te jene me tregje perkates te justifikuar per nderhyrje ex-ante. Ne baze te percaktimeve te ligjit 9918, rregullores se analizes se tregut dhe direktivave dhe rekomandimeve te BE/BEREC, ne keto raste hiqen dhe detyrimet qe jane vendosur per statusin e meparshem per FNT. Sipas ligjit 9918, heqja e detyrimeve behet efektive jo me vone se 6 muaj nga marrja e vendimeve te AKEP (bazuar ne analizen e tregut-versioni final pas keshillimit publik).

Per sa i perket tregjeve me pakice, AKEP ne analizen e vitit 2013 ka evidentuar nje sere karakteristikash te tregut Shqiptar te telefonise fikse (ndryshimet me vendet e BE) dhe megjithese Albtelecom u percaktua me FNT ne tregjet me pakice, detyrimet per FNT u kufizuan vetem ne detyrime per:

- transparence.
- mos-diskriminim
- ofrim Z(P)B per pajtimtarin

Keto detyrime nuk perfshinin rregullimin e tarifave me pakice te Albtelecom. Heqja e ketij detyrimi u be efektive me 1.01.2014. Detyrim per Z(P)B u vendos dhe ne nivel me shumice per FNT te Albtelecom per origjinimin e thirrjeve. Njekohesisht detyrimet per origjinimin e

thirrjeve perfshinin edhe detyrimin per kontroll te tarifes e percaktuar ne nivel te njejte me terminimin e thirrjeve ne rrjetin Albtelecom.

Detyrimet e mesiperme te Albtelecom per tregjet me pakice dhe tregun me shumice te origjinimit, propozohet te hiqen, dhe bazuar ne nenin 34 te ligjit 9918, heqja e ketyre detyrimeve propozohet te behet efektive brenda 6 muajve pas marrjes se vendimit per FNT dhe masat rregulluese per Albtelecom sipas konkluzioneve te versionit final te kesaj analize tregu, pas keshillimit publik.

AKEP vlereson qe te percaktoje si date te heqjes se detyrimeve te meparshem per FNT te Albtelecom datat e meposhtme:

- 1.01.2016 per detyrimet ne tregun me pakice
- 1.05.2016 detyrimet ne tregun me shumice te origjinimit te thirrjeve

Heqja e detyrimeve aktuale ne tregjet me pakice te Albetelcom nuk heq detyrimet e transparences per tarifate me pakice qe kane te gjithe operatoret e tjere te komunikimeve elektronike ne baze te Rregullores nr.27, date 21.09.2012 per publikimin e informacionit per sherbimet dhe tarifate. AKEP do te vazhdoje monitorimin e ecurise se tarifave te paketave standarde dhe te tjera te Albtelecom dhe operatoreve te tjere, me qellim dhe reflektimin e reduktimit te propozuar te tarifave te terminimit ne rrjetet fikse nepermjet ketij dokumneti si dhe ne rrjetet celulara te kryera nepermjet procesit te analizes se tregut celular.

ANEKS 1. LISTA E SIPERMARRSVE TE RRJETEVE PUBLIKE TELEFONIKE FIKSE TE PROPOZUAR PER STATUS ME FNT NE TERMINIMIN E THIRRJEVE¹⁴

Tabela e meposhteme paraqet listen e sipermarrsesve qe ofrojne rrjete publike fikse dhe te pajisur me numeracion gjeografik fikse per pajtimtare, deri me 8.10.2015, te percaktuar me status me FNT ne tregjet perkates te terminimit te thirrjeve ne rrjetet e tyre individuale.

Nr	Sipërmarrës
1	4 ALB sh.p.k
2	ABCOM sh.p.k
3	Abissnet sh.a
4	Abronet sh.p.k.
5	Administration, Management, Bussines, Etc sh.p.k
6	Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k
7	Albanian Carrier Telecommunication sh.p.k.
8	Albanian Satellite Communications sh.p.k
9	UltraNet (Ish Albanian Telecommunication Network)
10	Albanian Telecommunication Partners sh.p.k
11	Albfrut 2005 sh.p.k
12	ALBON sh.p.k
13	Alma 2001 sh.p.k
14	ALPI-COM sh.p.k
15	Altin Sharka (Person Fizik)
16	APOLL NET sh.p.k.
17	Arsen Shahaj (Person Fizik)
18	ATEL sh.p.k
19	Bindi sh.p.k
20	BITRI sh.p.k
21	Bleta sh.p.k.
22	Call Me sh.p.k.
23	CENTRAL ALB sh.p.k
24	DIGICOM sh.p.k.
25	DOVA sh.p.k
26	EDEN sh.p.k
27	EGIS – TEL 2004 sh.p.k
28	EJ & BI sh.p.k
29	ELCOM sh.p.k
30	ELITE Telecommunication sh.p.k.
31	Enada – Online sh.p.k
32	Enkelana Communication sh.p.k
33	Eralbi Computer System sh.p.k
34	ESDE Consulting sh.p.k.
35	ESPACE sh.p.k
36	FABBTEL sh.p.k
37	FBD sh.p.k
38	Fjoart sh.p.k

¹⁴ Kjo liste nuk perfshin Albtelecom dhe Telekom Albania, te cilet shpallen me FNT me vendime te vecanta.

39	FJOERS ONLINE sh.p.k
40	Greta Gjini (Person Fizik)
41	GRUPKOM sh.p.k.
42	Iliria Telecom A (ITA) sh.p.k
43	INFO – Telecom sh.p.k
44	IVA Elektronik sh.p.k
45	KRANER sh.p.k
46	L.E.M sh.p.k
47	Lorenc Bushi (Person Fizik)
48	LUNAL-TEL sh.p.k.
49	MC Networking SH.P.K
50	Merita Xhika (Person Fizik)
51	Mobitel Communication sh.p.k
52	Neofone sh.p.k
53	Neotel Albania sh.p.k
54	Net-Connect sh.p.k
55	NISATEL sh.p.k
56	ORBCOMM Albania Degë e Shoqërisë së Huaj
57	Orikum Telecommunication sh.p.k
58	PEGASUS COMMUNICATIONS sh.p.k
59	Professional Technologies sh.p.k.
60	PROTON COMMUNICATION sh.p.k.
61	RU – TEL sh.p.k
62	Sajet sh.p.k
63	SABATEL sh.p.k
64	Selcom sh.p.k
65	SHKODRA INTEL.TV sh.p.k
66	SIN-TEL sh.p.k
67	TEEB-CENTER sh.p.k
68	Tele.Co Albania sh.p.k.
69	Telekom Postriba sh.p.k
70	Telekomunikacion Group sh.p.k.
71	TEL-KOM sh.p.k
72	Treg Tur Korça sh.p.k.
73	Popaj Klodjano sh.p.k
74	UNIFI HOLDINGS INC sh.p.k.
75	Vasfi Balla (Person Fizik)
76	VIVO Communications sh.p.k
77	VOSKOPI sh.p.k
78	Vraninger Communications sh.p.k
79	Wings.Co Degë e Huaj në Shqipëri
80	XHENI A.D. sh.p.k

ANEKS 2. QENDRIMI I AKEP PER KOMENTET E DERGUARA NE KESHILLIM PUBLIK

AKEP me VKD Nr. 2582, datë 22.06.2015 miratoi publikim e dokumentit “Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: “Analizë e tregut të telefonisë fikse: Tregu me pakice i aksesit/thirrjeve nga rrjete publike telefonike nga vendodhje fikse dhe Tregjet me shumice te terminimit/tranzitimit/origjinimit te thirrjeve ne rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse -Këshillim Publik”

Në këtë dokument të publikuar në faqen zyrtare www.akep.al, AKEP kishte hartuar disa pyetje për të marrë opinionin e palëve të interesuara. Në përfundim të fazës së këshillimit publik në AKEP depozituan komentet: Autoriteti i Konkurrencës, Vodafone Albania, Telekom Albania, Albtelecom, Abcom. AKEP i falenderon të gjithë pjesëmarrsit për kontributet e dhena në procesin e këshillimit publik.

Autoriteti i Konkurrencës nuk ka bërë komente mbi pyetësonin, por ka shqyrtuar analizën në tërësi dhe është shprehur pa vrejje dhe sygjerime, duke vlerësuar se dokumeti ka adresuar drejt çështjen e konkurrencës dhe se ndërmarrja “Albtelecom” ka rënie të pjesëve të tregut, duke u ndeshur me konkurrencë të operatorëve të tjere.

Ky dokument përmban komentet e bëra me shkrim nga palët e interesuara dhe qëndrimin e AKEP mbi komentet.

Për orientim dokumenti është stukturuar në këtë mënyrë:

- pyetjet e hartuar nga AKEP në këshillim publik ;
- komentet/pergjigjet e secilit operator mbi këto pyetje, si dhe
- qëndrimin e mbajtur nga AKEP për komentet përkatëse

1. A jane pasqyruar drejt zhvillimet ecuria e tregut te telefonise fikse ne seksionin III.1?

ALBTELECOM

Zhvillimet dhe ecuria e tregut janë pasqyruar qartë dhe në mënyrë të detajuar. Albtelecom shpreh shqetësim për normën e ulët të penetrimit të fiksit dhe ulja e përdorimit mesatar mujor të telefonisë fikse. Për të rritur bazën e abonenteve, cilësinë dhe gamën e shërbimeve, Albtelecomit përveç investimeve dhe faktoteve të tjera të brendshme i duket i rëndësishëm dhe roli i rregullatorit në lidhje me tarifën e terminimit, lehtësimin e Albtelecom nga detyrimet rregullatore që përmbajnë barrë të rëndë për Albtelecom etj. Albtelecom kërkon të konsiderohet nga ana e AKEP raportimi i treguesve statistikorë nga ana e operatorëve alternativë, kryesisht në lidhje me raportimin e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse, ku citojnë se "... Abcom konsideron si pajtimtarë telefonikë vetëm ata pajtimtarë që e përdorin apo paguajnë vecmas për shërbim telefonik...", e cila sjell si rrjedhim rritjen artificiale të pjesëve të tregut të Albtelecom.

VODAFONE ALBANIA

VA gjykon se leximi dhe interpretimi i disa të dhënave nga AKEP nuk është i plotë dhe lë jashtë analizës një sërë argumentash të cilat kanë impakt mbi rezultatin përfundimtar. Konkluzionet nëse lexohen të shkeputura nga analiza, të shtyjne të besosh se tregu i telefonisë fikse ka përmirësime të dukshme të nivelit të konkurrencës, nderkohe që shifrat e tregut thonë të kundërtën. Operatori inkumbent vazhdon të dominojë në formë monopolistike në tregun e pajtimtarëve të telefonisë fikse, të thirrjeve dalese (origjinimit të tyre) dhe padyshim të të ardhurave, nderkohe që operatorët e tjerë e kanë të pamundur për të mposhtur hegjemoninë e inkumbentit. AKEP ka analizuar disa faktorë që zëvendësueshmëria mes fiksit dhe celularit, por nga ana tjetër nuk përmend fare një sërë ndryshimesh thelbësore midis dy shërbimeve dhe specifikave që ofron secili prej tyre, çka provon që këto dy shërbime janë me tëper plotësues ndaj njëri tjetrit se sa zëvendësues. Të njëjtën problematikë VA e has edhe në analizën e tregut të origjinimit, ku pohon se AKEP nuk marrë në konsideratë pjesën prej 80 % të thirrjeve dalëse dhe inekzistentencën në treg de facto të ZPB dhe LLU. VA është e mendimit se ky treg ka nevojë të jetë nën rregullim.

TELEKOM ALBANIA

Ecuria dhe zhvillimet e tregut të telefonisë fikse të pasqyruara nga AKEP në këtë dokument të analizës reflekton në vija të përgjithshme dinamikën e këtij tregu në vite. Gjate viteve të fundit konkurrenca në tregun me pakice të telefonisë fikse është rritur në vendin tonë për shkak të numrit të madh të operatorëve që operojnë dhe faktoreve të tjerë: investimet e operatorëve në infrastrukturën e tyre, portabiliteti i numrit fikse që ka lehtësuar lëvizjen e abonenteve nga një operator tjetër, gama e madhe e shërbimeve të ofruara nga operatorët, etj. Por disa indikatorë mbeten akoma të ulët sic është norma e penetrimit dhe reduktimi i pajtimtarëve të telefonisë fikse gjate dy viteve të fundit (kjo për shkak të përdorimit me të lartë të shërbimeve në telefoninë celulare nga ana e pajtimtarëve), të cilat ndikojnë në performancën e konkurrencës në tregun e telefonisë fikse me pakice, edhe pse vëhet re një reduktim i të ardhurave kryesisht tek të gjithë operatorët fikse sic e vërejtet në dokument. Telekom Albania, bazuar në sa është konstatuar nga ana e AKEP është e mendimit që konkurrenca në tregun me pakice të telefonisë fikse edhe pse ka shënuar rritje në këto dy vitet e fundit, ende mbeten problematika që e karakterizojnë këtë treg nga ato të vendeve të tjera të rajonit për shkak të penetrimit mjaft të ulët të saj në të gjithë territorin si dhe të

diferencave qe ekzistojne ne lidhje me mbulimin e territorit me rrjet fikse midis operatorit fikse inkumbent dhe operatoreve te tjere alternative fikse dhe te avantazheve perkates qe sjell ky mbulim.

ABCCom

Duke filluar komente e tij Abcom vlereson pune e bere nga AKEP dhe ne vijim jep komentin ne lidhje me pyetsorin e hartuar nga AKEP.

ABCCom mendon qe eshte pasqyruar ne pergjithesi drejt ecuria e tregut te telefonise fikse. Ne kete paraqitje ka edhe pasaktesi te cilat burojne nga pasaktesia e te dhenave te raportuara nga operatoret, te cilat duhet te verifikohen.

QËNDRIMI I AKEP

Me ndryshimet e miratuara me VKD 2516 më 06.11.2014 per Rregulloren nr.12, AKEP ka saktësuar qartë perkufizimet ne lidhje me pretendimet e Albtelecom dhe ABCCom, duke i përshatur ato me ndryshimet teknologjike dhe dinamikat e tregut. Përsa i takon komenti te Vodafone per seksionin III.1 te Analizes, AKEP ka drejtuar pyetjen ne lidhje me zhvillimet e tregut me pakice te telefonise fikse duke u fokusuar per zhvillimet e tregun me shumice ne nje paragraf te vecante. Gjithsesi AKEP vlereson komentet e paleve te interesuara per saktësimet te te dhenave te derguara nga operatoret per numirn e pajtimtarev te telefonise fikse. AKEP do te kryeje kete proces ne process te rishikimit te treguesve periodike te derguar nga operatoret. Pavaresishte sa me siper, gabime te mundshme qe mund te ekzistojne nuk vlersohet se ndikojne ne perfundimet e kesaj analize tregu.

2. Cili eshte opinioni i paleve te interesuara per perkufizimin e tregjeve perkates me pakice te telefonise fikse:

i. A eshte i drejte ri-segmentimi i tregjeve perkates me pakice per perfshirjen ne nje treg perkates te aksesit dhe thirrjeve nga vendndodhje fikse?

ii. A jeni dakort qe aksesi/thirrjet nga celulare duhet te perfshihen ne tregjet perkatese te aksesit/thirrjeve nga vendndodhje fikse?

ALBTELECOM

i. A eshte i drejte ri-segmentimi i tregjeve perkates me pakice per perfshirjen ne nje treg perkates te aksesit dhe thirrjeve nga vendndodhje fikse?

Albtelecom shpreh dakortësinë me AKEP mbi ri-segmentimin e tregjeve përkatës me pakicë për përfshirjen në një treg përkatës të aksesit dhe thirrjeve nga vendndodhje fikse.

ii. A jeni dakort qe aksesi/thirrjet nga celulare duhet te perfshihen ne tregjet perkatese te aksesit/thirrjeve nga vendndodhje fikse?

Albtelecom shpreh dakortësinë e tij në lidhje me përfshirjen e aksesit/thirrjeve nga rrjetet celulare në tregun përkatës të aksesit/thirrjeve nga vendndodhje fikse, duke qënë dakort me argumentat e sjellë nga AKEP në këtë dokument, në lidhje me karakteristikat e tregut shqiptar dhe Rekomandimeve të KE.

VODAFONE ALBANIA

i. A eshte i drejte ri-segmentimi i tregjeve perkates me pakice per perfshirjen ne nje treg perkates te aksesit dhe thirrjeve nga vendndodhje fikse?

VA eshte e mendimit se analiza duhet te mbaje ne konsiderate qendrimin e KE shprehur ne Rekomandimin 710/2014. Nje analize e plote ne lidhje me perkufizimin e tregjeve ne fjale

ofrohet ne Dokumentin Shoqerues te Rekomandimit dhe VA sugjeron qe AKEP te mbaje te njejtin qendrim me Grupin e punes hartues te ketij dokumenti. Nga ana tjetere, VA gjykon se AKEP duhet te kryeje me ne detaj vleresimin dhe analizen/testin e 3 kritereve dhe te rishikojë perfundimet e arritura, pasi tregu i pakices per aksesin dhe thirrjet nga vend-ndodhje fikse shfaq dominancë te theksuar prej vitesh, ku pjeset e tregut te operatorit inkumbent jane te qendrueshme, kane mbetur të pandryshuara ne nivelet 75% (pajtimtare dhe te ardhura) prej disa vitesh dhe tregu nuk tregon shenja dinamizmi apo premisa per te ndryshuar ne te ardhmen.

ii. A jeni dakort qe aksesit/thirrjet nga celulare duhet te perfshihen ne tregjet perkatese te aksesit/thirrjeve nga vendndodhje fikse?

VA i gjykon perfundimet si jo te plota dhe te parakohshme - aksesit/thirrjet nga telefonat celulare nuk duhet te perfshihen ne te njejtin treg pakice me aksesin/thirrjet nga vendndodhjet fikse pasi: 1)kjo nuk perputhet me qendrimin e deritanishem te AKEP dhe Autoritetit te Konkurrences mbi perkufizimin e tregut perkates, 2)sherbimet shfaqin diferencë te konsiderueshme, 3)nuk ekzistojne prova te mjaftueshme per te mbeshtetur kete vendimarrje, 4)analiza qe ka kryer AKEP nuk eshte e plote dhe gjithperfishirese, 5)rrethanat e tregut nuk mbeshtesin nje qasje te tille, 6)nuk rekomandohet nga KE dhe 7)nuk ekzistojne eksperiencia te ngjashme ne nivel BE dhe rajon me kete qasje.

Rrjetet celulare, mund të replikojne deri ne nje mase te caktuar sherbimet/produktet e ofruar nga rrjetet fikse duke i dhene pajtimtareve oferta te ngjashme - ne formen e nje zevendsueshmerie asimetrike/e njekahshme. Megjithate aksesit nepermjet rrjetit celular nuk konsiderohet nga organet rregullatore si i zevendesueshem me aksesin ne rrjetet publike nga vend-ndodhje fikse. Edhe pse % e familjeve qe perdorin vetem aksesin celular ne BE eshte rritur, pjesa me e madhe e pajtimtareve ende perdorin te dy sherbimet: fiks dhe celular. Ky qendrim i KE eshte shprehur qarte ne Rekomandimit 710/2014.

Mbulimi dhe cilesia e perceptuar e thirrjeve ne rrjetet celulare varion ne zona te ndryshme gjeografike dhe ne kohe te ndryshme, cka eshte rezultat dhe i numrit te ndryshueshem mes perdoruesve celulare qe perdorin rrjetin ne te njejten kohe. Keta elemente te cojne ne perfundimin se keto produkte jane te nje natyre plotesuese dhe jo te zevendesueshme, dhe ky qendrim eshte mbajtur nga sere vendesh anetare te BE. Kjo perforcohet dhe nga fakti qe pajtimi prane operatorit fiks perdoret kryesisht per akses ne internet ose IPTV (nderkohe qe thirrjet e telefonise fikse perbejne nje komponent te vogel te paketes) dhe pajtimtaret vijojne ti mbajne te dy sherbimet si komplementare te njeri-tjetrit. Rekomandimi i KE nuk e sheh zëvendësueshmërinë si nje realitet te tanishem por mbase ne nje te ardhme te mevonshme per tregun pan-europian, dhe kjo gjykon Vodafone se eshte e mjaftueshme per AKEP qe mos te nxitohet e mos ti paraprije vendim-marrjeve rregullatore qe ndiqen ne BE. Sic AKEP ka gjykuar të parakohshme zevendsueshmerine e OTT me telefoninë celulare, Vodafone mendon se duhet konsideruar edhe zevendsueshmerine e sipërpërmendur. Për kliente biznes kjo zevendsueshmeri shoqerohet me njesere kostosh si blerje pajisjesh, centale, ri alokim zyresh permiresime ne infrastruktura IT dhe nje tjetere disfavor eshte ofrimi i paketave 4 fishe, si rrjedhim telefonie fikse me ate celulare janë plotesues te njeri tjetrit. Vodafone merr per reference raportin e BEREC te vitit 2011 mbi këtë çështje dhe arsyjet e mos dakordësisë mbi këtë zëvendësueshmëri janë: 1)ka karakteristika te ndryshme mes fiksit dhe celularit, 2)ka diferencë ne cmime mes ofertave te telefonise fikse nga ato celulare, 3)ofertat fikse nuk lejojne levizshmeri ne perdorimin e sherbimeve, 4) sherbimet fikse dhe celulare jane plotesuese dhe jo zevendesuese. Per me teper Vodafone ka listuar elemente qe nje NRA duhet të kete parasysh në shqyrtimin e zevendsueshmerisë dhe sa prej tyre janë marrë në konsiderate nga AKEP:

- Diferencat mes ofertave te fiksit dhe celularit

- Struktura e tregut

- Analiza e ofertave bundle
- Krahasimi i numrit dhe menyrave te aksesit
- Vleresimi nese sherbimet televizive mund te perdoren nepermjet rrjeteve celulare
- Zevendsueshmeria historike dhe potenciale ndermjet rrjeteve celulare dhe fikse
- Ndryshimet mes pajisjeve fundore
- Ndryshimet mes karakteristikave te perdoruesve fundore dhe perdorimit te sherbimit
- Ekzistenca mes ofertave promocionale per sherbime/rrjete te vecanta
- Problematikat specifike te rrjetit te shperndarjes
- Kenaqesia e perdoruesit fundor ndaj secilit prej sherbimeve

Një element tjetër është edhe mungesa e portabilitetit fikse-celular dhe anasjelltas. Kjo është e kufizuar në ligjin 9918/2008 (i cili parashikon vetëm portabilitetin celular-celular ose fikse-fiks), por edhe e paralizuar dhe premature nga kapacitetet teknike të databazës ofruese të sherbimit dhe operatorëve pjesëmarrës në proces.

Një tjetër këndvështrim për Vodafone është edhe bazimi i analizës në udhëzimet specifike dhe Ligjit të konkurrencës dhe Vendimeve të Autoritetit të Konkurrencës, për trajtimin e zëvendësueshmërisë. Vodafone është i interesuar të dijë se çfarë mendimi ka dhënë AK mbi çështjen në fjalë duke qënë se edhe midis këtyre institucioneve në përputhje me dispozitat e Ligjit 9918, Direktivave të BE dhe MOU kanë një bashkëpunim.

Për Vodafone argumenti se penetrimi i lartë i telefonisë celulare është zhvilluar në dem të telefonisë fikse nuk është shumë bindës, pasi në Shqipëri nuk ka pasur për asnjë rast penetrim të konsiderueshëm të telefonisë fikse, e cila të jetë tkurrur nën presionin e telefonisë celulare, por ka adresuar dhe ofruar shërbim për një pjesë të madhe të popullatës e cila deri në atë kohë ishte e pa-shërbyer. Pra rrjeti celular nuk ka zëvendësuar atë fikse.

VA gjykon se për atë kohë sa FTR do të mbeten të barabararte apo edhe me të larta se MTR konsumatori do të shtyhet gjithmone drejt përdorimit të telefonisë celulare, dhe AKEP nuk do mundet të arrijë dot qëllimin e promovimit të fiksit. Ndërhyrjet e fundit në tregun më pakice celular kanë çuar në një disbalancim të sforcuar të përdorimit celular dhe menjanimin e produkteve fikse.

Duke përmbledhur edhe njëherë qëndrimin Vodafone thekson se thirrjet celulare nuk janë në të njëjtin treg me thirrjet nga vend-ndodhje fikse (aq me tepër aksesin në broadband, por kjo nuk është në objektin e analizës tona) dhe propozimi i Grupit të Punes në pikevështrimin e VA është i parakohshëm dhe jo i bazuar në një analizë të plotë dhe shteruese të fakteve dhe specifikave të tregut shqiptar. VA mendojmë se AKEP duhet të japë kohë të mjaftueshme tregut vendas për të përqaftuar plotësisht zhvillimet teknologjike dhe vecanerisht 4G, penetrimit të broadbandit celular dhe pajisjeve perkatese, dhe vetëm pasi zëvendësueshmëria të jetë praktike e konsoliduar në vendet e BE që janë me të zhvilluara AKEP duhet të ulët dhe të rishikojë çështjen. Nëse qëllimin e AKEP është që nepermjet zëvendësueshmërisë të justifikojë derregullimin e tregut me pakice të telefonisë fikse, VA gjykon se kjo nuk është menyra e duhur, duke sjelle si shembull praktikën e FICORA. VA mendon se tregu fikse i pakicës nuk është konkurrent.

TELEKOM ALBANIA

i. A është i drejte ri-segmentimi i tregjeve perkates me pakice per perfshirjen ne nje treg perkates te aksesit dhe thirrjeve nga vendndodhje fikse?

Bazuar ne dinamikat e viteve te fundit ne tregun e telefonise fikse, nje pjese e operatoreve fiks zoterojne rrjetet e tyre individuale, edhe pse mbulojne pjeserisht territorin, duke bere te mundur te kene lidhje direkte per akses tek perdoruesit fundor dhe ne menyre te tille te japin akses per abonentet e tyre, ne menyre qe te kryejne thirrjet e tyre nga keto rrjete. Rritja dhe shtimi i paketave bundle fiks i aksesit duke perfshire thirrje falas ne pajtimin mujor tashme nuk ofrohet vetem nga ana e Albtelekom, por dhe nga disa operatore alternative fiks. Kalimi nga rrjeti tradicional PSTN ne rrjetin bazuar ne IP, rritja e ofrimit te sherbimeve VoIP, disponueshmeria me e gjere e sherbimeve te aksesit ne rrjetin me brez te gjere (broadband), ofrimi isherbimeve fiks ne formen e paketave te integruara (akses/thirrje, internet dhe TV) nepermjet rrjeteve te tyre nga operoret fiks jane disa nga dinamikat qe karakterizojne ecurine e tregut me pakice te telefonise fikse. Ne kete menyre aksesit dhe thirrjet nga rrjetet fikse eshte bere e mundur qe te ofrohen bashke ne nje paketa bundle te integruara per abonentet e telefonise fikse. Por megjithe keto zhvillime shume nga keta operatore nuk e mbulojne te gjithe territorin me rrjetin e tyre dhe per kete perseri jane te detyruar qe te kerkojne akses tek operatori inkumbent ne ato zona qe ata nuk mbulojne me rrjetet e tyre ne menyre qe te ofrojne sherbimet e tyre tek perdoruesit fundore. Per shkak te karakteristikave te ndryshme ne nivelin e zhvillimit te tregut te telefonise fikse midis vendit tone dhe atyre ne rajon, por dhe te BE-se (me divergjenca te medha per shkak te nivelit mjaft te ulet te penetrimit te telefonise fikse ne vendin tone), akoma nuk eshte koha e duhur qe te behet nje risegmentim i tregut me pakice te aksesit duke perfshire ne te dhe thirrjet nga vendndodhje fikse. Per te bere nje gje te tille gjithashtu do te ishte se pari e nevojshme nje rishikim ne listen e tregjeve ne lidhje me perkufizimin e tyre ne Rregulloren per analizen e tregjeve te miratuar ne 2013. Si rrjedhim, Telekom Albania nuk eshte i te njejtit mendim me propozimin e AKEP per perfshirjen ne nje treg perkates te aksesit dhe thirrjeve nga vendndodhje fikse.

ii. A jeni dakort qe aksesit/thirrjet nga celulare duhet te perfshihen ne tregjet perkatese te aksesit/thirrjeve nga vendndodhje fikse?

Aksesi dhe thirrjet nga nje rrjet celular ka nje rol predominant dhe nje perdorim shume here mete madh ne krahasim me aksesin dhe thirrjet nga nje vendndodhje fikse, si ne terma te volumit te minutave te konsumuara ashtu dhe ne terma te perdoruesve qe perdorin keto sherbime. Keto dy sherbime jane komplementare me njera-tjetren dhe trendi i teknologjise dhe ecurise ne tregun e telefonise fikse dhe asaj celulare ka bere te mundur qe operoret celulare te krijojne ne nje shkalle te konsiderueshme shume produkte dhe oferta te rrjeteve fikse. Pavaresisht se ka dhe raste ku sherbimet fiks dhe ato celulare konsiderohen si zevendesues me njera - tjetren per shkak te disa faktoreve si: konvergjenca ne cmime, konvergjenca ne zgjatjen mesatare midis nje thirrje nga rrjet celular dhe nje thirrjeje nga nje rrjet fiks, etj, perseri keto dy sherbime shihen me shume si komplementare kundrejt njera-tjetres nga shumica e rregullatoreve te vendeve anetarete BE-se per shkak te funksionalitetit te ndryshem qe i karakterizon. Ne dokumentin shpjegues te Rekomandimit te Tetor 2014 2014/710/EC te KE "" , ne trajtimin e bere nga KE ne lidhje me kete ceshtje keto dy sherbime nuk jane konsideruar si zevendesuese ndaj njera-tjetres sic citohet ne .faqen. 22:4.1. Accessto voice and voice services}: "... the retail market for access to the public telephone network at a fixed location comprises narrowband access via PSTN, xDSL, fibre and cable networks. The access services provided over leased lines and mobile services are considered to be outside such defined relevant market." Mbulimi dhe cilesia e thirrjeve nga rrjetet celulare ndryshojne gjeografikisht dhe me kalimin e kohes per shkak te numrit te atyre qe perdorin njekohesisht njekohesisht rrjetin duke evidentuar me shume nje shkalle komplementariteti me sherbimin e thirrjeve fikse midis tyre.

Nw vijim tw argumentit mw siper Telekom i referohet nje tjetër dokumeti "Future electronic communications markets subject to ex-ante regulation- Final report", Ecorys, DG Connect 18 September 2013, ne faqjen 87 te paragrafit 5.2.2 "Fixed and mobile access".

Bazuar ne sa me siper, Telekom Albania nuk eshte dakort me propozimin e AKEP qe aksesit/thirrjet nga rrjetet celulare te perfshihen ne nje treg perkates me aksesit/thirrjet nga vendndodhje fikse, duke qene se keto dy sherbime nuk jane zevendesues kundrejt njeri-tjetrit dhe per rrjedhoje perbejne secili treg me vete

ABCCom

Në lidhje ne këtë pyetje ABCCom mendon qe ri-segmentimi i i tregjeve perkates me pakice per perfshirjen ne nje treg perkates te aksesit dhe thirrjeve nga vendndodhje fikse eshte i drejte dhe ka qene kerkese, prej kohe e operatoreve ne treg. Keto ndryshime duhej te ishin bere sipas planit kohe me pare dhe implementimin e tyre e konsiderojme te vonuar

QËNDRIMI I AKEP

Penetrimit i ulet te telefonise fikse ne Shqiperi eshte dukuri edhe vende te BE dhe boterore, por kjo nuk do te thote se ne ato tregje nuk ka konkurrence efektive. Shume vende antare te BE sic edhe eshte shprehur ne Analize kane risegmentuar tregun e aksesit dhe telefonise fikse para se te miratohej Rekomandimi i 2014.

Per arsye te dhena ne Analize dhe mos perseritje te tyre tregu i aksesit dhe telefonise fikse me pakice e ka treguar se bazuar ne zhvillimet e fundit te tregut dhe karakteristikat e telefonise fikse ne Shqiperi, aksesit dhe thirrjet telefonike nga vendndodhje fikse jane pjese e te njejtit treg perkates.

Për sa i takon komenti te Vodafone ne lidhje me shprehjen qartazi te Autoritetit te Konkurrences se sherbimet e telefonise fikse nuk jane ne te njejtin treg me ato te telefonise celulare po t'i referohemi Rekomandimi 2014 ne lidhje me perkufizimin e tregut perkates citon se "... *Markets identified in the Recommendation, while based on competition law methodologies, will not necessarily be identical to markets defined in individual competition law cases...*". AKEP ne kete dokument ka kryer te gjitha hapat dhe procedurat sic i parashikon ligji, duke ftuar Autoritetin e Konkurrences te jape komente dhe sugjerime në lidhje me përmbajtjen dhe konkluzionet e dokumentit të Analizës, te cilat jane paraqitur qe ne hyrje te ketij *Aneksi*.

AKEP bazuar ne vijim te paragrafit te cituar nga Telekom Albania(Ref.FQ.22:4.1) "...*nevertheless the impact especially of the mobile services should be considered by the NRAs at the stage of the three criteria or SMP assessment, as well as (alternatively) in the assessment of the appropriate remedies...*" ka analizuar faktoret qe ndikojne ne percaktimin e tregut perkates dhe ka kryer testin e tre kritereve.

Nisur nga karakteristikat e tregut shqiptar dhe faktoret që ndikojne ne zevendesueshmerine ndermjet fiksit dhe celularit AKEP eshte ndalur gjate ne dokumenti e Analizes ku dhe ka argumentuar me hollesisht konkuzioniet e nxjerra, bazuar edhe ne Rekomandimit e 2014 ku sipas te cilit nisur nga: renia e penetrimit te telefonise fikse konsideruershme ne favor te telefonise celulare, mbulimi me rrjet celuar ne pothuajse te gjithe Shqiperine, konvegjenca e cmimeve dhe modelet e sjelles te te dy ketyre tregjeve sic jane kohezgjatja mesatarja e nje telefonate nga rrjetet celulare e cila po konvergjon me kohezgjatjen mesataren te thirrjes nga rrjetet fikse(faktore keta te argumentuar ne dokemtin e Analizes), jane faktore te cilet kane percaktuar qarte zevendesueshmerine midis fiks dhe celuar. Po sipas Rekomandimit percaktohet se nqs se regullatori bazuar ne analizen e ketyre fakteve mund te evidenton kete zevendesueshmeri.

Ne nje te ardhme te aferte pritet qe teknologjia VoIP te pesoje nje rritje te rendesishme. Penetrimit i broadband ka pesuar rritje duke u ofruar nga planforma te ndryshme dhe mund te

verehet që zgjidhjet VoIP perbejne nje opsion te paracaktuar ne sitet e reja (zyra, ambiente) te biznesit dhe jane zgjidhje e pritshme ne rastet kur prokurohen zgjidhje te reja telefonike. Nisur nga kostot e pergjithshme me te ulta dhe funksionalitet shtese te VoIP, migrimi drejt VoIP eshte duke shkuar mire dhe pritet qe te pershpejtohet.

AKEP, bazuar ne ligjin 9918, i ndryshuar, ne Rreguloren nr. 9, neni 3, pika 2, 3 dhe 4, ne Rekomandimet e KE, mund të përcaktojë dhe analizojë tregje të tjera që nuk janë pjesë e listës të shprehur ne piken 1 te neni 2.

Ne lidhje me FTR, AKEP po ne kete dokument ka propozuar edhe glide path-in i cili ne nje te ardhme te afert po shkon drejt simetrise te tarifave te ketyre rrjeteve, fakt ky i cili, vec te tjerash, do të promovojë shërbimet nga fiksi dhe ndikon direkt ne zevendesueshmerine midis fiksit dhe celularit. Simetria midis dy rrjeteve eshe faktor i rendesihem ne percaktimin e tregut perkates me pakice te shërbimeve telefonike nga vendndodhje fikse i cili perfshin: aksesin dhe thirrjet telefonike nga vendndodhje fikse te ofruara nga operatorët e rrjeteve fikse dhe aksesit/thirrjet nga rrjetet celulare. Per pretendimet e VA që nderhyrjet e fundit ne tregun celular kane cuar ne nje disbalance te sforcuar te perdorimit celular dhe menjanimin e produkteve fikse dhe se tregu fiks i pakices nuk eshte konkurrues, AKEP mendon se jane perfundime te pa argumentuara mbi tregues konkret cilesore dhe sasiore.

3. A jeni dakort me perfundimin e AKEP per testin e 3 kritereve se tregu me pakice i aksesit/thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse nuk eshte me treg i justifikueshen per nderhyrje ex-ante?

ALBTELECOM

Albtelecom është plotësisht dakort me përfundimin e AKEP, edhe në rethanat e zhvillimeve të fundit në tregun e komunikimeve elektronike edhe në argumentat e perdorua për testin e 3 kritereve. Nuk ka patur asnjë kërkesë drejt Albtelecom për aktivizim të shërbimit Z(P)B, përdorimi i shërbimit të kartave të parapaguara ka ardhur gjithmonë e në ulje dhe po ashtu nuk ka patur interes për shërbimet e LLU-së. KE e ka hequr këtë treg nga lista e tregjeve të dyshuar për ndërhyrje ex ante dhe zhvillimet në Shqipërisë nuk janë dicka e izoluar dhe e pavaruar nga zhvillimet ndërkombëtare, por janë rrjedhojë e të gjitha prirjeve dhe ndryshimeve në lidhje me shërbimet e telefonisë. Pavarësisht se është mbajtur nën rregullim, ky faktor nuk ka nxitur rritjen e penetrimit të kësaj telefonie.

VODAFONE ALBANIA

VA gjykon se ne parim tregjet e nivelitte pakices nuk duhet te pesojne nderhyrje rregullatore. Megjithate ne rastin konkret bazuar mbi dinamikën e ulet te tregut dhe pandryshueshmerine e pjeseve te tij per operatorin inkumbent (i qendrueshem me mbi 70% pjese tregu ne te gjithë komponentet), VA i kerkon AKEP qe te kryeje me rigorozitet testin e 3 kritereve per nderhyrje nderhyrje ex-ante ndaj ketij te fundit.

TELEKOM ALBANIA

Ne Rregulloren nr.9 te AKEP per analizen e tregut, ndryshuar me ane te VKD 2342 date 31.07.2013, tregu me pakice i aksesit eshte ne listen e tregjeve i justifikueshem per nderhyrje exante. Kjo rregullore bazohet ne rekomandimin e BE-se te vitit 2007. Tregu me pakice i telefonise fikse ne vendin tone ka pasur ndryshime pozitive qe pas analizes se fundit te tregut

fiks te 2012 si: rritja e numrit te konkurrenteve ne treg, investimet ne infrastrukturen e njeteve nga disa operatore fiks dhe kalimi gradual drejt njeteve NGN, rritja e aksesit ne broadband fiks, gama e sherbimeve bundle te integruara (telefoni, internet, TV) nga disa operatore, apo i thirrjeve Voice over Broadband, ka bere qe cmimet me pakice te ulen. Nje influence sinjifikative ka pasur dhe futja ne kete treg i Telekom Albania ne ofrimet me sherbimet fikse duke mbuluar pothuaj gjithe territorin me to. Pavaresisht ketyre zhvillimeve positive, tregu retail ne telefonine fikse ne vendin tone eshte akoma shum larg atij ne vendet e tjera te rajonit apo te vendeve anetare te BE-se per shkak te nivelit te ulet te penetrimit te telefonise fikse si dhe per shkak te faktit qe shume operatore alternative fiks edhe pse kane ndermarre investime te rendesishme ne ndertimin e rrjeteve te tyre jane kryesisht te shtrire ne disa qendra te medha urbane apo ne nivel local duke lene te pambuluar me sinjal zona te tjera te territorit. Ne kete aspekt operatori inkumbent vazhdon akoma te gezoje avantazhe te konsiderueshme per shkak te prezences me te madhe me rrjet ne territor dhe te aksesit qe ka ne elementet esenciale te rrjetit dhe per pasoje nga kjo mund te njedhin sjellje abuzive kundrejt konkurrenteve te tjere ne treg.

i. prezenca e barrierave te larta dhe jo-kalimtare te hyrjes

Telekom Albania gjykon qe megjithe sa u permend me siper, barrierat e hyrjes per shume operatore ngelen te larta, pasi investimet ne rrjet jane shume te medha dhe jo te gjitha operatoret kane mundesine per t'i perballuar dhe rekuperuar ato ne menyre qe te ndertoje rrjetin e tij. Ndersa zevendesueshmeria midis sherbimeve fiks-celulare nuk luan nje rol ne kete drejtim pasi sic e theksuan dhe me lart keto dy sherbime jane komplementare dhe jo zevendesuese per shkak te karakteristikave funksionale te ndryshme nga njera-tjetra duke mos qene pjese e te njejtut treg. Ndaj Telekom Albania mendon qe kriteri i pare plotesohet ne lidhje me prezencen e barrierave te larta te hyrjes ne kete treg.

ii. nje strukture tregu e cila nuk ka tendence per te shkuar ne drejtimin te nje konkurrence efektive brenda afatit kohor perkates

Ne lidhje me kriterin e dyte, Telekom Albania gjykon se vihet re nje tendence per te shkuar ne drejtimin e nje konkurrence efektive per shkak te zhvillimeve positive dhe premtuese ne tregun e telefonise fikse, risive ne teknologji dhe te investimeve te bera ne te, zhvillimit te broadbandit, dhe mundesise per te pasur akses me te madh, rritjes se numrit te operatoreve qe i ofrojne keto sherbime, apo te portabilitetit te numrit fiks qe lehteson kalimin e nje abonenti nga nje operator tek nje tjetër pakosto shtese duke lehtesuar me tej nivelin e konkurrences midis operatoreve fiks, etj. Per kete arsye Telekom Albania shprehet dakort me AKEP qe kriteri i dyte nuk plotesohet.

iii. pajftueshmeria eligjtit te konkurrences per te adresuar ne menyre te pershtatshme deshtimin e tregut te marre ne shqyrtim

Duke qene se tendenca e ketij tregu eshte drejt nje konkurrence efektive ne te ardhmen, Telekom Albania mendon qe kriteri 3 nuk plotesohet duke e cilesuar ligjin e konkurrences si te mjaftueshme per adresimin e deshtimeve ne treg. Por duke qene se kriteri i pare plotesohet Telekom Albania mendon qe tregu me pakice nga vendndodhje fikse ka ende nevojë per nderhyrje rregullatore ex-ante dhe si i tille duhet te mbetet ne listen e tregjeve nen rregullim sic dhe parashikohet nga Rregullorja per analizen e tregjeve.

Telekom si edhe Vodafone gjen momentin te theksoje se AKEP nga njera ane propozon derregullimin i plote i ketij tregu dhe ana ana tjetër ka nderhyre ne tregun me pakice te telefonise se levizshme duke vendosur rregullimin e tij. Per Telekom, AKEP perdor dy standarte te ndryshme duke qene ne kete menyre ne kontradikte dhe jo koherent me pozicionet e ndermarra ne tregjet me pakice. Gjithashtu, Telekom thekon se AKEP eshte ne kundërshtim dhe me rregulloren qe ka miratuar vete duke qene se tregu me pakice i aksesit nga vendndodhje fikse eshte ne listen e 7 tregjeve nen rregullim dhe per ta hequr kete treg nga kjo liste praktika qe AKEP duhet te kishte ndjekur ishte ajo e rishikimit te kesaj liste duke bere ndryshimet perkatese ne rregulloren per analizen e tregut.

ABCom

ABcom është dakord me këte përfundim.

QËNDRIMI I AKEP

Nga të dhënat statistikore të këtyre viteve shihet qartë se pjesët e tregut të incumbent-it janë luhatur dukeshëm, operatorët alternativë kanë rritur presionin ndaj operatori kryesor duke ofruar akses dhe tarifa ose paketa konkurruese, për këto dhe për faktorë të tjerë AKEP është ndalur me në detaj përgjatë dokumentit. Testi i tre kriterëve ka marrë në konsideratë sidomos përkufizimin e tregut përkatës (përfshirje edhe të thirrjeve/akses) nga rrjet celular, dhe në këte prizëm, testi i tre kriterëve deshton për tregjet me pakice të aksesit/thirrjeve nga vendndje fikse. Sqarohet se akses nga vendndodhje fikse (në tregun përkatës) është për shërbime narrowband dhe jo broadband.

4. A mendoni se Altelecom përmbush kriteret për FNT në tregjet me shumicë të:

i. Terminimit në rrjetin Altelecom;

ii. Tranzitimit kombëtar në rrjete fikse;

ALBTELECOM

i. Terminimit në rrjetin Altelecom;

Ashtu sikurse dhe AKEP ka trajtuar në dokumentin e analizës, faktorët/kriteret e konsideruar më të rëndësishëm të tillë si, pjesët e tregut, fuqia kundërvepruese e blerësve të shërbimit dhe tarifimi i shërbimit të terminimit, secili nga Operatorët e tregut të telefonisë fikse është FNT në tregun e terminimit të thirrjeve. Për më tepër nuk ka asnjë mundësi teknike për terminimin e thirrjeve nga një rrjet në tjetrin pa ndërveprimin e operatorit, në pajtimtarin e të cilit terminohet thirrja. Për sa analizohet edhe në dokument është e drejtë të gjykohet se Altelecom dhe secili prej Operatorëve Alternativë, dhe Telekom Albania Fiks janë FNT në tregun e terminimit të thirrjeve.

ii. Tranzitimit kombëtar në rrjete fikse.

Në lidhje me statusin me FNT në tregun e tranzitimit kombëtar Altelecom beson se deshton në plotësimin e tre kriterëve për të gëzuar këtë status në rrethanat që ofron tregu për të gjithë sipërmarrësit. Ndërkohë që të qenurit FNT në tranzitimin kombëtar në rrjete fikse varet edhe nga kapacitetet teknike që operatorët e tjerë në treg kanë të lira. Për të argumentuar përgjigjen e tij Altelecom rendit faktorët që ndikojnë në deshtimin e testit të 3 kriteve për këte treg. Nuk ka pengesa juridike dhe strukturore për të hyrë më këtë treg vazhdon analizen Altelecom duke sjelle disa faktorë si, prezencën e konsiderueshme të rrjetit të disa AO me fibër optike në qendrat kryesore kabllorë, të cilët janë autorizuar nga AKEP për këtë shërbim dhe jo vetëm kanë një infrastrukturë të ndërtuar, por edhe vazhdojnë të investojnë në zgjerimin e saj dhe kryejnë tashmë tranzitimin e thirrjeve të operatorëve të tjerë alternativë njëherazi të cilët nuk kanë prezencë me Pikë lokale për të përfituar nga tarifa lokale e terminimit në rrjetin Altelecom. Paralelisht me këtë Altelecom evidenton se volumi i trafikut të tranzituar në Altelecom vjen gjithmonë në rënie dhe nga ana tjetër trafiku i tranzituar nga operatorët alternativë është gjithnjë e në rritje. Kjo, sipas Altelecom, dëshmon qartë se tashmë qëllimi për krijimin e një ambienti konkurrues në një treg të caktuar është arritur dhe nuk është e nevojshme për ndërhyrjen ex-ante të AKEP. Gjithashtu, edhe nëse bazohemi në kriterin e dytë, lidhur me tendencën e këtij tregu për të shkuar drejt konkurrencës efektive, sikurse dhe përmendet e jepen dhe shifrat e pjesëve të tregut në vite si dhe në tabelën e mëposhtme, pjesa e tregut të Altelecom në tregun e tranzitit kombëtar ka pasur rënie drastike nga 88% për vitin 2013 në 70% për vitin 2014.

Këto ndryshime në rënie të pjesës së tregut të Albtelecom, tregojnë për hapjen e këtij tregu dhe shkuarjen drejt konkurrencës efektive. Gjithashtu, në prani të disa operatorëve të tjerë në treg që kryejnë shërbimet tranzite, nuk ka të ngjarë që Albtelecom të sillet në mënyrë të pavarur nga konkurrentët apo klientët e tij në këtë treg (operatorët alternativë).

Ne perfundim të komentit për këtë pyetje Albtelecom përmend edhe njëherë të përmbledhur gjykimin se nuk përmbush kriteret ligjore për tu caktuar me statusin FNT në tregun e tranzitimit kombëtar si mëposhte:

- Uljen drastike të pjesës së tregut të Albtelecom në këtë treg;
- Qasjen pozitive të Albtelecom në këto vite 2014-2015, me synimin jo vetëm për të shfrytëzuar infrastrukturën e lirë të tij, por edhe për të qënë një zgjedhje e parë për operatorët e tregut të komunikimeve elektronike në ofrimin e shërbimeve me shumicë,
- Predispozitën e Albtelecom në marrëdhëniet me Operatorët Alternativë për t'iu përgjigjur në kohë kërkesave të tyre për këtë shërbim (kjo është më se e evidente, sa kohë që dhe pranë AKEP nuk ka ardhur asnjë ankesë);
- Mjaftueshmërinë e dispozitave në ligjin “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe kuadrin rregullator ekzistues;
- Rekomandimet e KE të vitit 2014 dhe 2007, për mospërfshirje të tregut të tranzitimit të thirrjeve në listën e tregjeve përkatëse;

VODAFONE ALBANIA

VA shprehet dakord me gjetjet e AKEP. Operatori inkumbent është si edhe çdo operator tjetër i telefonisë fikse është dominant për terminimin e thirrjeve në rrjetin e tij. Ky është dhe qëndrimi i qarte i Rekomandimit të KE në vitin 2003, 2007 dhe 2014, të gjithë praktikantët e vendeve evropiane dhe të rajonit si edhe qëndrimi i AKEP i shprehur në Rregulloren për Analizën e tregut. Edhe tregu i tranzitimit shfaq karakteristika dominancë të theksuar e për rrjedhojë ka nevojë për ndërhyrje rregullatore ex-ante.

TELEKOM ALBANIA

i. Terminimit në rrjetin Albtelecom;

Telekom Albania mendon që Albtelecom i përmbush të gjitha kriteret për FNT në tregun e terminimit në rrjetin e tij, për shkak të karakteristikave që ka ky treg dhe mënyrës se si operohet në të. Argumenta shtesë ka dhënë në analizat e mëparshme.

ii. tranzitimi kombëtar në rrjete fikse;

Telekom Albania mbështet analizën e kryer nga AKEP në lidhje me tregun e tranzitimit kombëtar në rrjetin fikse të Albtelecom. Duke qënë se problematikat në këtë treg mbeten në thelb të njëjta me ato të evidentuara dhe në analizat pararendese duke theksuar edhe njëherë disa problematika.

ABCCom

ABCCom shpreh opinionin e tij Albtelecom si operator incumbencë i përmbush kriteret për, të konsideruar FNT në tregjet:

- Terminimit në rrjetin Albtelecom
- Tranzitimit kombëtar në rrjete fikse

AT mbetet operatori dominues në treg për interkoneksionin kombëtar dhe ndërkombëtar kështu që për këto segmente duhet të vijojë të jetë nën kontroll.

QËNDRIMI I AKEP

Operatorët janë dakort për perfundimin e AKEP për këto tregje, përveç Albtelecom që nuk është dakort për tranzitimin e thirrjeve. AKEP ka dhënë argumenta në lidhje me pretendimin e Albtelecom të detajuar në dokumentin e analizës për keshillim dhe gjykon të drejtë perfundimin e arritura në të. Pavarësisht mos ekzistencës së barrierave ligjore vazhdon të ketë barrierë ekonomike me të cilat operatorët alternativë përballen duke pasur parasysh që shtrirja e rrjeteve të tyre është në nivel lokal dhe investimi në infrastrukturë kërkon kohë të gjatë kthimi dhe AO të kenë arritur ekonominë e shkallës dhe të qëllimit.

5. A mendoni se terminimi i thirrjeve në rrjetin e secilit operator alternativ fikse përben ende një treg perkates të vecante dhe se të gjithë operatorët alternativë dhe Telekom Albania duhet të shpallen me FNT për terminimin në rrjetet e tyre fikse (Telekom Albania për terminimin e thirrjeve drejt Telekom Albania Fiks)?

ALBTELECOM

Fakti që, secili nga Operatorët Alternativë dhe Telekom Albania (për Telekom Albania Fix) zotërojnë 100 për qind pjesë tregu në shërbimin e terminimit të thirrjeve zanore në këto rrjete dhe që çdo operator fikse është monopolist në ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet, do të thotë që sikurse dhe Albtelecom përmbushin të gjitha kushtet për të qenë FNT për terminimin në rrjetet e tyre, dhe nuk ka asnjë arsye të trajtohen të diferencuar nga Albtelecom. Me shumë argumente Albtelecom ka dhënë në kontin e pyetjes 4/i.

VODAFONE ALBANIA

VA shprehet dakord me gjetjet e AKEP. Cdo operator i telefonisë fikse është dominant për terminimin e thirrjeve në rrjetin etij.

TEKEKOM ALBANIA

Sic Telekom ka theksuar dhe në analizen e tregut fikse në 2013, edhe pse operatorët alternativë dhe Telekom FIX kanë FNT në tregun e terminimit, këta operatorë nuk i plotësojnë kriteret për të pasur FNT në këto tregje, kriteret këto të lidhura me pozicionin dominant të operatorit të parashikuar nga Udhezimi i BE-së për analizen e tregut dhe vlerësimin e FNT-së 2002/C 165/2003. Disa nga këto kriteret janë: a) kuota në përqindje e kontrollit në treg; b) dimensionin e operatorit; c) avantazhet dhe superioriteti teknologjik në treg; d) mungesa e fuqisë kundërvepruese; e) akses i privilegjuar në burimet financiare; f) ekonomia e shkallës dhe densitetit; g) integrimi vertikal; h) mungesa e një konkurrence potenciale etj. Edhe pse shumë AO së bashku me Telekom Fix tashmë kanë disa vite që operojnë në tregun e telefonisë fikse, ky treg karakterizohet ende nga pjesë mjaft të lartatë tregu nga ana e operatorit inkumbent, duke pasur pozite dominante, pozite të cilat ekzistojnë nëse ky i fundit zotëron me shumë se 25% të tregut të vetëm. Sic është evidentuar nga dokumenti i analizës, operatori Albtelekom zotëron pjesë mjaft të larta të tregut si në terma të abonentesh, trafikut të daleve dhe të të ardhurave gjatë vitit 2014: 77% në terma të abonentesh, 66% në terma të të ardhurave dhe 86% në lidhje me trafikun të daleve. E njëjta problematikë lidhet dhe me fuqinë e lartë kundërvepruese të operatorit inkumbent, aksesit të privilegjuar në burimet financiare, ekonominë e shkallës, etj. Bazuar në sa më sipër Telekom mbetet i mendimit që AO dhe Telekom Albania nuk i plotësojnë ende kushtet për të pasur status me FNT në tregjet e terminimit në rrjetet e tyre

fikse dhe gjykon qe AKEP duhet ta rishikojë percaktimin me FNT ne tregun e terminimit ne njetet fikse perkatese per AO dhe Telekom Albania .

ABCCom

Persa kohe nuk jane krijuar kushtet e hapjes se tregut per rrjetin lokal dhe aplikimi i LLU ka deshtuar per shkak te implementimit te saj me shume vonese, gje qe detyroi operatorët e tjere te ndertojne rrjetet e tyre te shperndarjes, eshte i drejte arsyetimi qe secili operator mbetet FNT ne rrjetin e vet. Kjo duhet te diktojë vetem rregullimin e tarifave ne terminim, por nuk duhet te sherbeje per detyrimin e operatorëve alternative te zbatojne LLU, sepse teknologjite e perdorura jane shume larg njera tjetres dhe me siguri do te krijojne probleme teknike duke demtuar cilesine e sherbimit te operatorit dhenes. Ne keto kushte eshte e pamundur teknikisht qe te hapet qarku lokal per operatorë te tjere. Keto kushte mund te plotesohen vetem pasi te kene dale ne treg Operatorët e Rrjetit.

QËNDRIMI I AKEP

AKEP gjykon se pretendimin e Telekom Albania e ka trajtuar gjerësisht ne dokumentin per keshillim te Analizes. AKEP ka analizuar faktoret qe ndikojne ne kete treg, te cilat nuk kane ndryshuar dhe nuk pritet te ndryshojne ne nje te ardhme. Si perfundim AKEP i qendron mendimit qe konkluzionet dhe arsyetimet e perdorura ne dokumentin e analizes se konsultuar jane te drejta, parimore dhe plotesojne kriteret e ligjit per AO dhe Telekom Albania fiks ne keto tregje.

6. Cili eshte opinioni juaj per perfundimet e AKEP per origjinimin e thirrjeve nga vendndodhje fikse ne lidhje me:

- i. përfshirjen edhe te origjinimit te thirrjeve nga rrjetet celulare ne kete treg**
- ii. mos-plotesimin e testit te 3 kriterëve**
- iii. derregullimin e ketij tregu**

ALBTELECOM

i. përfshirjen edhe të origjinimit të thirrjeve nga rrjetet celulare në këtë treg

Albtelecom gjykon që përfundimi i AKEP është mëse i drejtë kur përfshin origjinimit e thirrjeve nga rrjetet celulare në këtë treg. Zevendesueshmëria midis shërbimeve të telefonisë fikse dhe asaj celulare sa vjen dhe rritet, tarifat celulare në nivel të ulët, vecanerisht brenda rrjetit dhe aksesit jo me patjeter kunderjt nje abonimi mujor, ka bërë që abonentët e telefonisë kanë zgjedhur gjithmonë e më shumë përdorimin e aksesit nga telefonia celulare krahasimisht me përdorimin apo aksesin nëpërmjet linjave fikse, duke bërë zëvendësimin e thirrjeve nga rrjeti fiks me thirrje nga rrjeti celular. Per kete Albtelecom i referohet edhe statistikave mbi numrin e perdoruesve dhe përdorimit mesatar mujor të thirrjeve për te dyja rrjetet, atë fiks dhe ate celular.

ii. mos-plotesimin e testit te 3 kriterëve

Mbi këtë pyetje Albtelecom gjykon se në kushtet kur nuk ka kërkesë nga operatorët për shërbimet e Z(P)B, për shërbimet e LLU-së apo edhe në rrethanat specifike të Shqipërisë ku rreth 80 AO, që kanë investuar në rrjetet e tyre fikse, përfshirë rrjetet e aksesit, mund të thuhet që origjinimi i thirrjeve në nivel me shumicë nuk ndeshet me pengesa të larta jo-kalimtare, pra të paktën një nga kriteret nuk plotësohet

iii. derregullimin e ketij tregu

Përvec faktit që ky treg, tashmë nuk është as në listën e tregjeve përkatës të rekomanduar nga KE në vitin 2014, duke pasur parasysh sa më sipër dhe se përdorimi i shërbimit të thirrjeve me kartë është gjithnjë në ulje, është më se e drejtë dhe e justifikueshme derregullimi i tregut përkatës të origjinimit të thirrjeve, argumenton Albtelcom.

VODAFONE ALBANIA

i. përfshirjen edhe të origjinimit të thirrjeve nga rrjetet celulare në këtë treg

VA shprehet se njesoj si në rastin e aksesit dhe të thirrjeve të analizuar me sipër nuk jemi në kushtet e zevensueshmerisë dhe kjo është e parakohshme për tu konsideruar për tregun shqiptar. Pjesët e larta të tregut në origjinim tregojnë një dominancë absolute të Albtelcom dhe si pasoje nxjerrja nga rregullimi do të perkeqesoje me tej pozitën e AO dhe konsumatoreve me fuqi të ulet shpenzuese në lidhje me shërbimin e karta me parapagim. VA përmend se në disa raste operatori inkumbent shpesh është akuzuar nga AO për abuzim me pozitën dominuese në lidhje me shërbimin OSHKP dhe ka Vendim të AK që e evidenton këtë. VA shpreh shqetësimin në lidhje me mos përdorimin e ZPB dhe LLU dhe se disa here janë shprehur se ekzistojnë një sere barrierash indirekte që duhen eleminuar, siç janë tarifatat shumë të larta, kostoja e lartë e aksesit fillestar në ZPB, investimet shtesë në miljen e fundit, mungesa e hapësirave në kabinete, etj.

VA i kërkon AKEP që me koherencë dhe analogji të zbatojë të njëjtin qëndrim për tregun e origjinimit ashtu si edhe ka vepruar me tregun e tranzitimit; tesi i 13 kritereve dhe pjesët e tregut të operatorit inkumbent tregojnë qartazi për dominancë të Inkumbentit dhe konkurrenca të pafuqishme, ndaj nderhyrja ex-ante është një domosdoshmëri.

ii. mos-plotesimin e testit të 3 kritereve

Origjinimi i thirrjeve është një shërbim i domosdoshëm për AO që të ofrojë shërbime në nivel pakice. Alternativisht AO duhet të kenë një rrjet të gjërë dhe të konsoliduar (që nuk e kanë) dhe financa për ta mirëmbajtur (që nuk i kanë). Variant tjetër është që AO të mbeshteten nga një kuader i qartë dhe mirëfunksionues për linjat me qera, LLU, bitstream apo ZPB. Analiza faktike tregon qartazi se këto nuk janë prezent ende treg, ndaj nuk mundet që të pretendohet se konkurrenca është ekzistuese e për rrjedhojë duhet hequr rregullimi i operatorit incumbent.

iii. derregullimin e ketij tregu

VA shprehet se operatori incumbent duhet të vazhdojë të jetë i rregulluar si më parë, pasi pjesët e tij të tregut tregojnë për dominancë të theksuar. Përsëri sjell argumentat mbi zevensushmërinë e fiksit të celularit. VA gjykon që kushtet e tregut shqiptar janë në rrethanat që ka parashikuar Rekomandimi i vitit 2007 për tregjet, i cili gjykonte se tregu i origjinimit duhet të jetë objekt i rregullimit ex-ante për shkak të kostove të larta të LLU, ZPB dhe zhvillimit të ulet të AO. Këta të fundit janë të zhvilluar në zona të kufizuara gjeografike dhe ofrojë shërbime për grupe të caktuar pajtimtaresh. Nga ana tjetër ligji i konkurrencës nuk ka mundur ende të zgjidhë problemet e hasura në këtë treg, nderkohe që ka vite që nuk shikohen shenja drejt përmirësimit apo premisa të mundshme drejt konkurrencës efektive.

TEKEKOM ALBANIA

i. përfshirjen edhe të origjinimit të thirrjeve nga rrjetet celulare në këtë treg

Në lidhje me përfshirjen e origjinimit të thirrjeve nga rrjetet celulare në tregun e origjinimit të thirrjeve nga vendndodhje fikse Telekom Albania nuk ndan të njëjtin opinion në lidhje me përfundimet e AKEP për këtë çështje.

Sic Telekom theksoi dhe ne pergjigjen e pyetjes 2 ne lidhje me perfshirjen e aksesit/thinjeve nga nжете celulare ne te njejtin treg me aksesin/thinjet nga vendndodhje fikse, duke qene aksesi dhe thirrjet ne nivel pakice te lidhur vertikalisht me tregun e origjinimit te thirrjeve ne nivel shumice pasi origjinimi sherben si input per ofrimin e aksesit/thinjeve per perdoruesin fundor, per analogji dhe origjinimi nga njetet celulare nuk mund te konsiderohet si zevendesues per origjinimin nga vendndodhje fikse per shkak te karakteristikave funksionale te ndryshme midis ketyre sherbimeve. Argumentimi i perdorur ne lidhje me zevendesueshmerine midis thirrjeve nga nжете celulare dhe nga vendndodhje fikse mund te perdoret dhe ne kete rast per te mosperseritur te njejtin arsyetim.

ii. mos-plotesimi i testit te 3 kritereve

Origjinimi i thirrjeve nga vendndodhje fikse ndodhet ne listen e tregjeve nen rregullim bazuar ne Rregulloren e AKEP per analizen e tregut. Ky treg, duke qene i perfshire ne kete liste do te thote qe e ploteson testin e 3 kritereve, i cili percakton nese nje treg ka nevojte per nderhyrje rregulatore ex-ante, edhe pse ky treg nuk ndodhet me ne listen e tregjeve te rekomandimit te BE-se te tetor 2014. Por karakteristikat e tij ne vendin tone jane shume larg atyre ne vendet e tjera te BE apo dhe te rajonit per shkak te zhvillimit te ulet te telefonise fikse si dhe te pozites qe gezon operatori inkumbent.

Telekom analizon keto kritere. Edhe pse eshte rritur numri i operatoreve alternative qe operojne ne telefonine fikse, nje pjese e vogel e tyre kane shtrirje lokale te rrjetit ne zonat me te medha urbane, por nuk kane nje presence kombetare, edhe pse kane kryer investime te rendesishme ne infrastrukturen e tyre. Bazuar dhe ne statistikat e dhena ne dokument nga ana e AKEP sic shihet dhe ne tabelen e faqe.26, parag.3 "Pjeset e tregut" Seksioni III, vihet re se ne terma pajtimtaresh Albtelekom si operatori incumbent zoteron rreth 77% te tregut gjate 2014, dhe ne term ate trafikut dales rreth 86% te tij gjate ketij viti dhe keto shifra kane qene me luhate te vogla qe nga viti 2012 kur u publikua analiza pararendese e tregut te telefonise fikse. Kjo tregon per pozita mjaft te forta dhe dominante ne treg nga ana e Albtelekom, i cili gjithashtu ka nje presence kombetare te shtrijes se rrjetit ne territor duke i dhene avantazhe kundrejt operatoreve te tjere alternative. Kostot per ndertimin e rrjetit jane mjaft te larta dhe shume operatore nuk mund t'i rekuperojne dot keto kosto ne nje te ardhme te afert per shkak te pozitave te tyre. Kjo situat e pershkruar me siper tregon per barriera te larta te tipit ekonomik te hyrjes ne treg nga ana e operatoreve te tjere, edhe pse nga ana ligjore kuadri eshte lehtesuar dukshem.

Gjithashtu kjo situat e evidenton nje nivel problematik te konkurrences ne treg midis operatoreve larg se qeni efektive. Ndaj kriteri i pare i dhe ai i dyte ne lidhje me mungesen e tendences drejt nje konkurrence efektive plotesohen. Per sa i perket kriterit te trete per tregun e origjinimit te thinjeve, Telekom Albania eshte dakort me AKEP qe ky kriter nuk plotesohet. Zevendesueshmeria e pretenduar e origjinimit nga rrjete celulare me ate te thinjeve nga vendndodhje fikse nuk qendron duke qene se kemi te bejme me sherbime komplementare dhe ky argument nuk ndikon ne nivelin e konkurrences ne tregun e origjinimit nga njetet fikse midis operatoreve.

Si perfundim, Telekom Albania nuk eshte dakort me AKEP ne lidhje me mos-plotesimin e testit te tre kritereve, duke mbetur e mendimit qe ky treg i ploteson keto kritere.

iii. De-rregullimi

Per shkak se ky treg ploteson testin e kritereve ka nevojte per nderhyrje rregulatore ex-ante. Gjithashtu ky treg ndodhet dhe ne listen e tregjeve nen rregullim te Rregullores se AKEP Nr.9 per analizen e tregut. Perfundimet e AKEP per derregullimin e origjinimit te thirrjeve jane te gabuara dhe ne kundersizim me Rregulloren per analizen e tregut te miratuar nga vete AKEP, duke theksuar pwrseri argumentat e dhena ne kometet me siper se eshte pjese e listes se rregullores te tregjeve. Problematikat ne lidhje me nivelin e pamjaftueshem te konkurrences ne kete treg per shkak te pozites dominante te operatorit inkumbent nuk jane eliminuar ende dhe mbeten ekzistuese edhe pse ka pasur zhvillime positive ne telefonine fikse ne saj te investimeve ne teknologji dhe infrastrukture, rritjes se numrit te operatoreve ne kete treg, etj.

Ne konkluzion, Telekom gjykon qe tregu i origjinimit te thirrjeve nga vendndodhje fikse mbetet i justifikuar per nderhyrje rregullatore ex ante nga ana e AKEP dhe perfundimet e nxjerra nga ana e AKEP nuk jane te sakta dhe ne kundershtim me ate cfare parashikon kuadri rregullator perkates.

ABCCom

Ashtu sic theksohet ne konkluzionet e analizes se tregut tashme eshte krijuar mjedis me i pershtatshem per nje konkurrence reale ne treg gje qe ka per rrjedhoje uljen apo dobesimin e masave rregullatore.

Megjithese edhe pse ezistojne ne treg kushte duhet qe AKEP te pershpejtoje implementimin e LLU, share infrastructure, etj te cilat ulin barrierat per hyrjen ne treg te operatoreve te rinj. Per kete AKEP duhet te shkurtoje kohen e pergatitjes, konsultimit dhe miratimit te akteve rregullatore si draft-rregullore te ndryshme qe ka pregatitur.

QËNDRIMI I AKEP

Rishikimi i ofertave te Linjave me qera dhe Bitstream-it nga ana e Albtelecom ne drejtim te ulje se tarifave ne shtator te 2015, miratimi i Rregullores ne korrik te 2015 “Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe asetëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike”, si dhe nga faktoret e analizuar ne dokumentet, AKEP gjykon si te drejte dhe te bazuar ne kuadrin rregullator konkluzionet e nxjerra nga analiza per perfshirjen edhe te origjinimit te thirrjeve nga rrjetet celulare ne tregun e origjinimit te thirrjeve nga vendndodhje fikse treg, mos-plotesimin e testit te 3 kriterëve dhe derregullimin e ketij tregu. Me nivelin e kenaqshem te penetrimit te telefonise celulare perdorimi i sherbimit OSHKP po zevendesohet me sherbimin nga celulari. Konkurenca e operatoreve fikse ne Shqiperi eshte bazuar mbi te rrjetet individuale te cdo operatori dhe pjeset e tregut te larta (por me ulje nga 2011 e ne vijim te Albtelecom) jo domosdoshmerisht tregojne per dominace te operatorit incumbent ne treg, por ato duhen marre ne kompleksitet me faktore te tjere, per te cilat AKEP eshte ndalur gjate ne dokumentin per keshillim. Nisur nga keto pjese te tregut shohim qe pjesa e AO ka ardhur ne rritje dhe po zgjerohet nga vitit ne vit, sic edhe ka shprehur ne komente e saj dhe Autoritet i Konkurrences, duke vlerësuar se dokumenti ka adresuar drejt çështjen e konkurrencës dhe se ndërmarrja “Albtelecom” ka rënie të pjesëve të tregut, duke u ndeshur me konkurrencë të operatorëve te tjere.

Gjithsesi, AKEP gjykon se sherbimet e OSHKP-ve do te duhet te jene pjese e ofertes reference te interkoneksionit te rishikuar te Albtelecom, pasi ato sherbejne ne rritjen e zgjedhjeve per perdoruesit e thirrjeve telefonike fikse dhe konkurrencen ne kete treg. Per keto sherbime Albtelecom do te duhet ti ofroje sipas kushteve aktuale deri me 1.05.2016 dhe me pas do te duhet percaktoje nje oferte te re (pjese e rishikimit te RIO sipas vendimeve per FNT me kete dokumnet analize), bazuar ne tarifate e reja te terminimit te percaktuara nga AKEP.

7. Cfare mendoni per masat rregullatore te propozuara nga AKEP per terminimin, dhe tranzitimin ne rrjetin Albtelecom:

i. A sjell perfitime per tregun reduktimi i segmenteve te terminimit nga 2 ne 1?

ii. Cfare mendoni per reduktimin e propozuar te tarifave te interkoneksionit te Albtelecom?

ALBTELECOM

Ne komente mbi kete pyetje Albtelecom eshte ndalur gjate dhe ka dhene sygjerime edhe ne hyrje të komneteve duke u ndalur në tre pika kyersore:

- Kalimi në një segment të vetëm kombëtar
- Reduktimi i pikave të interkoneksionit të Albtelecom, nga 12 në 2
- Masat rregullatore të propozuara për tregjet FNT të Albtelecom (detyrimi i ndarjes së llogarive), tarifat e terminimit dhe të tranzitimit të thirrjeve.

Albtelecom është dakort për kalimin në një segment kombëtar, por për arsye të argumentuar në vijim, angazhohet që të mbajë/ofrojë 12 pika interkoneksioni të paktën edhe 1 vit nga afati i propozuar në dokument, pra deri më 01.01.2018. Gjithashtu për arsye si:

- reduktimi i prituri i tarifave të terminimit,
- arsyetimi i AKEP në rastin e heqjes së këtij detyrimi operatorëve celularë,
- zbatimin rigoroz nga Albtelecom të detyrimit të ndarjes së llogarive midis segmentit Fix dhe Mobile të biznesit dhe provimit të tij kundrejt Autoriteteve,
- mungesës së problematikave në tregun e telefonisë fikse krahasimisht me tregun e telefonisë celulare, e ku megjithatë operatorëve në këtë treg iu hoq ky detyrim
- kryerjes së raportimeve të ndara në AKEP për të ardhurat nga telefonia fikse dhe celulare;
- krijimit të disavantazhit për Albtelecom në pikpamje të kostove shtesë të domosdoshme për gjithë procesin e implementimit dhe auditimit në kuadër të zbatimit të këtij detyrimi si i vetmi operator në treg që mbetet subjekt i këtij detyrimi ndërkohë që për nga rrethanat Albtelecom nuk është në pozicion të ndryshëm nga operatorët e tjerë që të jetë i nevojshëm mbajtja e këtij detyrimi;

Albtelecom kërkon heqjen e detyrimit për ndarjen e llogarive dhe llogaritjet e kostove, në tregjet e terminimit të thirrjeve dhe tranzitimit të thirrjeve kombëtare.

i. A sjell perfitime per tregun reduktimi i segmenteve te terminimit nga 2 ne 1?

Albtelecom, siç dhe është shprehur në korrespondenca të mëparshme të tij mendon se reduktimi i segmenteve të terminimit nga 2 në 1 është një proces pozitiv dhe përfitues për operatorët alternativë, për Albtelecom dhe gjithashtu për konsumatorin/përdoruesin fundor, për disa arsye të renditura më poshtë:

- Thjeshtëzon tarifimin në tregun me pakicë (retail) për përdoruesit fundorë;
- I mundëson operatorëve përfshirjen në paketat e tyre të një tarife të padiferencuar për çdo thirrje të kryer në territorin e Shqipërisë, duke eliminuar hezitimin e përdoruesve të telefonisë fikse për të kryer thirrje kombëtare(thirrje jashtë rajonit).

- Krijon premisa për mosdiferencim të thirrjeve drejtuar destinacionit fix/mobile, duke nxitur në këtë mënyrë kryerjen e thirrjeve nga telefoni fiks në rrjetet mobile dhe anasjelltas;
- Krijon lehtësira dhe thjeshton procesin e implementimit teknik në lidhje me numeracionin e operatorëve, faturimet mes tyre, etc);
- Krijon lehtësira në administrimin e marrëdhënieve mes operatorëve, dhe eliminon apo minimizon konsumin e panevojshëm të burimeve për shkak të trajtimeve të ndryshme edhe të diferencave të trafikut që mund të ndodhin në segmentin lokal apo kombëtar të ndarë dhe të sasisë së vogël të trafikut në këto segmente.

ii. Cfare mendoni per reduktimin e propozuar te tarifave te interkoneksionit te Albtelecom?

Lidhur me reduktimin e propozuar të tarifave të interkoneksionit të Albtelecom dhe afatet e propozuara, Albtelecom parashtrori argumente e tij si më poshtë:

Për tarifat e terminimit:

Lidhur me reduktimin e tarifave të terminimit të Albtelecom dhe afatet e propozuara:

- Albtelecom mirëkupton nevojën dhe domosdoshmërinë e përcaktimit të një tarife të vetme nga 01/01/2016 me kalimin në një segment të vetëm kombëtar, dhe njëkohësisht shpreh dakortësinë e tij lidhur me mënyrën e llogaritjes së kësaj tarife për këtë periudhë.
- Por, nga ana tjetër nuk është dakort me propozimin për përcaktimin e tarifave të terminimit në rrjetet fikse për periudhën e dytë nga 01/01/2017, sipas vlerave të përcaktuara në dokumentin e analizës, dhe mendon se përcaktimi i tyre për periudha të mëtejshme të lihet në analizën e radhës të tregut të telefonisë fikse. Kohë kjo që do të shërbejë për një maturim sa më të mirë të mbylljes së fazës së kalimit me një segment të vetëm kombëtar.
- Nëse AKEP nuk konsideron sa më sipër, Albtelecom propozon një përshkallëzim më të butë të tarifës së terminimit për periudhën e dytë nga 01.01.2017-31.12.2017, dhe propozon si tarifë terminimi, tarifën 1.32 lek/min, e cila është tarifa mesatare e ponderuar për trafikun e terminuar në rrjetin fiks të Albtelecom nga Operatorët Alternativë dhe Telekom Albania Fiks.

Në lidhje më këtë, Albtelecom mendon se:

Përsa i takon uljes drastike të tarifës së terminimit të propozuar nga 01.01.2017, Albtelecom nuk paragjykon zgjedhjen apo mënyrën e përcaktimit të kësaj tarife, por mendon se reduktimi dhe përcaktimi i tarifës së terminimit për periudhën e dytë (01.01.2017-31.12.2017) duhet të jetë një tarifë të ndërmjetme para së të shkojë në të njëjtin nivel me tarifën mesatare të terminimit të vendeve të BEREC që aplikojnë 1 segment. Argumenta për këtë koment Albtelecom sjell penetrimin e ulet(trafik hyren ne renie nga rrjet fikse), demtimet ne infrastrukturë, investimet me kthim të vonuar.

Në lidhje me kalimin nga 12 ne 2 pika interkoneksioni, heqje e tarifes për thirrje dhe reduktimi e FTR ne afatet e përcaktuar në Analizë, Albtelecom akoma nuk është gati pasi koha e maturimit të të rrjetit NGN është e shkurtër dhe fakti që akoma nuk janë në fazën me IP për shkak të topologjisë së rrjetit të AO. Albtelecom sygjeron të këtë një fazë të

ndërmjetme, vlera prej 0.7 lek/min të aplikohet më 01.01.2018 bashke me kalimin në këtë datë nga 12 në 2 pika interkoneksioni. Dukë vazhduar arsyjetimin e tij Albtelecom argumenton se tregu i telefonisë fikse në Shqipëri nuk paraqet në asnjë komponent të tij problematika/ngjashmëri me tregun e telefonisë mobile ku me të drejtë është propozuar reduktim i konsiderueshëm i tarifave të terminimit nga Dhjetor 2014. Pjesët tregut të Albtelecom kanë ardhur vit pas vitit duke u ulur në pajtimtarë të telefonië fikse ashtu edhe pajtimtarëve me akses broadband. Gjithashtu në aspektin e përdoruesit nuk është vënë re diskriminimi i tarifave brenda dhe jashtë rrjetit. Në asnjë rast tarifat e terminimit të operatorëve të rrjeteve fikse nuk janë përdorur nga vetë operatorët për të diferencuar tarifat për thirrjet me pakicë të abonentëve të tyre, nëse kryhen brenda rrjetit të të njëjtit operator, apo nëse abonenti i thirrur është i ndryshëm nga thirrësi. Reduktimi i FTR në 0.7 lek/min(01.01.2017) do të çojë në ulje 30% të të ardhurave nga terminimi të Albtelecom në marrëdhëniet e interkoneksionit me Operatorët e tjerë fikse në treg dhe Telekom Albania Fiks; apo 33% ulje të të ardhurës nga interkoneksioni kombëtar me operatorët alternativë (terminim+tranzitim) konsideruar dhe ndryshimin e tarifës së tranzitimit në 0.43 lek/min.

Në përfundim, duke marrë në konsideratë:

- heqjen përfundimtare të tarifës për thirrje në shërbimet e terminimit dhe tranzitimit;
- angazhimin tonë për mbajtje të 12 pikave të interkoneksionit edhe për 1 vit më shumë nga afati i propozuar nga AKEP (deri në fund të vitit 2017),
- duke siguruar një proces gradual dhe të shtrirë në kohë për operatorët alternativë për kalimin/lidhjen e tyre të detyrueshme në një nga 2 pikat e interkoneksionit të Albtelecom;

Albtelecom propozon një glidepath më të zbutur dhe tarifat e terminimit si më poshtë:

Tabela 1- Tarifat e Terminimit në rrjetit Fiks të Albtelecom

Terminim	01.09.2014	01.01.2016	01.01.2017	01.01.2018
Lokal/Njefish (lek/min)	1.19	1.52	1.32	0.7
Dyfish (lek/min)	1.85			
Ndryshimi ne %			-13%	-46%

Shënim: Tarifa e terminimit e propozuar për periudhën nga 01.01.2017-31.12.2017, (1.32 lek/min), bazohet në tarifën mesatare të ponderuar të trafikut të terminuar nga Operatorët Alternativë dhe Telekom Albania Fiks në Albtelecom.

Për tarifat e tranzitimit:

Lidhur me reduktimin e propozuar në tarifat e tranzitimit 0.93 lek/min nga 01.01.2016 dhe 0.43 lek/min nga 01.01.2017, Albtelecom mendon se është i përshpejtuar dhe i kërkon AKEP reduktimin e kësaj tarife sipas një glidepath-i të përshkallëzuar më të zbutur.

Për këtë, janë dhe qëndrojnë të njëjtat argumenta që Albtelecom dha për rastin e reduktimit të propozuar të tarifës së terminimit si: penetrimin e ulet(trafik hyren ne renie nga rrjet fikse), demtimet ne infrastrukturë, investimet me kthim të vonuar.

Gjithashtu duke konsideruar dhe marrë parasysh edhe sa më poshtë:

- angazhimin e Albtelecom (shih komentet tona në pikën 2.), lidhur me disponibilitetin e tij për të mundur lidhjen me “detyrim” në 12 pikat e interkoneksionit të paktën në 1 vit nga afati 1-vjecar i propozuar në dokument
- heqjen e tarifës për thirrje nga 01.01.2016,
- si dhe, kohën akoma të shkurtër të maturimit të rrjetit NGN të Albtelecom;

Albtelecom propozon glidepath-in dhe tarifat e tranzitimit, si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2- Tarifat e tranzitimit të trafikut kombëtar

Tranzitim	01.09.2014	01.01.2016	01.01.2017	01.01.2018
Tarifa e tranzitit (lek/min)	1.32	1.1	0.80	0.43
Ndryshimi ne %		-15%	-28%	-46%

Shënim: Tarifat e tranzitimit të propozuara nga Albtelecom: 1.1 lek/min për periudhën nga 01.01.2016 dhe 0.8 lek/min nga 01.01.2017, reduktohen me në 15% në periudhën e parë dhe 28% në periudhën e dytë, ç'ka është dhe më e justifikueshme për kushtet apo specifikat e tregut dhe operatorëve të telefonisë fikse në Shqipëri.

VODAFONE ALBANIA

në lidhje me këtë pyetje VA ka shkrehur dakordësinë për me propozimin e AKEP për aplikimin e tarifave simetrike të terminimit midis të gjithë operatorëve ekzistues në treg, pasi asimetria nuk është në përputhje me kuadrin rregullator ekzistues.

i. A sjell përfitime për tregun reduktimi i segmenteve të terminimit nga 2 në 1?

VA mbështet mendimin, ashtu sikurse edhe në komunikime të tjera, se kalimi në një segment të vetëm tarifimi së bashku me zbritjen e pershkallesuar të tarifave të terminimit të telefonisë fikse si dhe aplikimin e tarifave simetrike për të gjithë operatorët e rrjeteve fikse menjëherë sjell përfitime të mëdha në tregun e telefonisë fikse.

ii. Cfare mendoni për reduktimin e propozuar të tarifave të interkoneksionit të Albtelecom?

VA gjykon se glide-path i propozuar nga AKEP duhet të rishikohet për të reflektuar me korrektesë dhe barazi realitetin e ofruar nga praktikët europianë, kostot që mbartin operatorët fikse përkundërsht atyre celularë dhe që të garantojë mosdiskriminim krahasuar me benchmark-un e aplikuar ndaj operatorëve celularë para pak muajsh nga AKEP.

Duke marrë për bazë statistikën dhe metodologjinë e BE, VA argumenton se FTR dhe MTR janë në raportin 1:5 në favor të MRT. VA vlerëson se niveli i FTR të propozuar nga AKEP mbetet ende në nivele shumë të larta krahasuar me MTR, të cilat AKEP po i kon në kostot e operatorit eficient, sipas një glide-path-i tepër të mprehtë. Në këtë kontekst, VA sugjeron që FTR duhet të synojë qasjen e shpejtë në mesataren e benchmarkut të FTR sipas pure LRIC, njësoj si dhe vepruar me MTR. VA shpreh jo dakordësi me vlerësimin e AKEP se mbajtja e FTR në nivele të më të larta do të ndihmojë rritjen e konkurrencës në treg dhe i përshtratet karakteristikave të tregut shqiptar dhe kostove që mbartin operatorët e telefonisë fikse krahasuar me ata celularë - kostot e rrjetit janë gjithmone më të larta për operatorët celularë pasi lidhen ngushtesisht me rrjetin e aksesit çka rrjedh në diferencën e madhe në strukturën e kostove mes rrjeteve fikse dhe celularë sic edhe e reflekton praktika e BE.

Tek telefonia fikse kostot e telit të bakrit nuk përfshihen në kostot e shërbimeve zanore, kurse tek telefonia celularë kostoja e stacioneve baze përfshihen në koston e këtij shërbimi. Nga ana tjetër, përhapja e gjere e shfrytëzimit të telefonisë celularë në një treg me 4 operatorë rrjeti jo detyrimisht përthëhet në ulje kostosh për operatorët celularë, pasi avantazhet e ekonomive të shkallës nuk aplikohen si në rastet e tregjeve me kosto të ulëta hyrjeje. Ndaj FTR janë gjithmone ndjeshëm më të ulëta se MTR. Duke iu referuar Rekomandimit të 2009 të KE në lidhje me tarifën e terminimit në rrjete fikse dhe celularë, VA kërkon nga AKEP sqarime se përse në rastin e operatorëve celularë e zbaton me rigorozitet orientimin në kosto, por nuk ndjek të njëjtin standart me telefoninë fikse.

AKEP duhet të mbështetet në kuadrin rregullator dhe praktiken e vendeve të BE dhe të garantojë trajtimin jodiskriminues dhe më të njëjtin standart të MTR përkundërsht FTR. Nga

ana tjetër sic edhe praktika por edhe teoria ekonomike ka treguar, përafërimi i FTR me koston e operatorit eficient do të rezultojë në rritjen e konkurrencës, eliminimin e inefficencave në treg, duke nxitur operatorët në treg për të qenë më inovative dhe eficientë, çka do të reflektohet dhe në ulje të tarifave për pajtimtarët fundorë.

TELEKOM ALBANIA

i. A sjell përfitime për tregun reduktimi i segmenteve të terminimit nga 2 në 1?

Reduktimi i segmenteve të terminimit nga 2 në 1 sjell përfitime për tregun e telefonisë fikse dhe atë të terminimit në përgjithësi. Sic Telekom është shprehur dhe në analizën pararendëse të tregut të telefonisë fikse të 2013, ky reduktim i cili ka disa kohe që është në proces thjeshton marrëdhëniet e interkoneksionit midis operatorëve dhe ka ndikim në reduktimin e kostove të interkoneksionit. Me reduktimin e segmenteve nga 2 në 1 përfitimet për operatorët janë të dukshme si nga ana teknike në terma të implementimit të lidhjeve të interkoneksionit midis operatorëve, ashtu dhe nga ana komerciale pasi ul kostot përkatëse për operatorët.

ii. Cfare mendoni për reduktimin e propozuar të tarifave të interkoneksionit të Albtelecom?

Telekom Albania është dakort në parim me reduktimin e tarifave kombëtare të interkoneksionit (terminimit dhe tranzitimit kombëtar) për Albtelecom, duke qenë se ka FNT në këto dy tregje. Por dhe në këtë dokument AKEP perseri nuk ka dhënë evidencë në lidhje me kostot përkatëse për përlogaritjen e këtyre tarifave. Në konsultimet publike të mëparshme të telefonisë fikse të 2012 dhe të 2014, AKEP-it i është kërkuar vazhdimisht nga Telekom Albania, implementimi i një modeli për përlogaritjen e kostove përkatëse të interkoneksionit në mënyrë që reduktimi i tarifave të jetë i orientuar në kostot efektive që operatorët fiks manifestojnë. Telekom Albania është shprehur, ashtu si dhe në analizat e mëparshme, për publikimin e modelit BULRAIC të kostove të interkoneksionit për Albtelecom, sic parashikohet në direktivat përkatëse të BE-së sipas të cilave tarifimet me shumicë të interkoneksionit duhet të jenë të orientuara në koston sipas operatorit eficient.

Reduktimi i propozuar i tarifave të terminimit dhe tranzitimit të Albtelecom dhe unifikimi i tyre në një nivel të vetëm është gjithësesi një hap pozitiv nga ana e AKEP duke ulur në këtë mënyrë kostot e operatorëve të tjerë nga ana financiare në marrëdhëniet përkatëse të interkoneksionit. Vendosija e simetrisë së tarifave të terminimit fiks kombëtar për të gjithë operatorët e telefonisë fikse duke filluar nga 1.01.2016, sic propozohet në këtë analizë tregu, është një sinjal pozitiv që shmang sjelljet diskriminuese midis operatorëve si dhe nxit konkurrencën në tregun e telefonisë fikse. Bazuar në sa më sipër Telekom Albania përshëndet nismën e AKEP për reduktimin e tarifave të interkoneksionit për Albtelecom dhe pasjen e një niveli të vetëm të këtyre tarifave në nivel kombëtar, por objeksioni që Telekom shpreh është mungesa e një modeli kostosh për të pasur tarifa të bazuara në koston të sakta që shfaqin operatorët, pasi vlerat e propozuara nuk reflektojnë realisht kostot përkatëse që Albtelecom manifeston.

ABCCom

ABCCom mendon se ndryshimet e propozuara do të kenë efekt në thjeshtëzimin e tarifimit të operatorëve me njëri-tjetrin dhe për pajtimtarët.

Nuk mendojmë që këto tarifa do të jenë një shtytse e re në konkurrencën në treg për thirrjet telefonike fikse paralelisht apo të shërbejnë si stimul për zgjidhjen apo minimizimin e problematikave dhe tarifave të ndryshme on-net- off-net të ngjashme me tregun celular.

Këto mund të shërbejnë në stimulimin për të kaluar në një sistem tarifimi unik në rrjetet fikse dhe celulare pavarësisht destinacionit fiks/celular

QËNDRIMI I AKEP

Lidhur me kërkesën e Albtelcom heqjen e detyrimit për ndarjen e llogarise AKEP gjykon se kjo masë rregulluese krijon një klimë mirëbesimi për strukturën e konkurrencës, investimeve dhe inovacionit. Ky detyrim rrit qartësinë, duke e fokusuar rregullimin në çështje me rëndësi, sidomos në kompani si Albtelcom që janë të integruara vertikalisht dhe ofrojnë shërbime si nga rrjete fikse ashtu edhe ato celulare. Kjo masë rregulluese siguron bazat për derregullimin e tregut më pakicë dhe origjinimit me shumicë.

Ne lidhje me komentet e Telekom Albania për ndertimin e një modeli kostoje, AKEP sqaron se përdorimi i benchmark-ut është një metodologji në përputhje me Ligjin 9918, i ndryshuar, nëni 57.

Përsa i përket komenteve të Albtelcom, AKEP ka vendosur marrjen pjeserisht në konsiderate të tyre për nivelin dhe kohën e aplikimit të tarifave të reja të terminimit/tranzitimit. Këto ndryshime janë dhënë në këtë version final të dokumentit të analizës së tregut.

8. Cfare mendoni per masat rregullatore, perfshire rregullimin dhe nivelin e tarifave, te propozuara nga AKEP per operatoret alternative per FNT per terminimin ne rrjetet e tyre fikse dhe per Telekom Albania per terminimin e thirrjeve drejt Telekom Albania Fiks?

ALBTELECOM

Lidhur me masat rregullatore, nivelet e tarifave dhe afatet e tarifave të terminimit të propozuara nga AKEP për operatorët alternativë dhe Telekom Albania fikse, Albtelcom ashtu siç arsyetoi edhe për tarifën e terminimit në rrjetin e vet, shpreh dakortësinë e tij për propozimin e një tarife të vetme dhe simetrike për të gjithë operatorët nga 01/01/2016, 1.52 lek/min. Përsa i takon propozimit të tarifës së terminimit 0.7 lek/min nga 01/01/2017, Albtelcom nuk është dakort me përcaktimin e kësaj tarife, dhe propozon tarifën e terminimit edhe për operatorët e tjerë sipas tabelës 1 më sipër (në përgjigje të pyetjes 7/ii).

VODAFONE ALBANIA

Sic edhe është shprehur gjatë përgjigjeve në pyetjen e mesipërme edhe komenteve të sjella gjatë dokumentit për “Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse - keshillim publik”, VA shpreh dakord me propozimin e AKEP për aplikimin e tarifave simetrike të terminimit midis të gjithë operatorëve të telefonisë fikse. Simetria është në përputhje me kuadrin rregullator ekzistues vendas e të BE, si dhe mbështetet në praktiken rregullatore Europiane. Sipas këtij standardi, simetria në tarifën e terminimit të operatorëve në treg rezulton në promovimin e konkurrencës eficientë, shmang diskriminimin dhe nxit inovacionin duke sjelle kështu me shumë përfitime për pajtimtarët.

TELEKOM ALBANIA

Sic edhe ka komentuar në përgjigjen e pyetjes pararendesi Telekom Albania është dakort me simetrinë e tarifave. Por ajo shpreh përseri objeksionin e saj në lidhje me përdorimin e metodologjisë benchmark për rregullimin e tarifave të terminimit edhe në rrjetet e telefonisë

fikse per argumenta e dhena mw siper duke gjykuar per ndertim te nje modeli nga ana e AKEP, bazuar ne Ligjin dhe Direktiva e BE nw qellim tw kwsaj ceshtjeje.

Gjithashtu, duke qene se Telekom Albania eshte i mendimit qe nuk i permbush kushtet per FNT ne tregun e terminimit, dhe sic edhe eshte shprehur dhe ne analizat pararendese te telefonise fikse, tarifat e terminimit duhet te jene te nje natyre rekomanduese.

Sa i perket masave te tjera rregullatore (detyrimeve per transparence, mosdiskriminim dhe dhenie akses per interkonkesion) ne tregun e terminimit per operatoret alternative dhe Telekom Albania, duke qene se Telekom Albania nuk i ploteson kriteret per te qene me FNT ne tregun e terminimit ne rrjetet fikse, gjykon qe masat rregullatore te propozuara nga ana e AKEP jane te teperata, pasi keto masa jane te panevojshme

ABCom

Vendimi i AKEP per deklarimin FNT te operatoreve alternative ne nje analize te ngushte eshte i drejte, por duke e pare ne raport me tregun dhe cfare vendi zene keta operatore ne treg duket pa efek real.

Te gjithë operatorët alternative janë në kushte të operatorit "new entry" në treg, pavarësisht kohës së gjatë që mund të kenë në treg. Ky treg vazhdon të jetë monopoli dhe i dominuar nga AT. Rregullimi i tarifave të operatoreve alternative kufizon lirinë dhe konkurrencën në treg dhe zgjat kohën e futjes në treg të këtyre operatoreve.

Propozimi i ABCom do të ishte që kjo tarifa nuk mund të jetë e njëta apo gati të njëjta me tarifat e terminimit në rrjetin e operatorit incumbent, por duhet të ketë asimetri.

QËNDRIMI I AKEP

Lidhur me komente të bera nga operatorët alternative dhe Telekom, AKEP ka dhënë argumentat e tij në komente të mesipërme dhe në dokument dhe i qëndron gjykimit të tij se AO dhe Telekom fikse janë FNT për terminim në rrjetet fikse.

9. Cfare mendoni per de-rregullimin e plote te tregjeve me pakice te telefonise fikse, nderkohe qe de-rregullimi i tarifave me pakice filloi me 1.01.2014?

ALBTELECOM

Në vijim të komenteve të dhëna në pyetjen nr.3, Albtelecom jep dakortësinë e tij më propozimin e AKEP të mirëpritur prej kohësh për heqjen e kësaj mase mbi Albtelecom. Derregullimi i plotë i tregjeve me pakicë të telefonisë fikse duhej tashmë të kishte ndodhur duke parë jo vetëm zhvillimet e këtij tregu ndër vite por duke parë kryesisht forcimin e vazhdueshëm të tregut të telefonisë celulare dhe efektin e fortë të zëvendësueshmërisë së telefonisë fikse me atë celulare. Akoma më shumë shërben si argument, edhe sjellja e Albtelecom pas derregullimit të tarifave me pakicë më 01.01.2014 pas procesit të Analizës së tregut të vitit 2013. Këtu Albtelecom merr për shembull sjelljen e tij gjatë 2 vjetëve, ku përcaktimi i tarifave për shërbimet e telefonisë fikse janë orientuar thjesht nga konkurrenca, kërkesa e tregut dhe përpjekja për ta mbajtur sa më atraktiv këtë treg gjithmonë e në rënie, cka demonstron për konkurrencë efektive dhe eficientë ndërmjet operatorëve të telefonisë fikse të cilët konkurojnë fort ndërmjet njëri-tjetrit për numrin e pajtimtarëve dhe gamës së shërbimeve të ofruara.

VODAFONE ALBANIA

Masat e vendosuar në Analizen 2013 në lidhje tregjet me pakicë të telefonisë fikse, me synim krijimin e fleksibilitetit për Albtelecom në tarifimin e shërbimeve, për plotësim me të mirë të kërkesave të konsumatorëve dhe nxitje për investime në linja të reja telefonike pra dhe rritje të penetrimit të telefonisë fikse, sipas VA kanë rezultuar kështu. Penetrimi i kësaj telefonie është në nivel të ulët, vëhet re se operatorët e telefonisë fikse nuk i kanë shoqëruar uljet e tarifave të shumices me ulje të tarifave të pakicës çka do reflektohej në përfitime për pajtimtarët fundorë. Përkundrazi, operatorët e telefonisë fikse, veçanërisht ai incumbent kanë rritur me tej tarifën fundorë dhe shumëfishuar marzhin e fitimit duke përfituar në mënyrë të padrejtë, jo të orientuar në kosto, në dem të pajtimtarëve fundorë, argumenton VA. VA është e mendimit se AKEP nuk duhet t'i heqë detyrimet e vendosura në Analizën e tregut të vitit 2013 për Albtelecom në nivel pakicë (detyrimin për transparencë, për mosdiskriminim si dhe ofrimin e Z(P)B), përkundrazi duhet t'i mbajë ato si në Analizën e vitit 2013, për të garantuar konkurrencën e ndërshtme në treg dhe maksimizimin e përfitueshmërisë së pajtimtarëve.

Lidhur me ofrimin e shërbimit Z(P)B, VA në parim vlerëson se ky detyrim duhet të vazhdojë të qendrojë për Albtelecom si operatori dominues në treg me 77% pjesë të tregut pajtimtarë të telefonisë fikse, pasi ndihmon në rritjen e konkurrencës dhe zgjeron mundësinë e pajtimtarëve në treg për të zgjedhur operatorin e dëshiruar me kosto të ulura. Por për këto nevojitet një analizë e veçantë (jashtë analizës së tregut të telefonisë fikse), ku AKEP dhe palet e interesuara duhet të diskutojnë në detaj tregun përkatës dhe të shqyrtojnë si mund të funksionojë në të ardhmen, përfshirë uljen e domosdoshmë të tarifave të larta që veprojnë si bariere financiare për shfrytëzimin e shërbimit.

Në kushtet e tregut shqiptar të telefonisë fikse kostot e larta administrative të aplikuar nga Albtelecom për përfitimin e këtij shërbimi përbejnë një pengesë konkrete për zhvillimin e tij. Kjo çon në mungesën e marrëveshjeve midis Albtelecom me operatorët alternativë lidhur me ofrimin e këtij shërbimi. Për këto arsye VA beson se rregullimi i kostove administrative lidhur me këto shërbim do ta bente më tërheqës atë.

Në përfundim VA thekson se, AKEP duhet të mbajë në vëmendje bashkimin mes Albtelecom dhe Eagle Mobile, i cili e ka fuqizuar me tej operatorin inkumbent, duke i dhënë mundësinë të pozicionohet më mirë si operator i vetëm dhe ekskluziv në tregje të konvergjuar dhe oferta 4 fishe. Duke vëzhguar raportin krahasimor të paketave tarifore që ofrojnë operatorët e telefonisë fikse vëhet re se pavarësisht se AO ofrojnë cmime me të ulëta se operatori inkumbent, ata e kanë të pamundur të shpërbejnë dominancën e Albtelecom. Nderkohe inkumbenti përfiton nga konvergimi për të ofruar shërbime celulare me cmime shumë të ulëta, çka nuk konkurrohet dot nga AO e tjere. VA është e mendimit se e gjitha kjo kërkon vëmendje rregullatore të shtuar ndaj operatorit inkumbent dhe jo de-rregullim.

TELEKOM ALBANIA

Edhe pse tregu në telefoninë fikse është karakterizuar nga zhvillime pozitive për një sërë faktorësh që Telekom i ka përmendur edhe në paragrafet e mësipërme, ende ky treg paraqet problematika për sa i përket nivelit të konkurrencës. Këto argumente Telekom i ka sjellë edhe në komente të pyetjeve nr.6.

Vlerat e larta të pjesëve të tregut nga ana e Albtelekom, avantazhi që gëzon në saj të mbulimit të gjithë territorit me njetin e tij, evidentojnë ende për një treg të pastabilizuar nga ana e konkurrencës megjithë dinamikën pozitive të hasur në këto vite. Kjo situatë në të cilën ndodhet tregu me pakicë të telefonisë fikse evidenton nevojën për një mbikqyrje dhe për mbajtjen në fuqi të masave rregullatore aktuale sic janë detyrimi për transparencë, mosdiskriminim, si dhe të kontrollit të tarifave të origjinimit për operatorin Albtelekom duke qenë se tregu me shumicë të origjinimit i lidhur vertikalisht me tregun me pakicë nuk i plotëson ende kushtet për de-rregullim sic është propozuar në këto dokumente nga AKEP.

Telekom Albania edhe njehere pohon se AKEP eshte duke mbajtur dy pozicione krejt te kunderta ne lidhje me keto dy tregje.

Situata ne tregun e telefonise fikse eshte shume me ndryshe nga ajo ne telefonine celulare per shkak te shume faktoreve: norma e ulet e penetrimit e telefonise fikse, pozita dominante ne tregun e telefonise fikse nga ana e operatorit inkumbent krahasuar me operatoret e tjere fikse (pjeset e larta te tregut ne nivel abonentesh, te ardhurash dhe te trafikut qe origjinohet nga Albtelekom) sic eshte evidentuar ne paragrafet me siper, avantazhet qe gezon ky operator per shkak te mbulimit te pjeses me te madhe te territorit me njet dhe te aksesit me te madh ne burime financiare per njedhoje te te ardhurave me te larta qe ka ky operator. Keta faktore evidentojne problemet qe ka konkurrenca ne kete treg dhe nevoja per ta mbajtur nen mbikqyije nag ana e entit rregullator. Propozimi per nje derregullim te plote nga AKEP eshte i gabuar duke pare situaten ne te cilen ndodhet tregu me pakice i telefonise fikse aktualisht. Nderkohe qe AKEP nderhyn kur niveli i konkuresces ne tregun e telefonise fikse me pakice eshte i larte dhe i kenaqshem, ne anet tjeter derregullon plotesisht tregut me pakice te telefonise fikse qe nuk eshte ende konkumies dhe ku eshte akoma e domosdoshme lenia nenrregullim e tij, per faktoret e sipermendur.

Ne vijim te sa me siper Telekom Albania nuk eshte dakort me de-rregullimin e plote te tregjeve me pakice te telefonise fikse, per me teper kur tregu me pakice i aksesit nga vendndodhje fikse eshte akoma ne listen e tregjeve nen rregullim te Rregullores nr.9 te AKEP per analizen e tregut.

ABCCom

De-rregullimi i plote ne kushte e dominances se Albtelecom ne rrjetin fix eshte i parakoheshem. Deklarimi OFNT i AT eshte i domosdoshem persa kohe akoma nuk eshte krijuar tregu alternativ i cil vazhdon te gjej veshtiresi ne tregjet per te cilat AT eshte shpallur FNT.

QËNDRIMI I AKEP

De-rregullimi i tarifave me pakice, i cili filloi te aplikohet me daten 01.01.2014 tregoi qe sjelljet e Albtelekom nuk jane te pavaruar nga ato te operatoreve konkurrenente duke e bere Albtelecom te humbe pjese tregu si ne pajtimatare edhe ne te ardhura. AKEP ka analizuar efektet e derrgullimit te tarifave te ALbtelcom ne kete analize dhe nuk rezulton qe kete pasur problem ne konkurrencen midis operatoreve.

AKEP sqaron Telekom edhe njehere se, bazuar ne ligjin 9918, i ndryshuar, ne Rreguloren nr. 9, neni 3, pika 2, 3 dhe 4, ne Rekomandimet e KE, mund të përcaktojë dhe analizojë tregje të tjera që nuk janë pjesë e listës të shprehur ne piken 1 te nenit 2.